

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE  
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

# 100 VJET XHEMIJET

*(Konferencë shkencore – 17 dhjetor 2019)*

28



Shkup, 2020

Boton:  
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE  
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Vëllimi 28 – 2020  
Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:  
*Dr. Skender Asani*

Kryeredaktor:  
*Dr. Zeqirija Ibrahim*

Këshilli redaktues:  
*Dr. Skender Asani*  
*Dr. Sevdail Demiri*  
*Dr. Nuridin Ahmeti*  
*Mr. Nora Maliqi – Zylali*

Copyright©ITSHKSH, 2020  
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN: 978–608–4897–13–2

[www.itsh.edu.mk](http://www.itsh.edu.mk)

*Ky botim financohet nga:*

Република Северна Македонија  
Министерство за култура



Republika e Maqedonisë së Veriut  
Ministria e Kulturës

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE  
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

# 100 VJET XHEMIJET

*(Konferencë shkencore – 17 dhjetor 2019)*

28

**SCUPI**  
Shkup, 2020



## TRYEZA E LËNDËS:

|                                                                                                                                                          |     |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| DY FJALË PËR KËTË VËLLIM .....                                                                                                                           | 7   |
| <b>Skender ASANI</b> – FJALË PËRSHËNDETËSE: .....                                                                                                        | 11  |
| <b>Jasmina CURIQ</b> – FJALË PËRSHËNDETËSE .....                                                                                                         | 17  |
| <b>KUMTESA</b> .....                                                                                                                                     | 19  |
| <b>Jusuf OSMANI:</b> FERHAT BEJ DRAGA NË<br>DOKUMENTET ARKIVORE.....                                                                                     | 21  |
| <b>Qerim LITA:</b> ORGANIZATA POLITIKE XHEMIJETI<br>(BASHKIMI) 1919–1925 .....                                                                           | 35  |
| <b>Nuridin AHMETI:</b> “XHEMIJETI” – NJË ZË I ARTIKULUAR<br>NË MBROJTJEN DHE AVANCIMIN E TË DREJTAVE<br>NACIONALE TË SHQIPTARËVE NË MBRETËRINË SKS ..... | 55  |
| <b>Nexhmedin SPAHIU:</b> 100 VJET NGA THEMELIMI I XHEMIJETIT –<br>PARARENDËSES SË LDK–së SË IBRAHIM RUGOVËS .....                                        | 60  |
| <b>Ismet AZIZI:</b> AQIF BLYTA, SEKRETAR I XHEMIJETIT<br>DHE LIDER I SANXHAKUT .....                                                                     | 67  |
| <b>Emin AZEMI:</b> XHEMIJETI, 100 VITE PAS .....                                                                                                         | 95  |
| <b>Mehmet PRISHTINA:</b> “XHEMIJETI”, VAZHDIMËSI E<br>PËRPJEKJEVE PATRIOTIKE SHQIPTARE .....                                                             | 101 |
| <b>RECENSION</b> .....                                                                                                                                   | 107 |
| <b>Adem ZEJNULLAHU:</b> DËSHMI HISTORIKE PËR KONTRIBUTIN<br>E FERAT BEJ DRAGËS DHËNË ÇËSHTJES KOMBËTARE .....                                            | 109 |
| <b>FOTOGRAFI</b> .....                                                                                                                                   | 123 |



## DY FJALË PËR KËTË VËLLIM

Më 17 dhjetor 1919 u bënë 100 vjet që nga themelimi i organizatës politike ”*Islam Muhafaza-yl Hukuk Cemijet*”, që në gjuhën shqipe është “*Shoqata Islamike për Mbrojtje dhe Drejtësi*”, e cila në opinionin do të mbetet e njohur si “Xhemijet” (Bashkimin).

Me këtë rast Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, nën titullin “100 vjet Xhemijet”, organizoi disa aktivitete që e shënuan këtë përvjetor shekullor. Ndonëse ky nuk ishte aktiviteti i parë i Institutit për këtë temë (më 17 dhjetor 2017 ITS-HKSH, bashkë me SHB “Logos-A”, e kishte organizuar konferencën shkencore “*Organizata Xhemijeti dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit*” dhe kumtesat ishin botuar në një vëllim të edicionit SCUPI më 2018), shënimi i këtij përvjetori ishte në përmasa krejt të tjera. Edhe kësaj radhe aktivitetet u zhvilluan bashkë me Shtëpinë Botuese “Logos-A” nga Shkupi, e cila i ka botuar disa nga veprat mbi Xhemijetin.

Duke e vlerësuar rëndësinë e madhe që ka kjo datë për historinë e shqiptarëve, në përgjithësi, dhe për shqiptarët e Shkupit, në veçanti, së pari u shpalos një pllakë përkujtimore në Çarshinë e Shkupit, e vendosur në hyrje të Kapanhanit, aty ku është mbajtur Kuvendi Themelues i Xhemijetit. Shpalosjen e kësaj pllake e bëri drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Dr. Skender Asani, kryetarja e Këshillit Nacional të Boshnjakëve të Sanxhakut, Dr. Jasmina Curiq, e ardhur nga Novi Pazari enkas për këtë ngjarje, pastaj Sadik Beqiri zëvendësministër i Transportit dhe Lidhjeve në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë Veriut, Faton Fazliu, shef i kabinetit të ministrit të Kulturës, Visar Ganiu, kryetar i

Komunës së Çairit, si dhe përfaqësuesit e familjeve të famshme shqiptare Draga, Prishtina, Boletini dhe Seferi.

Pas shpalesjes së pllakës, fjalë të shkurtër rasti mbajti drejtori i Institutit, Dr. Skender Asani, ndërsa pjesa tjetër e aktiviteteve vijuan në ITSHKSH. Aty së pari u hap një ekspozitë dokumentare, e përgatitur nga studuesit Mr. Nora Maliqi Zylali dhe Dr. Skender Asani me temë “Xhamitë dhe teqetë në Shkup mesdy luftërave botërore”, ndërsa hapjen solemne të ekspozitës e bëri shefi i kabinetit të ministrit të Kulturës, Faton Fazliu.

Pjesa e tjetër e aktiviteteve vazhdoi në sallën “Wilson” të Institutit, ku pas fjalëve përshëndetëse të drejtorit Asani, fjalë rasti pati edhe kryetarja e Këshillit Nacional të Boshnjakëve të Sanxhakut, Dr. Jasmina Curiq, që në këtë aktivitet kishte ardhur si përfaqësuese e boshnjakëve të Sanxhakut.

Pastaj vazhdoi pjesa shkencore, ku u lexuan disa kumtesa shkencore dhe u promovuan veprat që deri tash janë botuar për këtë organizatë politike dhe për personalitetet drejtuese të saj.

Duke e vlerësuar këtë akt të rëndësishëm kombëtar dhe shkencor, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve ka vendosur që kumtesat e lexuara në këtë konferencë të botohen në këtë vëllim të edicionit “Scupi”, në mënyrë që të përjetësohet edhe ngjarja e shënimit të përvjetorit të Xhemijetit dhe ajo të mbetet e dokumentuar në historiografinë tonë shkencore.

Ky vëllim është i ndarë në katër pjesë: në fillim janë fjalët përshëndetëse, vijojnë pastaj kumtesat shkencore, në pjesën e tretë është një recension për veprën e autorëve Jusuf Osmani & Asllan Murati, *Ferhat Bej Draga shembull atdhetarie* (dokumente), bot. Kolegji



AAB, Prishtinë, 2018, ndërsa në fund janë disa fotografi ilustruese të ngjarjes.

Mbetemi me shpresë se kështu kemi përmbushur një detyrim kombëtar dhe shkencor.

*Maj 2020*

*Dr. Zeqirija Ibrahim*



## FJALË PËRSHËNDETËSE

**SKENDER ASANI**

Drejtor i ITSHKSH – Shkup



*E nderuara zonja Curiq, kryetare e Këshillit Nacional të Boshnjakëve të Sanxhakut,*

*I respektuar zëvendësministër i Transportit dhe Lidhjeve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Veriut, z. Sadik Beqiri,*

*I nderuar përfaqësues i Ministrisë së Kulturës, z. Faton Fazliu,*

*I nderuari kryetar i Komunës së Çairit, z. Visar Ganiu,*

*Të dashur përfaqësues të familjeve Draga, Prishtina, Boletini dhe Seferi,*

*Shumë të respektuar studiues që sot na keni nderuar,*

*Të nderuar të tjerë të pranishëm në këtë ngjarje dhe ju përfaqësues të mediave,*

Pasi që bashkërisht e bëmë shpalosjen e pllakës përkujtimore për 100-vjetorin e Xhemijetit, jam shumë i nderuar që kam mundësi t'ju drejtohem dhe t'ju falënderoj që sot e keni begatuar këtë ngjarje historike në Shkupin tonë. Kjo ditë nuk është si çdo ditë

tjetër për ne. Ne sot nuk e kemi vendosur vetëm një pllakë të thjeshtë në Çarshi, por ne sot kemi vendosur një tullë të rëndësishme të historisë sonë në Shkup. Ne sot e kemi rilidhur fuqishëm hallkën e shkëputur të historisë sonë kombëtare në këto troje.

Mua më vjen keq që duhet ta përmend, por janë bërë gati 100 vjet që kjo organizatë është anatemuar në historinë kombëtare dhe nuk është përmendur fare nga historiografia jonë ose, aq më keq, është përmendur me tone negative. Prandaj, për neve si Institut, por edhe si shqiptarë, madje edhe personalisht për mua si studiues i Xhemijetit, ky është një moment që dikur vetëm mund ta kemi ëndërruar.

Shumë të respektuar të pranishëm,

17 dhjetori i vitit 1919 ishte një ditë gëzimi për bashkëkombësit tanë në Shkup. Madje, kësaj dite iu gëzuan edhe vëllezërit tanë të Kosovës, të Sanxhakut, si edhe turqit e këtyre trevave. Atë ditë u themelua organizata politike Xhemijet, që për disa vite me radhe do të ishte gardiania e vetme, por e paepur, e kauzës sonë kombëtare. Në të vërtetë, Xhemijeti ishte një hallkë tjetër e lëvizjes sonë kombëtare, një sinonim i Lidhjes së Prizrenit, i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, i Kongresit të Manastirit, por edhe emri tjetër i Klubit “Bashkimi”, të themeluar pikërisht nga Nexhib Draga më 1908, i cili u zgjodh edhe kryetar i parë i Xhemijetit.

Nëse për një çast kthehemi në ato vite dhe e sjellim ndër mend atë histori, kur përfundoi Paqja e Versajës dhe trevat lindore mbetën në Mbretërinë SKS, para nesh shfaqen skenat e masakrave, depërtimit me dhunë, shpronësimeve, kolonizimeve e deri në çnderimet familjare. Atëbotë seriozisht u shtrua pyetja “A do të arrijmë të mbi-jetojmë?”. Sepse krejt kushtet ishin që ne të mos arrinim të mbijetojmë.

tonim. Por, falë njerëzve që kanë pasur guxim, vizion dhe vullnet, kjo trysni sistematike – së paku për disa vite – u ndal. Ishin pikërisht këto vitet e Xhemijetit. Patriotët tanë, si vëllezërit Nexhib e Ferhat Draga, por edhe Aqif Blyta e Nazim Gafuri, si edhe shumë të tjerë gjithandej, i dolën zot popullit të tyre dhe sakrifikuan gjithçka që patën, madje edhe më të shtrenjtën – jetën, që ta mbrojnë këtë popullatë nga shfarosja. Xhemijeti, për aq vite sa ekzistoi, e ktheu krenarinë e humbur më 1912. Ajo do të jetë organizata e vetme që për gjashtë vjet me radhë (1919–1925), ndërsa veprimtarët e saj do të vazhdojnë me aktivitete edhe pas shuarjes së saj, do ta mbrojnë interesin e popullatës, do ta pengojë shpërnguljen e dhunshme, reformën agrare dhe kolonizimin.

Për fat të keq, shumë studiues, duke qenë subjektivë, kanë rënë në grackën e interpretimeve ideologjike, duke e pasur parasysh emrin e Xhemijetit, që të japin vlerësime e kualifikime se bëhej fjalë për një organizatë fetare, madje edhe turke. Në të vërtetë, në kohën kur mundësia e vetme e organizimit politik ishte ombrella e fesë, krerët e Xhemijetit nuk hezituan që ta përdorin atë embleinë për realizimin e objektivave të tyre madhore. Ndërkaq dokumentet e konsujve të ndryshëm, por edhe ato raportet e diplomacisë shqiptare të asaj kohe, si edhe ato denigruese serbe, flasin se Xhemijeti ishte një organizatë shqiptare, që i mbronte edhe interesat e myslimanëve të tjerë të jugut në Mbretërinë SKS. Madje, në dokumentet serbe Ferhat Draga akuzohet si nacionalist shqiptar me prirje separatiste. Që, në fakt është e vërtetë, sepse vëllai i tij, Shefqeti, ishte pjesë e çetave kaçake, ndërsa i biri i tij, Aliu, si anëtar i Komitetit të Kosovës, ishte shpallë nga pushteti serb si “kriminel lufte”. Thënë ndryshe, Ferhat Draga ishte për organizimin legal ajo që ishte Hasan Prishtina për organizimin ilegal kombëtar.

Por, kjo dhe beteja që e bënte Xhemijeti në parlamentin e Mbretërisë ishte edhe arsyeja që pushteti i asaj kohe iu kundërvu aq rëndë kësaj organizate, derisa e shoi tërësisht, ndërsa krerët e saj i burgosi (Ferhat Dragën e Aqif Blytën) dhe i vrau mizorisht (Nazim Gafurin).

Ajo që duhet vënë në spikamë sot është se Xhemijeti në vitet ndërmjet dy luftërave botërore ishte indi lidhor i Shkupit, Mitrovicës dhe Pazarit të Ri, duke krijuar relacionin e fuqishëm mes bërthamës dhe periferisë, në mënyrë që kauza jonë kombëtare të mos mbetej e marginalizuar dhe e përjashtuar. Më vjen keq ta them, por liderët e sotëm politikë e kanë harruar Sanxhakun dhe kanë hequr dorë krejtësisht nga ky rajon, i cili një kohë ka qenë balli i rezistencës sonë kombëtare. E duke hequr dorë nga ky koncept i Xhemijetit, ne vullnetarisht kemi hequr dorë nga kufijtë tanë etnikë, duke e rrudhur substancën tonë etnike dhe duke i përjashtuar pjesët natyrale të gjeografisë sonë kombëtare. Sa për informacion, për Aqif Blytën, Ferhat Dragën, por edhe për Isa Boletinin, Pazari i Ri nuk dallonte asgjë nga Mitrovica. Ato ishin dy qytetet tona të medaljes së njëjtë kombëtare. Prandaj, duke e pasur mbi vete këtë histori, ne sot kemi vënë lidhje komunikimi e bashkëpunimi me drejtuesit e Sanxhakut dhe shpresojmë se ato edhe në të ardhmen do të kultivohen. Ne e njohim realitetin e ri etnik atje, por nuk mendojmë se është mirë të heqim dorë nga e kaluara jonë e përbashkët. Dhe, ajo që më gëzon edhe më shumë, është se përsëri Shkupi – si në kohën e Xhemijetit – është mullari ose epiqendra e kësaj gjeografie ose, shprehur ndryshe, kryeqendra shpirtërore shqiptare. Me themelimin e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup ne e kemi ridizajnuar edhe identitetin tonë kombëtar dhe, pavarësisht kufijve

politikë, ne nuk vetëperceptohemi më si periferi, por si një strumbullar rreth të cilit ndërtohet shqiptaria e kësaj pjese të Ballkanit. Ndërkaq, në kontekst të temës së kësaj dite, Xhemijeti është modeli më i mirë i këtij organizimi. Një model që edhe sot mund t'u shërbejë elitave tona politike.

Të nderuar të pranishëm,

Xhemijeti, pos tjerash, është edhe një model unik properëndimor, ngase ai ka një qasje progresiste – ai e mbron identitetin tonë etnik dhe fetar, por nuk është përjashtues as për identitetet e tjera. Kjo qasje inkluzive edhe sot e kësaj dite mbetet sfidë për popujt tanë.

Andaj, nëse duhet ta përvijojmë historinë tonë kombëtare në trevat tona lindore, detyrimisht pika jonë fillestare do të jetë Xhemijeti. Sepse vetëm në saje të këtij tipi të organizimit, ne favorizohemi në Ballkan dhe bëhemi element që nuk lëkundet dhe nuk tundet lehtë.

Nisur nga kjo, dita e sotme e shënimit të 100-vjetorit të Xhemijetit, shpalosja e pllakës përkujtimore në Kapanhan, aty ku është mbajtur Kuvendi Themelues para një shekulli, si edhe kjo konferencë shkencore, është një festë e veçantë dhe e rëndësishme, sepse kështu – së paku pjesërisht – ia kemi dalë ta nxjerrim në dritë një periudhë shumë të rëndësishme të historisë sonë dhe të dëshmojmë për praninë tonë këtu.

Më lejoni që, duke përfunduar të them se po të mos ishte Xhemijeti, nuk do të ishte as NDSH-ja, as Lidhja e Dytë e Prizrenit, as rezistenca aktive gjatë viteve të '60-ta e '70-ta e prirë nga baca Adem Demaçi, as periudha e ngjarjeve të 1968-tës, ndoshta as kushtetuta e 1974-tës, as demonstratat e '81-shit, madje mbase as

UÇK–ja. Xhemijeti ishte fija e parë e rezistencës dhe organizimit tonë politik.

Duke ju falënderuar për kujdesin, unë ju falënderoj përzemërsisht që sot ishit në Shkup. Në veçanti i falënderoj mysafirët na San–xhaku e nga Kosova, që këtë ditë të bukur na e bënë Xhemijet.

Ju faleminderit të gjithëve!

Shkup, 17 dhjetor 2019



## FJALË PËRSHËNDETËSE

***JASMINA CURIQ,***

Kryetare e Këshillit Nacional  
të Boshnjakëve të Sanxhakut



Të nderuar pjesëmarrës, zonja e zotërinj,

Të nderuar ministra, të respektuar deputetë, vëllezër e motra,

E shfrytëzoj rastin që para së gjithash t’ju falënderoj për ftesën që të marr pjesë në shënimin e 100–vjetorit të themelimit të organizatës politike “Xhemijet”, që për mua është nder dhe kënaqësi e madhe.

Më lejoni t’ju përgëzoj për vendimin e urtë dhe historik që ta shënoni 100–vjetorin e themelimit të Xhemijetit dhe me këtë rast të vendosni një pllakë përkujtimore në vendin ku është themeluar kjo organizatë politike në Mbretërinë e atëhershme Serbo–Kroatë–Sllovene, e cila atëbotë kishte tubuar numrin më të madh të pjesëtarëve të kombit boshnjak dhe shqiptarë të Sanxhakut, Kosovës dhe Maqedonisë.

Themeluesi dhe kryetari i Xhemijetit, Ferhat Beg Draga, ishte një njeri i madh me vizion, një lider meritator dhe një politikan i urtë. Popujt e Sanxhakut, Kosovës dhe Maqedonisë i detyrohen shumë sakrificës dhe konsistencës së tij.

Prijësit e Xhemijetit, Nexhib Draga, Ferhat Beg Draga dhe Aqif Efendiu ishin dhe mbetën simbolet e patriotëve të Sanxhakut.

Edhe Këshilli Nacional i Boshnjakëve të Sanxhakut në vitin 1912 në Tutin dhe në Novi Pazar ka shpalosur pllaka përkujtimore për prijësit e Xhemijetit: për Ferhat Beg Dragën në shkollën fillore të f. Dragaj, në Tutin ku është i lindur Aqif Efendiu dhe në qendër të Novi Pazari, ku ka qenë shtëpia e tij.

Ju faleminderit për kujdesin!

Ju dëshiroj gjithë të mirat!

Shkup, 17 dhjetor 2019

**KUMTESA**



---

*JUSUF OSMANI*

*Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës*

## FERHAT BEJ DRAGA NË DOKUMENTET ARKIVORE

Për personalitetin e Ferhat bej Dragës deri me tani është shkruar pak. Gjatë hulumtimeve tona shkencore arkivore përkritazi me kolonizimin e Kosovës, reformën agrare dhe shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi kemi hasur në disa dokumente arkivore që flasin për veprimtarinë e këtij veprimtari të shquar të kombit tonë. Në mënyrë që të kontribuojnë sado pak në ndriçimin e jetës dhe veprimtarisë së tyre, i kam botuar, së bashku me të ndjerin Asllan Muratin, që në popull njihet me emrin Mulla Asllani, dokumentet që kanë të bëjnë për personalitetin e Ferhat bej Dragës me titull ***FERHAT DRAGA SHEMBULL ATDHEDASHURIE***, Prishtinë, 2018. Këto dokumente do t'i shërbejnë plotësimit të shkrimeve dhe hulumtimeve të mëtutjeshme për krijuesit që do të botojnë monografi për këtë personalitet dhe familjen e tij, sepse ata e meritojnë këtë.

Libri është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë janë paraqitur të dhënat për Ferhat bej Dragën dhe familjen e tij, ndërsa në pjesën e dytë janë paraqitur 207 dokumente arkivore të hulumtuara në arkiva të ndryshme të vendit, rajonit dhe të botës.

Dokumentet e prezantuara janë hulumtuar në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë, në Arkivin e Institutit Historik Ushtarak në Beograd, në Arkivin Nacional në Londër, në Arkivin e Maqedonisë në Shkup, në Arkivin Shtetëror të Kosovës në Prishtinë etj. Por, edhe shënimet stenografike, që i kanë botuar diskuti-

met e Ferhat Dragës në Parlamentin e Mbretërisë SKS, përkatësisht jugosllav, gazetat e kohës, si: *Politika*, *Pravda* dhe *Vreme* të Beogradit; gazeta *Hak* dhe *Stara Naša Srbija* të Shkupit; *Drita*, Tiranë; *Nepravda*, Beograd dhe të tjera, e plotësojnë këtë. Janë marrë edhe disa dokumente që janë botuar në libra e revista të ndryshme nga prof. Dr. Hakif Bajrami, Akad. Marenglen Verli, Dr. Skender Asani dhe Dr. Qerim Lita.

Dokumentet janë paraqitur në mënyrë kronologjike, sipas vitit të krijimit. Disa dokumente, ato në gjuhën shqipe, janë paraqitur në gjuhën e kohës, me shkronja të pjerrëta, të paraqitur me thonjëza dhe nuk është bërë kurrfarë ndërhyrje në to.

Prandaj këtu më poshtë do t'i paraqesim shkurtimisht arkivat në të cilët ruhen dokumentet për Ferhat Bej Dragën.

### ***Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (MPJSH)***

Pa dyshim se arkivi në të cilin ka më së shumti dokumente arkivore për veprimtarinë e Ferhat bej Dragës është Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Në këtë arkiv janë raportet, informatat, kërkesat, protestat etj. të organizatës Xhemijeti dhe të Ferhat Dragës. Këto dokumente i janë dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë nga Kryekonsullata Shqiptare në Shkup, Ambasada e Shqipërisë në Beograd, konsullata në Manastirit etj. Këto dokumente dëshmojnë se menjëherë pas vënies në krye të Xhemijetit, ai iu përvesh punës, që nuk ishte edhe aq e lehtë, sepse duhej të veprime në rrethana mjaft të vështira për kombin shqiptar, aq më shumë që Mbretëria SKS, përkatësisht Mbretëria e Jugosllavisë, assesi nuk donte t'i cilësonte ata si shqiptarë, por si nacionalitet turk. Zaten, shteti gjithë këtë e bënte për ta justifikuar dëbimin e

shqiptarëve në Anadoll e gjetiu, duke marrë pronat e shqiptarëve nëpërmjet të ashtuquajturës reformë agrare dhe kolonizim sllavë të Kosovës, gjë që ishin arsye edhe për shumë vrasje e padrejtësi që i bëheshin popullit shqiptar. Puna dhe aktiviteti i veprimtarisë politike i Ferhat Dragës filloi t’u bëhet pengesë e madhe parlamentarëve jugosllavë. Në këtë mënyrë pushteti nisi fushatën për t’ia ngushtuar hapësirën e veprimit Xhemijetit, sidomos pas prononcimeve të liderit të saj, Ferhat Draga, kundër shpërnguljes së shqiptarëve dhe kërkesës për kthimin e muhaxhirëve shqiptarë në trojet e veta etnike. Këtë kërkesë në Parlamentin Jugosllav Ferhat Draga e kishte bërë në mënyrë të mençur e të guximshme dhe, madje, e kishte deponuar në Konferencën e Hagës. Kjo deklaratë e kishte nxitur Beogradin që të punojë për ta rrënuar nga brenda këtë parti me anën e krijimit të fraksioneve të ndryshme, por edhe me tryzni të tjera nga jashtë, që do të çojnë deri te shkatërrimi i saj disa vjet më vonë, madje edhe deri te burgosja dy herë e Ferhat Dragës dhe dënimi i tij pa kurrfarë argumenti.

Në dhjetor të vitit 1923 Xhemijeti i parashtron kërkesat për krijimin e gjyqeve të sheriatit, për autonomi të brendshme të vakëfeve, rregullimin e çështjes agrare, që të hapen shkolla në gjuhën shqipe dhe turqishte, të pushohet kolonizimi dhe të dënohen fajtorët e gjakderdhjes në Mitrovicë.

Një dokument i vitit 1933, i Konsullatës Mbretërore Shqiptare në Shkup, flet për vdekjen e djalit të Ferhatit, për ngushëllimet që i janë dërguar nga personalitetet e shumta të njohura.

Në Arkivin e MPJ të Shqipërisë shihet se, pas burgut, Ferhat bej Dragës nuk iu lejua të formonte parti politike e as të merrte pjesë në zgjedhjet për Parlament, që u zhvilluan më 1931, më 1935 dhe më 1938. Atij iu la mundësia të vepronte vetëm në gjirin e “Ko-

munitetit Fetar Mysliman” për “Serbinë Jugore”, por edhe në këtë drejtim u pengua fuqimisht në mënyrë që të mos zgjidhej kryetar i Vakëfit në Shkup. Edhe pse pushteti ushtronte trysni të vazhdueshme mbi deputetët shqiptarë të cilitdo rreshtim politik, në zgjedhjet komunale e parlamentare fitonte ai politikan që përkrahej nga Draga. Pra, Ferhat Draga, edhe pse pa parti politike, edhe pse vetëm kryetar i Vakëfit të Shkupit, roli i tij binte shumë në sy dhe gati të gjitha përvijimet politike e shoqërore të shqiptarëve silleshin rreth tij.

Në dokumentin e datës 17 tetor 1935 Ferhat Bej Draga dhe Mimqillo Ivaniqi në emër të myslimanëve të jugut, ia dërguan kryeministrit Stojadinoviç një informatë për grabitjen e pronave të shqiptarëve, duke kërkuar që të ndërpritet marrja arbitrare e pronave, si dhe të realizohen të drejtat kombëtare dhe liritë demokratike për shqiptarët.

Gjatë periudhës 1935–1938 Ferhat Draga ka përgatitur disa pro-memorie, ku kërkonte sigurimin e lirisë politike dhe kulturore të shqiptarëve në Mbretërinë Jugosllave, duke kundërshtuar politikën diskriminuese shtetërore: shpronësimin agrar, shpërnguljen me dhunë dhe kolonizimin e Kosovës.

Sipas dokumenteve arkivore, më 30 maj 1937 u mbajtën zgjedhjet e para të lira e demokratike të BFI-së, në të cilat fitoi krahu opozitar, përkatësisht lista e Ferhat bej Dragës, të cilët përfundimisht e bënë këtë bashkësi fetare armën më të fuqishme kundër projekteve antishqiptare të klikës hegjemoniste serbomadhe. Ferhat bej Draga arriti ta zgjerojë autonominë e Bashkësisë e Fesë Islame në Kosovë dhe Maqedoni (selia e saj ishte në Shkup).



Në gusht të vitit 1938, Ferhat bej Draga i shkruan ministrin të komunikacionit, dr. Mehmet Spaho, dhe e informon për gjendjen e vështirë të popullit shqiptar, madje kërkon nga ai që të kërkojë nga kryeministri Stojadinoviq shfuqizimin e të gjitha dispozitave ligjore mbi reformën agrare, kërkon liri politike dhe kulturore për shqiptarët, si dhe anulimin e Konventës Jugosllavo-Turke për shpërnguljen në Anadoll të një çerek milioni “myslimanësh” nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia.

Në një informatë shumë me interes, që ruhet në Arkivin e MPJSH, e vitit 1938, shkruan se Ferhat beg Draga kishte udhëtuar në Stamboll përkitazi me çështjen e pozitës së shqiptarëve në Kosovë. Ai kishte njoftuar lidhur me dhunën e terrorin që po ushtronte qeveria e Beogradit për shpërnguljen e popullatës shqiptare nga Kosova dhe viset e tjera të banuara me shqiptarë, sidomos me nënshkrimin e Konventës Turko-Jugosllave për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi. Ai u takua me Hasan Rizën, Sekretar i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës turke, mik i familjes Draga, të cilin e njofton lidhur me pozitën e shqiptarëve në Mbretërinë Jugosllave. Hasan Rizai i premtonte se të gjitha këto do t’ia përcjellë Kryetarit të Republikës, Ataturkut. *“N’ate rast i deklaroi Hasan Rizaj bashkëkombësit t’one që ia kish dhënë Ataturkut një nga një dhe me të gjithë hollësi fjalët e tij, të cilat Kryetari i Shtetit turk i kish dëgjuar me kujdesi te veçante. I kish dërguar haber Ataturku Ferhat Bej Drages që ay nuk e njohte këtë personalisht, por njohte të ndyerin Nexhip Bey Dragën, të cilin e kish njohur në kohën kur ishte inspektor i Shemendufërëve të Maqedonisë dhe kish ngrënë bukë në shtëpinë e tij. E përshëndeste dhe ftonte që të rrinte i qetë sepse sa i kish thënë ay dhe se kërkonte ay, do të ja plotësonte dëshirën plotësisht sepse vërtet u përgatit konventa, por ajo kërkon*

*ratifikimin e Guvernës dhe ay nuk do të bënte kurrë një gjë që ishte në kundërshtim me realitetin dhe me dëshirat e shfaqura nga ana e tij”.*

Ekzistojnë edhe dokumente të shumta në këtë arkiv, që hulumtuesit e studiuesit nga lëmitë e ndryshme duhet t’i hulumtojnë.

### ***Arkivi Kombëtar në Londër***

Po e përmendim një dokument të proveniencës angleze, të datës 2 nëntor 1923, nr. 61, të hulumtuar në PRO në Londër, ku mes tjerash shkruan se: “14 deputetë myslimanë (shqiptarë) nga Kosova, vajtën në Beograd, nën udhëheqjen e Ferhat Dragës, deputet i Prishtinës, që rrjedh nga një familje fisnike nga Mitrovica, për të protestuar kundër persekutimeve të vendësve të tyre. Mirëpo, pa rezultate.”

Aty flitet edhe për sulmin ndaj Ferhat Dragës, kur “katër persona e sulmojnë atë dhe e plagosin, ndërsa xhandarmëria qëndron indifereente.”

Jepet aty edhe mendimi i tij për migrimin në Shqipëri, sepse “asnjë jetë shqiptare këtu nuk është e sigurt”.

Në dokument ceket se “gjatë zgjedhjeve komunale në Mitrovicë u krijuan trazira, me ç’rast u vranë 7 dhe u plagosën 11 shqiptarë”.

Në një vend tjetër përmendet “vrasja e një funksionari shqiptar dhe e një ushtari serb nga një atentator i panjohur, që pastaj të burgoset një numër i madh shqiptarësh dhe të rrethohen shumë shtëpi dhe dyqane të shqiptarëve”.

### *Arkivi i Jugosllavisë në Beograd*

Në Arkivin e Jugosllavisë në Beograd në Fondin “Stenografske beleške Kralevine SHS”, përkatësisht “Jugosllavije”, botohen dy diskutimet më të rëndësishme të Ferhat Dragës në Parlamentin Jugosllav. I pari ka të bëjë me zgjedhjet komunale të viti 1923. Në fillim të diskutimit të tij ai thekson se “Unë nuk jam turk, zotëri, unë jam mysliman i nacionalitetit shqiptar, më i vjetër se ti në Ballkan”. Më pastaj flet për terrorizmin, gjakderdhjet në Mitrovicë, Prishtinë e gjetiu. Pa dyshim dokumenti më i rëndësishëm që është botuar në “Stenografske beleške” është interpelanca e Ferhat beg Dragës në Parlamentin Jugosllav në mbledhjen e 64-të të datës 20.III.1924. Ai i përshkruan vrasjet, krimet dhe dhunën, që është bërë ndaj popullatës shqiptare. Draga e përshkruan shkurtimisht historikun e popullit shqiptar, ardhjen e serbëve në Ballkan, flet për kaçakët, masakrat që janë bërë në rajone të ndryshme të Kosovës, sidomos në Zagori, Poseçan të Ohrit etj.

Dokumentet dëshmojnë se në muajin gusht të vitit 1924 Ferhat Draga e kishte vizituar Zagrebin dhe kishte zhvilluar biseda me deputetet e HRSS-së (Partisë Fshatare Kroate). Pas kthimit nga Zagrebi Ferhat Draga e ka përshkruar haptazi qëllimin e politikës së tij: *“Çdokush të vetën e ne tonën. Çka kërkon Serbia kur ne nuk e prekim në kufij të saj!”*,

### *Arkivin e Institutit Historik Ushtarak në Beograd*

Në këtë arkiv, në Regjistrin P.17, kut. 94, viti 1937, ka të dhëna për propagandën shqiptare, për takimin në Mitrovicë të Asim Gutës nga Gjakova me Sherif Vocës dhe Ferhat Dragës, ku ata bëjnë agjitacion që mos të braktiset vendi dhe bëjnë thirrje për rezistencë përkitazi me marrjen e tokës dhe shpërnguljes. Këtu flitet edhe për

organizimin e bashkësive fetare dhe anëtarëve të tyre, si dhe për ndërprerjen e punëve të pushtetit agrar. Aty është përfshirë edhe dërgimi i Beqir Myftarit në Beograd me lutje që të ndërpritet puna e pushtetit agrar.

Në një raport të Armatës III të vitit 1938 thuhet se deputetët shqiptarë kanë dëshirë që Ferhat Draga të zgjidhet deputet. Aty flitet edhe për hyrjen e tij në qeveri, me shpresë se ashtu do të pengohet shpërngulja e qëllimshme dhe marrja e mëtejshme e tokës nga shqiptarët.

Këtu është një dokument i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Mbretërisë jugosllave, i vitit 1938, i cili e informon Armatën se po përhapet propaganda e madhe nëpër fshatra dhe qyteza rreth kufirit nga Shqipëria për të penguar shpërnguljen nga vendi ynë. Në të përmendet edhe nisma e Ferhat bej Dragës dhe ndihma e Sherif Vocës në grumbullimin e nënshkrimeve të shqiptarëve për dërgimin e peticionit përfaqësuesve të jashtëm në shtetin tonë dhe Lidhjes së Kombeve.

Në një raport për veprimet politike në Kosovë, viti 1939, i Shtabit të Përgjithshëm në Beograd, dërguar Armatës III, MPJ, bëhet fjalë për propagandën e Ferhat Dragës pas okupimit të Italisë së Shqipërisë, dhe shpresat e popullit shqiptarë. Këtu është një analizë e Komandantit të Armatës së III në Shkup për reagimin e popullatës shqiptare në Kosovë, të vitit 1939, ku thuhet: “Me rastin e ftesës së fundit të popullsisë së këtushme në stërvitje ushtarake, në mesin e shqiptarëve, u dëgjuan thënie se “pse na thërrasin në ushtrime ushtarake ndërsa në shtëpi i kemi fëmijët e uritur, kur neve na morën tokën?” etj.

Një raport i Ministrisë së Punëve të Brendshme, shtator 1939, informon për aktivitetin e Ferhat Bej Dragës për bashkimin e trojeve shqiptare.

Shtabi i Zonës së Divizionit të Kosovës në Shkup, i vitit 1939, njofton për parinë shqiptare dhe protestën e Ferhat Bej Dragës për shkak të marrjes së tokës.

Më 2 dhjetor 1939 Shtabi i Divizionit të Krahinës së Kosovës raporton për punën e Ferhat Dragës dhe thotë se “ai po punon në themelimin e organizatës myslimane–shqiptare. Këtë po e bënë nëpërmjet pushtetit italian në Shqipëri”.

### ***Arkivi historik i qytetit të Shkupit***

Në këtë Arkivi ruhen dokumentet e trashëgimisë së familjes Draga, kërkesa për kthimin e pronave, tapitë, aktgjykimet etj. Dokumentet janë të vitit 1925–1929.

### ***Arkivi i Sekretariatit Federativ të Punëve të Jashtme, Shoqata e Kombeve në Gjenevë***

Aty kam gjetur dy dokumente, një për Sharrën e Dragajve në Mitrovicë dhe për Memorandumin e vitit 1930 dërguar Lidhjes së Kombeve nga Don Gjon Bisaku, Don Shtjefën Kurti dhe Don Luigj Gashi. Ai bën fjalë për gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi. Aty protestohet edhe kundër burgosjes së Ferhat bej Dragës.

### ***Arkivi i Institutit Historik të Maqedonisë***

Aty kemi gjetur një dokument të Shtabit të Përgjithshëm në Beograd, viti 1939, që thekson se agentët e Ferhat Bej Dragës, gjatë gjysmës së muajt të kaluar, i kanë vizituar këto vise. Sipas të gjitha

gjasave, kjo vizitë ka pasur për qëllim grumbullimin e të dhënave për gjendjen në këtë territor lidhur me thirrjet e fundit për stërvitje ushtarake.

Në një dokument tjetër tregohet se udhëheqësit shqiptarë, në krye me Ferhat bej Dragën, sugjerojnë që në asnjë mënyrë të mos i braktisin vatrat e tyre, sepse pushteti nuk ka rrugë dhe metodë që t'i shpërngulë me forcë.

Në fund të vitit 1939 Shtabi i Përgjithshëm e informon Ministrin e Ushtrisë dhe Narinës në Beograd dhe ministritë tjera për aktivitetin politik të parisë shqiptare në Kosovë, për udhëtimin e Ferhat bej Dragës në Stamboll dhe për takimin me Mbretin Zog.

Në një raport tjetër të këtij shtabi, të vitit 1940, thuhet se: “Kohëve të fundit po vërehet një gjallërim i lëvizjes së parisë shqiptare për rithemelimin e ish partisë myslimane Xhemijet, ku kanë marr pjesë figura të njohura, si Ferhat bej Draga, Iljaz Agushi, Qerim Zejini, Jusuf Imeri, Sherif Voca – Beqiri, Adem Marmullaku, Jahja Daci, Sadik Myrta dhe Asim Luzha–Murtezi...”

Në këtë arkiv ka edhe dokumente të tjera që flasin për Ferhat Dragën.

### ***Arkivi i Forcave ushtarake të Shqipëri***

Aty kemi gjetur një telegram sekret të datës 17.XI.1941. Lidhur me idenë për shpërnguljen e shqiptarëve nga treva e Mitrovicës aty thuhet se kjo do të shkaktonte tek shqiptarët më shumë dëshpërim sesa të gjitha tentativat e serbëve të bëra gjatë dekadave për t'i kolonizuar. Kjo do t'ia jepte goditjen më të rëndë prestigjit gjerman në të gjithë shqiptarët, gjë që e dëshirojnë dhe italianët. Aty kons-tatohet se duke marrë parasysh besnikërinë e madhe të shqiptarëve

karshi atdheut të tyre, do të ishte e mundur të zbatohesh shpërngulja vetëm me masa arbitrare dhe jo pa trazira të rënda, Konsiderohet sidomos e dëshirueshme që “derisa ekziston problem i ruajtjes së paqes në vendet ballkanike, ideja e shpërnguljes, edhe po të para-shikohet për më vonë, të mos përmendet askund....”

### ***Arkivi Qendror Shqiptar***

Një analizë e Kryetarit të Komitetit të Kosovës, Bedri Pejani, të datës 27 janar 1942, flet për gjendjen në Mitrovicë, çështjen e Kollashinit, mbrojtjen e Pazarit të Ri, miqësinë shqiptaro-serbe, shtatë katundet e Pejës dhe masat që duhet ndërmarrë.

Dokumenti tjetër është një Promemorie lidhur me masat që duhet marrë Qeveria Shqiptare në Mitrovicë dhe rrethinë, kjo me 3 shkurt 1942.

**“NJI DOKUMENT TRATHTIJE ME XHUFKË”**, Tiranë, 25.III.1942, është shkresë nga *Nga Ministria e Tokave të Liruar, lidhur me Apelin e përbashkët të Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe Partisë Komuniste të Jugosllavisë, drejtuar shqiptarëve të Kosovës*.

E rëndësishme është edhe letra e Qerim Begollit, e datë 4 prill 1942, që flet për situatën jo të mirë në përgjithësi në Kosovë, Pejë dhe Sanxhak.

Në këtë fond është edhe një Promemorie e Ferhat Dragës për gjendjen e pyjeve në Rozhajë.

### *Arkivi Shtetëror i Kosovës*

Në Arkivin Shtetëror të Kosovës, në fondin “Prokuroria Publike e Kosovës”<sup>1</sup>, në regjistrin e personave që janë shpallur kriminelë të luftës, nën nr. 139, figuron edhe emri Ali Beg Dragës nga Mitrovica, anëtar i Komitetit të Kosovës. Aliu ishte djali i Ferhat bej Dragës.

Në një dokument tjetër, që ruhet në Arkivin Shtetëror të Kosovës, ekzistojnë të dhënat për konfiskimin e pasurisë së personave të shpallur “armiqtë e popullit”, në mesin e të cilëve është edhe emri i Ferhat Dragës.

Në fondin e Gjyqit të Qarkut në Prishtinë, në gjykimin kundër Ukë Sadik Ramës nga Gjurgjeviku, në vitin 1947, ka të dhëna edhe për vdekjen e Ferhat Bej Dragës.

### *Arkivi Ras në Novi Pazar*

Aty është një dokument për **Gjyqin Komunal në Tutin**, Lëndët civile, 1948, ku për Ferhat Ali Dragën ekzistojnë disa lëndë për konfiskimin e pasurisë.

### *Instituti i Historisë së Kosovës*

Këtu ruhet një raport i Pllavshiqit (tetor 1943) për gjendjen në rrethinën e Mitrovicës. Në një kapitull të tij flitet edhe për rolin e Ferhat bej Dragës dhe të tjerëve. Atë e ka botuar prof. dr. H. Bajrami në revistën “Vjetari” të Arkivit të Kosovës.

---

<sup>1</sup> ASHK, F. Prokuroria Publike e Kosovës, Prizren, kut. 2, doku. Nr. 418/46.



### *Gazetat*

Për Ferhat Dragën kanë shkruar edhe gazetat e kohës. Ssidomos të dhëna ka në gazetat e Beogradit “Politika”, “Pravda” dhe “Vreme”. Këto gazeta, në kontest negativ, me prapavijë politike e me plot të pavërteta, shkruajnë për Ferhat Dragën, familjen e tij dhe organizatatën Xhemijet.

Kështu në vitin 1921 gazeta “Politika” boton disa artikuj për vëllain e Ferhatit, Shefket bej Dragën, dhe kaçakët e tij. Ajo shkruan gjoja për anarkinë në jug dhe rolin e Xhemijetit, kinse çetat myslimane janë duke bërë krime të reja. Botohen aty edhe artikuj për zgjedhjet parlamentare të vitit 1923, kur lista e Xhemijetit i fitoi 14 deputetë në Qarkun e Zveçanit.

Gazeta “Politika” e boton artikullin “Gjak në Mitrovicë” – kinse shqiptarët, të prirë nga Ferhat Draga, gjatë zgjedhjeve i kanë sulmuar serbet.

Gazeta “Politika” e 23 nëntorit 1923 shkruan për Xhemijetin dhe thekson se Organizata e Myslimanëve të Serbisë Jugore me emrin “Xhemijet”, gjatë themelimit të saj, ka punuar nën maskën për tendenca arsimore–kulturore, andaj është lejuar veprimi dhe organizimi i saj në tërë popullatën myslimane në viset jugore.

Në prag të zgjedhjeve parlamentare të 11 shtatorit 1927, siç shkruan gazeta “Pravda” e Beogradit, Ferhat bej Draga prapë burgoset dhe atij i shqiptohet dënimi me 20 vjet burg të rëndë<sup>2</sup>. Nga gjykatën e shkallës së dytë, në janar të vitit 1928, siç shkruan gazeta “Politika” e Beogradit, Ferhat bej Draga është lëshuar në liri.

---

<sup>2</sup> “Pravda”, 17.V.1927, Beograd

Gazeta “Vreme” e boton fotografinë e delegacionit të parisë shqiptare në Beograd.

Duhet përmendur, po ashtu, edhe shumë artikuj të gazetës “Hak”

*Gazeta “Kosova”* e vitit 1941 e boton artikullin **“ANËTARËT E NDERIT TË KOMITETIT TË KOSOVËS”**, ku flet gjerësisht për jetën dhe veprimtarinë e Ferhat Bej Dragës, për çështjen kombëtare shqiptare, për sakrificën dhe burrninë e tij për Kosovën etj.

Gazeta “Kosova” (23.VI.1942) e boton artikullin e Ferhat Dragës, të vitit 1935, me titull: **“SI U ZBATUE REFORMA AGRARE NË KOSOVË”**.

Në fund duhet theksuar se së bashku me Mulla Asllanin kemi shkuar dhe e kemi gjetur varrin e Ferhat Dragës, që gjendet i vetmuar në malet e Voljakës të komunës së Klinës, e kemi fotografuar, e kemi pastruar dhe kemi vërë lule në varrin e tij. Më pastaj, kemi kërkuar nga zyrtarët e Komunës së Klinës dhe të Mitrovicës, që eshtrat e tij të bartën dhe të varrosen në mënyrë dinitoze në Mitrovicë dhe aty t’i ngrihet një lapidar. Këtë iniciativë, që ishte iniciuar fillimisht nga Mulla Asllani, e përkrahën verbalisht në Komunën e Klinës, por që atëherë asgjë konkrete nuk është ndërmarrë. Mulla Asllani shkoi në jetën tjetër të amshueshme pa e realizuar dëshirën e tij për sjelljen e eshtrave të Ferhat Dragës në Mitrovicë, sikurse kishte bërë para shumë viteve me eshtrat e Isa Boletinit, të bijve dhe bashkëpunëtorëve të tij. Mbetem me shpresë se kjo dëshirë e Mulla Asllanit do të realizohet, që në konkluzionet e kësaj konference shkencore të kërkohet me organet tona shtetërore e komunale të Kosovës që Ferhat Draga të riarroset në Mitrovicë. Sepse, Ferhat Draga ishte një personalitet i madh, ndonëse shumë intelektualë e politikanë tanë nuk e dinë.

## QERIM LITA

*Fondacioni “Qendra e Civilizimit Islam” – Shkup*

### ORGANIZATA POLITIKE XHEMIJETI (BASHKIMI) 1919–1925

Nga prag të mbarimit të Luftës së Parë Botërore tokat shqiptare u pushtuan nga trupat ushtarake të fuqive fitimtare. Shqipëria e Mesme dhe një pjesë e madhe e veriut u pushtua nga trupat italiane, zona e Korçës mbahej nën pushtimin e trupave franceze, ndërsa trupat serbe, krahas Kosovës dhe krahinave lindore shqiptare, e pushtuan edhe Dibrën, Lumën dhe Hasin. Ripushtimi i këtyre tokave nga ushtria serbo-malazeze, përkatësisht ajo e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene (MSKS-së), ishte rrjedhojë e Traktatit të fshehtë të nënshkruar më 25 prill 1915 në Londër midis fuqive të Antantës dhe qeverisë italiane. Sipas pikës 5 të Traktatit, bregdeti shqiptar prej derdhjes së Bunës në veri e deri në derdhjen e Drinit në jug, përfshi edhe Shëngjinin, do t'i kalonte Serbisë dhe Malit të Zi<sup>3</sup>.

Në Konferencën e Paqes në Paris, gjatë muajit shtator-tetor 1919, ndodhën disa çështje me rëndësi për problemin shqiptar në përgjithësi, e për shqiptarët nën pushtimin e SKS-së, në veçanti. Udhëheqja e Mbretërisë së SKS-së shpresonte se Konferenca e Paqes do të vendosë pro marrëveshjes së fshehtë të Londrës, me çka – siç u tha më lart – thuajse e tërë Shqipëria Veriore i jepej Serbisë. Mirëpo, kjo shpresë u shua kur delegacioni i SHBA-ve në Konferencën e Paqes, i udhëhequr nga vetë presidenti Wilson, në mënyrë

---

<sup>3</sup> Qerim Lita, *Përpyjeket e Beogradit për copëtimin e Shtetit Shqiptar 1918-1921*, “Shenja”, Viti IX, Nr. 101, Shkup, shtator 2019, f. 31-38.

të qartë e të prerë e kundërshtoi copëtimin e Shqipërisë. Ministri i Jashtëm i Mbretërisë së SKS-së, Trumbiq, më 21 shtator të vitit 1919, u deklaroi anëtarëve të qeverisë së tij se SHBA-të e kundërshtojnë copëtimin e Shqipërisë dhe se kërkojnë, për një kohë të caktuar, një mandat ndërkombëtar për udhëheqjen e saj: *“...Nevojitet një maturi ndaj çështjes së Shqipërisë. Lidhur me Shqipërinë, vetë amerikanët e kanë parë se është e paafte të jetojë dhe të udhëheq me vetveten. Megjithatë ata e kundërshtojnë ndarjen e saj, atëherë vetvetiu shtrohet pyetja rreth mandatit për udhëheqjen me Shqipërinë. Për këtë nuk është e interesuar Anglia, e as Franca, ndërsa këtë e dëshiron Italia, prandaj tash për tash mundësitë janë shumë të mira për Italinë, megjithatë ne këtë e kundërshtojmë dhe bëjmë gjithçka për ta penguar...”*<sup>4</sup>.

Dy ditë më pas, Trumbiqi theksoi se delegacioni i qeverisë së SKS-së në Paris, në bisedimet e zhvilluara me përfaqësuesin e delegacionit të SHBA-ve, Xhonson, është dakorduar që “Shqipëria të mos preket territorialisht” në përjashtim, siç shprehet ai, “të disa përmirësimeve kah ne”, ndërsa nëse “i jepet mandati ndonjë shteti, atëherë neve (jugosllavëve – Q.L.) duhet të na jepet Shqipëria Veriore”<sup>5</sup>.

Ndërkohë, me insistimin e Fuqive të Mëdha, në radhë të parë të Francës, Britanisë së Madhe dhe SHBA-ve, delegacionit jugosllav në Paris iu kërkuar ta nënshkruajë sa më parë Konventën për Minoritetet. Lidhur me këtë, ministri Trumbiq, në mbledhjen e qeverisë, të mbajtur më 18 tetor 1919, bëri të ditur se përfaqësuesit e Francës, Anglisë dhe Amerikës para do dite kishin kryer demarsh

<sup>4</sup> Архив Југославије (АЈ), Ф. 20, *Записници са Седница Министраског Савета (18.08.1919 – 14.02.1920)*.

<sup>5</sup> По ату.

“që marrëveshja të nënshkruhet sa më parë” dhe se është informuar se “një Fuqi tjetër e Madhe” vepron që Konferenca e Paqes ta kryejë edhe një demarsh tjetër të ashpër ndaj delegacionit jugosllav që sa më parë ta nënshkruajë Konventën. Në mbledhje u kërkuar që në Konventë “të mos përfshihen Maqedonia dhe Kosova”, sepse – sipas ministrit Drashkoviç – “me këtë do të ruhet paqja në Ballkan, sepse atje vlon agjitimi i komitëve bullgarë dhe i kaçakëve shqiptarë...”. Në fund u soll konkluzioni me të cilin u kërkuar që në kuadër të marrëveshjes së minoriteteve “të mos përfshihet territori i ish Mbretërisë së Serbisë...”<sup>6</sup>, që nënkuptonte se shqiptarët dhe bullgaro-maqedonasit të përjashtoheshin nga të drejtat që ua mundësonte Konventa e Minoriteteve.

Në mbledhjen e njëjtë, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme, u vendos që organet policore e të xhandarmërisë, për një kohë të caktuar t’i ndërpresin të gjitha masat represive në ato krahina, ku vepronin anëtarët e Lëvizjes Kaçake. Në vend të kësaj u vendos që në ato krahina “të shkohet drejt paqësisht” me kaçakët dhe, me propozim të autoriteteve policore, atyre “t’u premtohet” se nuk do të “implementohet dënimi me vdekje e as që do të dërgohen para gjyqit” të gjithë ata të cilët dorëzohen brenda një kohe të caktuar<sup>7</sup>.

Po në këtë periudhë kohore, me nismën e Nexhip Dragës, Emin Beut, Aqif Blutës, Halim bej Derallës e disa atdhetarëve tjerë shqiptarë, u mor iniciativa për themelimin e një partie politike, e cila do t’i mbronte interesat e popullsisë “myslimane të Jugut”, përkatësisht të popullsisë shqiptare myslimane të Kosovës, Maqedonisë së sotme Veriore, Malit të Zi dhe të Sanxhakut. Është me

---

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Po aty.

rëndësi të vihet në dukje fakti se Beogradi zyrtar, asaj kohe, po-pullsinë myslimane e ndante në dy grupe: myslimanët e Bosnjës e Hercegovinës, të cilët i konsideronte për serbë të islamizuar dhe myslimanët e jugut, të cilët i konsideronte për shqiptarë dhe turq. Në fakt, gjithë popullsia myslimane në Kosovë, Sanxhak, Mal të Zi dhe Maqedoni ishte e përkatësisë etnike shqiptare, me përjashtim të pjesës lindore të Maqedonisë, ku pjesa dërmuese e popullsia myslimane i takonte përkatësisë etnike turke, përkatësisht turq-juruk, të cilët në ato vise ishin vendosur me ardhjen e Perandorisë Osmane në këtë pjesë të Gadishullit Ballkanik<sup>8</sup>. Marrë në përgjithësi, popullsia “myslimane e jugut” 90 për qind i takonte kombësisë shqiptare dhe 10 për qind kombësisë turke. Është me rëndësi të thuhet se kjo popullsi “myslimane” ishte përfshirë në projektet ogurzeza, të hartuara nëpër kuzhinat e Beogradit, sipas të cilave parashikohej dëbimi i dhunshëm i tyre nga trojet e veta për Turqi ose edhe në shtetin shqiptar, ndërsa në vend të tyre të vendoseshin kolonë sllavë, përkatësisht serbo-malazias<sup>9</sup>. Është për t’u theksuar fakti se, në kuadër të këtyre projekteve nuk ishte përfshirë popullsia myslimane e Bosnjës e Hercegovinës. Ishin pikërisht këto arsyt kryesore që në kuadër të Mbretërisë së SKS-së të formohen dy organizata të komunitetit mysliman: Bashkësia Fetare Islame e Bosnjës e Hercegovinës, e cila kishte një autonomi të plotë, që buronte nga kush-tetuta e miratuar që nga koha e Perandorisë së Austro-Hungarisë (qendra e saj ishte Sarajevë dhe me me të udhëhiqte Reis-ul-

<sup>8</sup> Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë – Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës, *Politika e Mbretërisë Jugosllave ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë 1929-1941*, Përmbledhje dokumentesh, përzgjedhjen, parathënien dhe redaktimin: Qerim Lita, Shkup – Prishtinë 2012, dok.nr. 50, f.188-189.

<sup>9</sup> Qerim Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë 1922-1941*, Përmbledhje dokumentesh, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë 2019, dok. nr. 4, f. 47-48.

Ulemaja) dhe Myftinia Supreme, në kuadër të së cilës përfshihej komuniteti mysliman i Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Sanxhakut. Qendra e kësaj të fundit ishte Beogradi, ndërsa me të udhëhiqte kryemyftiu, i cili njihej si Myftiu Suprem. Për dallim nga BFI-ja e Bosnjës e Hercegovinës, Myftinia Supreme, ishte nën varësi të plotë të Qeverisë së SKS-së, përkatësisht të Ministrisë së Fesë. Veprimtaria e saj mbështetej mbi një rregullore të miratuar gjatë vitit 1919, e cila në vitin 1920 kaloi në ligj. Sipas dispozitave të asaj rregulloreje, tërë pushteti ishte koncentruar tek Kryemyftiu dhe myftinj të qarqeve e të rretheve, të cilët emëroheshin nga ana e ministrit të Fesë. Në krye të këtyre institucioneve u emëruan njerëz më të besuar të pushtetit, siç ishin Hasan Rebac, udhëheqës i Dhomës Myslimane<sup>10</sup>, e cila funksiononte në kuadër të Ministrisë, Mehmet Zeki, Kryemyfti, dhe Mustafa Kulenoviç, sekretar i Ministrisë Supreme<sup>11</sup>, ndërsa Talat Selim ishte myfti i Myftinisë së Qarkut në Manastir, Xh. H. Mejliq ishte myfti i Myftinisë së Qarkut të Shkupit, Ali Riza ishte myfti i Myftinisë së Qarkut të Ohrit etj.<sup>12</sup>.

Këto, si dhe shumë shkaqe të tjera, e shtynë Nexhip Dragën, Emin Beun, Aqif Blytën, Halim bej Derallën dhe një plejadë të ulemave të atëhershëm shqiptarë, të marrin nismën për themelimin e organizatës politike “Xhemijet” (Bashkimi). Kuvendi themelues u mbajt më 18 dhjetor të vitit 1919 në qytetin e Shkupit. Në rrethanat e vështira që ekzistonin asokohe ajo u paraqit nën një mbulesë fetare dhe, në këtë kuadër, bashkëpunoi dhe i shtoi radhët edhe me përfaqësues të kombësive tjera. Në kuvendin themelues morën pjesë 64 delegatë dhe aty u miratua statuti e programi i saj. Kuvendi

---

<sup>10</sup> ДАРМ. I. 609. 2. 38/51.

<sup>11</sup> ДАРМ. I. 611. I. 1/1-7.

<sup>12</sup> ДАРМ. I. 611. I. 4/10-11.

Themelues zgjodhi Këshillin Qendror dhe Këshillin Mbikëqyrës. Kryetar i Këshillit Qendror u zgjodh Nexhip Draga nga Mitrovica, nënkryetar Sheh Sabedini nga Tetova, ndërsa sekretar Aqif Bluta nga Pazari i Ri<sup>13</sup>.

Partia “Bashkimi” u emërtua turqisht “Xhemijet”, kurse gazeta e saj, që botohej në gjuhën serbo-kroate dhe gjuhën e vjetër turke, u quajt “HAK” (E drejta). Përkundër asaj se gazeta botohej në këto dy gjuhë, ajo në fakt i mbronte interesat e popullsisë myslimane në përgjithësi në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi e në Sanxhak, si dhe të shqiptarëve mysliman në veçanti. Deri në qershor të vitit 1922 ajo dilte tre herë në javë, ndërsa nga qershori i atij viti u shndërrua në gazetë të përditshme. Gazeta pati një tirazh prej rreth 2500 ekzemplarësh. Pronar, përkatësisht sponsor kryesor i gazetës ishte z. Halit Ajdini nga Shkupi, i cili njëkohësisht ishte njëri ndër udhëheqësit e organizatës. Gazeta pati edhe stafin e vet drejtues: drejtor ishte Fahri Gjylbegoviq nga Shkupi, ndërsa Hasan Sabriu, nga Lugina e Preshevës, e mbante postin e kryeredaktorit të gazetës. Përveç tyre, gazeta i pati edhe bashkëpunëtorët e vet të rregullt, si Zejnel Ibrahimini – Strazimiri nga Shkupi me prejardhje nga Reka e Epërme, Ismail Qemali nga Manastiri, Hysen Hyseni nga Mitrovica etj.<sup>14</sup>

Në veprimtarinë e tij, Xhemijeti zhvilloi një politikë që i mbështeste interesat kombëtare e sociale të shqiptarëve dhe luftoi për të drejtat e tyre. Gjatë gjysmës së parë të vitit 1920, veprimtaria e Xhemijetit u shtri në të gjitha qarqet e rrethet ku kishte shqiptarë. Kjo u pa në zgjedhjet komunale, të cilat u mbajtën 22 gushtit 1920,

<sup>13</sup> *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëllimi II, Tiranë 2019, f. 600.

<sup>14</sup> AJ. 14. 76/32.



me ç'rast Xhemijeti arriti të dalë si parti fituese në 55 komuna<sup>15</sup>. Ndërkohë, në zgjedhjet parlamentare për Asamblenë Kushtetuese të Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene, që u zhvillua më 28 nëntor 1920, Xhemijeti arriti të paraqitej me listën e vet të veçantë zgjedhore dhe i fitoi 8 deputetë.

Krerët udhëheqës të Xhemijetit së shpejti vendosën lidhje me udhëheqjen e Komitetit të Kosovës me seli në Shkodër, si dhe me anëtarët e Lëvizjes Kaçake, e cila konsiderohej si krahu luftarak i Komitetit të Kosovës, në krye të së cilës qëndronin atdhetarët dhe ushtarakët e shquar shqiptarë të kohës, si: Bajram Curri, Hysni Curri, Azem Bejta, Sadik Rama, Idriz Seferi, Beqir e Musli Smajli, Adem Bulku, Elez Isufi, Dan Cami, Miftar Kaloshi, Osman e Zenel Lita, Islam Spahia, Arif e Ibish Metaj, Kalosh Dani, Jetish Budakova, Adem Reçaku, Ukë Sokoli, Selman Oruçi, Kol Delia e shumë të tjerë<sup>16</sup>.

Në fillim të vitit 1920 udhëheqja e Xhemijetit vendosi bashkëpunim me Partinë Radikale Serbe, me shpresë se përmes këtij bashkëpunimi do të mund ta realizojë më lehtë programin politik të vetin, i cili përfshinte disa pika, dy prej të cilave ishin më me rëndësi: hapja e shkollave me mësim në gjuhën shqipe dhe problemi i reformës agrare. Lidhur me pikën e parë u arrit marrëveshje e shkruar midis Xhemijetit dhe Partisë Radikale, përmbajtja e së cilës është si më poshtë vijon:

*“a/ Në viset Jugore, ku popullsia myslimane është shumicë ose ku fëmijët myslimanë janë në numër të njaftueshëm të paraparë për hapjen e shkollave fillore sipas Ligjit për Shkollat Kombëtare, do të*

---

<sup>15</sup> Po aty, f. 601.

<sup>16</sup> Q. Lita, *Përpjekjet e Beogradit për copëtimin e Shtetit Shqiptar 1918-1921...*, po aty.

*hapen shkolla fillore myslimane, të cilat do të jenë nën barrën e buxhetit të shtetit, ashtu dhe po aq sa janë nën barrën e buxhetit të shtetit edhe shkollat e tjera fillore ortodokse.*

*b/ Në vendet ku popullsia myslimane është pakicë ose ku nuk ka nxënës të mjaftueshëm myslimanë për hapjen e shkollave fillore myslimane, vetë myslimanët mund të hapin shkolla fillore myslimane me shpenzimet e tyre, por plan-programi mësimor dhe gjithçka tjetër do të jetë sipas Ligjit për Shkollat Kombëtare.*

*c/ Në Shkup të hapet një shkollë normale myslimane me shpenzimet e shtetit<sup>17</sup>.*

Lidhur me pikën e dytë të programit Xhemijeti insistonte që të njihej prona private tokësore e garantuar deri në 30 hektarë. Sipas tyre, prona tokësore mbi 30 hektarë të mund të përdorej në këtë mënyrë: 75 për qind ta përfitonin vendësit pa tokë, ndërsa 25 për qind të mund të përdorej për nevoja të kolonizimit. Gjithashtu u kërkua që ndarja e tokës, me ligjet e reja, të mos bëhej pa u plotësuar fillimisht nevojat e fshatarëve vendas<sup>18</sup>. Për këtë çështje një delegacion i Xhemijetit, në fillim të muajit prill të vitit 1921, zhvilloi negociata me kreun e Partisë Radikale Serbe, Nikolla Pashiq. Rrjedhimisht, Pashiqi më 5 prill të atij viti, në cilësinë e kryeministrit, përmes një shkrese u drejtohet deputetëve të Xhemijetit me sa vijon:

*“Z.Z. Deputetëve Myslimanë nga viset Jugore – Beograd*

*Lidhur me bisedimet, që i pata zhvilluar këtyre ditëve me Ju në lidhje me dispozitat kushtetuese për zgjidhjen e marrëdhënieve*

<sup>17</sup> AJ. 80- 20/496-497.

<sup>18</sup> Hakif Bajrami, Kosova. Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë (1918-1941)... (Prishtinë: 2017), f. 196, 197.

*agrarë, në cilësinë e Kryetarit të Qeverisë kam nderin t'u deklaroj Juve si më poshtë:*

*1) Çështja agrare në viset jugore do të zgjidhet në principet e njëjta dhe në mënyrën e njëjtë sikurse ajo do të zgjidhet në Bosnjë e Hercegovinë, ndërsa në kuptimin e dispozitave paraprahe për përgatitjen e reformës agrare nga 25 shkurti i vitit 1919.*

*2) Se pronarët e tokave në cilësinë e çifçi-saibive e cilësive të ngjashme do të marrin dëmshpërblimin që ua garanton shteti, dhe*

*3) Qeveria është e gatshme të bëjë pagesën e rentës së nevojshme për pronarët e prekur edhe para zgjidhjes përfundimtare të çështjes agrare*<sup>19</sup>.

Sëmundja dhe, më pas, vdekja e Nexhip Dragës (1921) shkaktoi një përçarje më të thelluar brenda kreut më të lartë të organizatës. Kjo u pa në Kongresin e Dytë të Xhemijetit, i cili u mbajt në shtator të vitit 1921 e në të cilin u forcua ndikimi i krahut pa identitet të qartë kombëtar. Në këto rrethana, Xhemijeti, për afër gjashtë muaj, mbeti i përçarë, gjë që e dëmtoi rëndë organizimin politik të shqiptarëve nën Mbretërinë e SKS-së. Në këto rrethana, për t'i kapërcyer përçarjet në parti, kryesia e Xhemijetit dhe, në mënyrë të veçantë, Ferhat Draga, Xhemajl Agushi dhe Nazim Gafuri, me mjaft autoritet në popull, më 4 prill 1922, e ftuan Kongresin e Tretë të Partisë. Në vend të çështjeve të pjesshme, të paraqitura nga ata që ndiqnin politikën serbe, Kongresi shtroi kërkesa që i takonin popullsisë shqiptare të të gjitha viseve. Në Kongres u miratua një dokument në të cilin kërkohej që të gjithë "muhaxhirëve", të dëbuar nga pronat e veta me dhunë, t'u lejohej kthimi pa kushte. Pronat e grabitura nga kolonët dhe pronat e shtetëzuara duhej t'u

---

<sup>19</sup> AJ. 80- 20/535.

ktheheshin pronarëve të ligjshëm. Në të kërkohej që t’u kthehej toka atyre që i kishin tapitë. Me miratimin e këtyre kërkesave, u forcuan pozitat e “krahut kombëtar” të Xhemijetit, me në krye Ferhat Dragën, Nazim Gafurin, Xhemajl Agushin, Aqif Blutën e Halim bej Derallën. Nën ndikimin e tyre dokumentin e sipërpërmendur e nënshkruan edhe udhëheqës të tjerë të kësaj partie. Me afrimin e pjesëtarëve të të dy krahëve, Xhemijeti, si parti politike, u bë më homogjene dhe paraqiti në skenën politike qëndrime më të qarta.

Falë veprimtarisë së Ferhat Dragës e bashkëpunëtorëve të tij më të ngushtë, Xhemijeti faktikisht u shndërrua në një institucion të vetëm, i cili i mbronte interesat e popullsisë myslimane, përkatësisht të shqiptarëve myslimanë, si dhe të pakicës turke, e cila – siç u tha më lart – shtrihej në pjesën lindore të Maqedonisë së sotme të Veriut. Pra, popullsia tjetër myslimane e këtyre krahinave, përfshi edhe Sanxhakun, i përkiste kombësisë shqiptare. Ndonëse sot popullsia myslimane e Sanxhakut, me përjashtime të vogla, e ka humbur gjuhën e të parëve të tyre dhe ata sot ndjehen boshnjakë, faktet e dokumentuara vënë në dukje se ajo popullsi, si për nga gjaku, ashtu edhe për nga tradita, është shqiptare. Vet sanxhaklinjtë deri në vitin 1945 deklaroheshin si shqiptarë dhe si të tillë ata merrnin pjesë në të gjitha lëvizjet politike—ushtarake shqiptare siç ishin Lëvizja Kaçake, Komiteti për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, Xhemijeti, Lidhja II e Prizrenit etj. Kryetari i Misionit të Jashtëzakonshëm Shkollor të Kosovës, Ali Hasharova, më 19 shtator të vitit 1941 i raportonte ministrit të Arsimit, Ernest Koliqi, për jehonën e madhe që pati te popullsia shqiptare në Kosovë, veçmas në Jeni Pazar (Pazar të Ri), hapja e kurseve verore të gjuhës shqipe nga ana e Ministrisë së Arsimit Kombëtar Shqiptar:

*“...Jeni–Pazari, krahina më e largët e më e veçuar e Kosovës, krahina që ruan me fanatizëm kujtimin e origjinës së saj shqiptare e karakteristikat shpirtërore e fizike, por që, siç përmendëm sipër, fatkeqësisht ka humbur gjuhën amtare, kishte mbetur pezull, nuk diresh kujt do t’i takonte. Ishte frikë se mos i ngjitesh Malit të Zi. Populli duke mos dashur në asnjë mënyrë të bashkohet me Malin e Zi, ishte ndarë në dy pjesë. Njëra pjesë, me nacionalistin e shquar shqiptar në krye, Zotin Aqif Bluta, donte t’a lidhte fatin e krahinës me atë të Mitrovicës, e cila shpresohesh se do t’i lihesh Shqipërisë; kurse pjesa tjetër, për të shpëtuar nga Mali i Zi, kishte vendosur të përpiqesh për t’u bashkuar me Kroacinë. Në kohën kur vajtëm ne në Jeni–Pazar për të shikuar në kishte mundësi për të çelur ndonjë kurs qytetin e gjetëm të stolisur me flamurin kombëtar, kafën e madhe të qytetit të emëruar ‘Kafe Skënderbej’, gjindarmërin me shkambë dykrenore në krahë të djathtë e me kurorën e Skënderbeut mbi fesin e kuq, gjithë shenja që na mbushte zëmrat me gëzim; por me gjith këto një komision 5–6 vetash ishte nisur për Kroaci për t’u marrë vesh që Jeni–Pazari të bashkohet me atë. Mirëpo vajtja jonë atje, dërgimi i shpejtë i 2 mësuesve dhe entusiasmi që ngjalli çelja e kursit në atë vënd, e lartësoi shpirtërisht dhe e forcoi aq tepër pjesën që donte të mbetesh e lidhur me Mitrovicën, sa që kjo pjesë morri krejt fuqinë në dorë duke e imponuar përfundimisht pjesën tjetër kundërshtare. Dhe kështu Jeni–Pazari, ky qytet i djegur për Shqipërinë, mbeti i lidhur me Mitrovicën dhe po gëzon të drejtat minoritare që i janë dhënë Mitrovicës, Vuçiternës e Podujevës...”<sup>20</sup>.*

---

<sup>20</sup> Tokat e lirura, Përmbledhje dokumentesh, përzgjedhjen, përkthimin, redaktimin dhe hyrjen, Qerim Lita, Logos-A, Shkup, 2016, dok. nr. 658, f. 137-141.

Këtu shihet qartë roli dhe kontributi i jashtëzakonshëm i Aqif Blutës, i cili dikur – së bashku me vëllezërit Draga dhe atdhetarët tjerë – i printe organizatës Xhemijet, që përbën dëshminë më të fuqishme për frymën kombëtare të kësaj organizate. Sipas Dr. Rexhep Krasniqit, tërë popullsia myslimane e Sanxhakut lidhej ngushtë me fisin Hot, fisin siç shprehet ai “të fortë t’Alpeve Veriore Shqiptare”, i cili fatkeqësisht “*nuk ka mujt me i shpëtue sllavizimit total...*”<sup>21</sup>.

Në zgjedhjet parlamentare të 18 marsit 1923 Xhemijeti arriti një fitore tjetër: fitoi 14 deputetë. Gjatë fushatës zgjedhore shqiptarët shpërfaqën përkatësinë kombëtare kundër mohimit të saj nga propaganda e qarqeve serbomëdha, të instaluara brenda Myftinisë Supreme me seli në Beograd. Përveç kësaj, zgjedhjet dëshmuuan qartë se shqiptarët, edhe në këtë periudhë, e njihnin si qendër të tyre politike e kulturore Shkupin. Pjesëmarrja e shqiptarëve në zgjedhje nxori edhe një herë qartë hartën e shtrirjes së tyre demografike brenda vijës Pazari i Ri, Mitrovicë, Llap, Bujanoc, Kumanovë, Shkup, Tetovë, Manastir, Prespë<sup>22</sup>.

Pa dyshim se ky bashkim dhe ky përforsim i Xhemijetit nuk u shkonte përshtati qarqeve të atëhershme serbomëdha, të cilat bënin çmos që të krijonin përçarje brenda strukturave udhëheqëse të organizatës. Është me rëndësi të theksohet fakti se rol të rëndësishëm në homogenizimin e organizatës pati organi informativ i saj, përkatësisht gazeta “HAK”, e cila – siç u tha më lart – nga qershori i vitit 1923 u bë gazetë e përditshme. Ajo, përmes shkrimeve të veta, hidhte poshtë çdo dezinformatë që plasohet nga shtypi i atëhershëm serb, se gjoja brenda strukturës së Xhemijetit ekzistonte

<sup>21</sup> Po aty. dok. 666. F. 152-156.

<sup>22</sup> *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, f. 604.

përçarje, se jo të gjithë e mbështesin politikën e Ferhat Dragës etj. Ministri i Punëve të Brendshme, në pjesën e parë të muajit korrik të vitit 1923, e urdhëronte Zhupanin e Madh të Shkupit, Axhedo-viq, të kryejë kontroll të rreptë ndaj gazetës. Ky i fundit, më 6 korrik të vitit 1923, e angazhoi avokatin nga Beogradi, Mirko Munjeviq, që të bëjë përkthimin nga gjuha osmane në gjuhën serbe të dy numrave të fundit të “Hak”-ut, nr. 563 dhe 564 të datës 5 dhe 6 korrik 1923. Një ditë më pas, avokati Munjeviq i raportonte Zhupanit të Shkupit me sa vijon:

*“Pas leximit të dy numrave të HAK–ut, nr. 563 dhe 564 nga data 5 dhe 6 korrik 1923, kam nderin ta njoftoj udhëheqjen se në numrin e parë në artikullin hyrës flitet shumë se si deputetët e popullit, të Xhemijetit, i kryejnë detyrat e veta me vetëdije dhe me krenari e harmoni për zgjedhësit myslimanë dhe i demanton të gjitha zërat, përfshirë edhe shkrimin e ‘Politikës’ se ekziston përçarje dhe mos-pajttime midis udhëheqësit të ‘Xhemijetit’, Qenan Zija Beut dhe Ferhat Beut. Përkundrazi, ata – sikurse të gjithë deputetët e ‘Xhemijetit’ – janë të njëzëshëm dhe të bashkuar në programin e tyre, që është në shërbim të zgjedhësve të tyre myslimanë.*

*Artikullin i dytë i numrit të njëjtë të HAK–ut me kënaqësi dhe gëzim e publikon konstituimin e Nënkëshillit të ri të Xhemijetit në Mitrovicën e Kosovës dhe nëpër fshatrat e rrethit të Shkupit: Luboten – komuna e Lubancës, Konjare e Poshtne – komuna e Sushicës, Maranë – komuna e Draçevës, Çajlanë – komuna e Çajlanës, ku është bërë konstituimi i organizatës së Xhemijetit dhe në secilin fshat janë zgjedhë nga tre persona: kryetari, arkëtari dhe sekretari (anëtari), të cilët do ta bëjnë organizimin e këshillave të Xhemijetit.*

*Në artikullin e tretë thuhet se është e sigurt se deputetët e ardhshëm të Xhemijetit, do ta braktisin Kuvendin dhe do të abstenojnë nga*

*parlamenti për arsye se Qeveria nuk i merr parasysh parashitë e tyre në pengimin e hajnisë dhe çrregullimeve dhe joligjshmërive të tjera ndaj popullsisë myslimane në Krahinat Jugore – të Qarkut të Serbisë.*

*Në numrin e dytë në lajmet ditore të vendit me kënaqësi dhe gëzim njoftohet për organizimin e organizatës myslimane Xhemijeti dhe konstituimin e këshillave me nga tre anëtarë, që u theksua në sipër edhe në këto fshatra të rrethit të Shkupit: Cvetovë – komuna e Dërzhillovës, Satapet – komuna e Govërlevës, Nigishtan – komuna e Kuçkovës, Arnaqi – komuna e Çajlanës, Bukoviq – gjithashtu komuna e Çajlanës.*

*Nën ¼ dhe ½ po ua kthej numrat e porositur të HAK–ut.*

*7 korrik 1923*

*Avokat Mirko M. Munjeviq*<sup>23</sup>.

Po atë ditë, Zhupani i Shkupit i shkruante ministrit të Brendshëm se “ditët e fundit vërehet një veprim” më aktiv i Xhemijetit”, që ky aktivitet – sipas tij – shihej nga shkrimet e vetë gazetës së Xhemijetit “HAK”<sup>24</sup>. Duhet të vëmë në dukje faktin se, përkundër këtij presioni, gazeta “HAK” e vazhdoi politikën e saj redaktuese, duke e afirmuar dhe kultivuar ndjenjën kombëtare të popullsisë shqiptare në Kosovë e në trevat e tjera shqiptare nën pushtimin e SKS–së. Ishin pikërisht këto arsye kryesore që autoritetet e atëhershme serbomëdha të sjellin vendim me të cilin ndalohej botimi i mëtutjeshëm i kësaj gazete. Kjo ndodhi më 19 nëntor të vitit 1919, kur Zhupani i Shkupit e ndaloi botimin e mëtutjeshëm të gazetës.

<sup>23</sup> AJ. 14-76/33-34.

<sup>24</sup> Po aty.



Vendimi në fjalë, me shkresën nr. 14992, iu komunikua Ministrisë së Brendshme, në të cilën thuhej shprehimisht:

*“Me vendim të Zhupanisë nga 19 nëntor k.v. është ndaluar gazeta e këtushme ‘HAK’, nr. 938 nga 19 i këtij muaji. Vendimi për ndalesë do i dërgohet gjyqit të shkallës së parë të këtushëm për vendosje”<sup>25</sup>.*

Është me rëndësi të thuhet se një akt i tillë arbitrar, i kryer nga ana e Zhupanit të Shkupit, kundër gazetës “HAK”, që përbënte dritaren e vetme informative për popullsinë shqiptare në Kosovë e në trevat tjera shqiptare nën pushtimin e SKS-së, përbënte vazhdimin e politikës antishqiptare të udhëheqjes së atëhershme të Shkupit, e cila pa dyshim se dirigjohej nga Beogradi. Paraprakisht, udhëheqja e qytetit të Shkupit e rrënoi xhaminë Burnali. Rrënimin e xhamisë më të madhe të këtij qyteti, që ndryshe njihej si “Bukuroshja e Shkupit”, që gjendej në anën e djathtë të Vardarit, erdhi si rrjedhojë e Planit Rregullativ për Qytetin e Shkupit, i cili qe miratuar nga ministri i Ndërtimitarisë me vendimin nr. 36994 të datës 30 nëntor 1922<sup>26</sup>. Realizimi i këtij plani filloi më 6 qershor të vitit 1924, kur Gjyqi Komunal i Shkupit, me shkresën nr. 18245, e njoftonte Myftininë e Shkupit se një hap i tillë duhej të ndërmerrej “për shkak zbukurimit të asaj pjese të qytetit” dhe “për shkak se në një pjesë të atij trualli, i cili ishte pjesë përbërëse e oborrit të xhamisë, do të ndërtohej objekti monumental Shtëpia e Armatës”. Nisur nga kjo: “Gjyqi ka nderin ta lusë Myftininë e Qarkut, për një përgjigje urgjente, se në cilën mënyrë, kuptohet miqësore, mundet dhe dëshiron që këtë truall, për të cilin Gjyqi ka të drejtë sipas dispozitave ligjore ta merr dhe t’ia dorëzoj komunës”. “Lënda është urgjente dhe nuk duron shtyrje – thuhej më tej në shkresë – sepse

---

<sup>25</sup> Po aty.

<sup>26</sup> Qerim Lita, *Shenjat Kohës*, Konica Press, Shkup, 2019, f. 84.

*duhet menjëherë të kryhet, ndërsa Myftynisë i kanë ngel tre ditë afat për t'u përgjigjur, pas të cilit afat Komuna do ta shfrytëzojë të drejtën që ia mundëson neni 3 pika 1 dhe 2 nga Ligji për marrjen e pronësisë së patundur private për nevojat e përgjithshme populllore*<sup>27</sup>. Në përgjigjen e Myftinisë së Qarkut të Shkupit thuhej: *“Në lidhje me shkresën e Gjyqit të Komunës nga 6 qershori 1924 nr. 18245 në lidhje me eksproprijimin dhe rrënimin e xhamisë Burmali në Shkup, kam nderin t'u njoftoj se kjo myftiniu ftoi Këshillin e Vakëfit dhe Mexhlisin e Xhematit, të cilët kanë qëndruar në pikëpamjen se kjo xhami nuk parqet pronë private, por pronë shoqërore, e cila shërben për qëllime fetare dhe se mendimi i opinionit publik të qytetarëve të fesë myslimane nuk pranon që në asnjë mënyrë kjo xhami të rrënohet*<sup>28</sup>.

Një ditë më vonë, Gjyqi i Komunës së Shkupit solli vendim me të cilin lejohej rrënimi i xhamisë, ku thuhej se nëse këtë refuzon ta bëjë Myftinia, në atë rast *“ajo do të kryhet nga vetë komuna*<sup>29</sup>. Menjëherë pas kësaj u bë rrënimi i dhunshëm i xhamisë, një akt i cili e revoltoi tej mase popullsinë myslimane të këtij qyteti e më gjerë. Lidhur me këtë akt arbitrar e tejet të shëmtuar, në Promemorien e klerit katolik shqiptar të Kosovës, dërguar sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, Erik Dramondit, ndër të tjera thuhej: *“....Ka qenë eksproprijuar xhamia e madhe ‘Burmali’ të qytetit të Shkupit pa pëlqimin e komunës dhe pa as çfarë dëshmipërblimi. Në vendin e saj është ndërtuar Shtëpia e Armatës. Ka mundësi që pëlqimi të jetë dhënë nën kërcënimin e gjenral Terziçit, i cili lidhur me këtë që më parë e kishte shprehur*

---

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> Po aty, f. 85.

<sup>29</sup> Po aty.

*mendimin e tij: ose një milion dinarë, ose dy bomba që të ngrihet xhamia në ajër...*<sup>30</sup>.

Një projekt tjetër antishqiptarë, që asaj kohe u iniciua nga push-tuesit serbomëdhenj gjithsesi se ishte hapja e Medresesë së Madhe në Shkup, e cila mori emrin “Mbreti Aleksandër I”. Kjo shkollë financohej nga shteti dhe si e tillë e pati statusin e njëjtë me shkollat e tjera të mesme shtetërore. Tërë kuadri edukativo-arsimor (përveç drejtorit Mehmetbashiq – një boshnjak i serbizuar), i përkiste kombësisë së krishterë serbe, përkatësisht ruse<sup>31</sup>. Këtë më së miri e sqaronte elaborati i këshilltarit të Ministrisë së Arsimit, Dragoslav Jovanoviq, hartuar më 14 korrik të vitit 1930, në të cilin shprehi-misht thuhej: “Për të ndihmuar që elementet myslimane nëpërmjet rrugës së arsimit dhe progresit të futen në rrugën e vërtetë, që të krijohet kleri i ri mysliman i edukuar në shkollën dhe frymën e kulturës sonë (serbe – Q.L.), nevojave tona shtetërore dhe aspiratave e idealeve tona nacionale, për ta paralizuar aksionin e huaj propa-gandues në mesin e elementeve shqiptare e turke, për ta përshpejtuar procesin e asimilimit të këtyre elementeve dhe me këtë të ndihmohet në konsolidimin e çështjeve në këto vise, si vendim më i përshtatshëm i zgjidhjes së çështjes u pa në themelimin e shkollës së Medresesë së Madhe në Shkup.. Mirëpo, disa elemente shqiptare e turke nuk ju pëlqen puna dhe edukata që po zbatohet në këtë shkollë sepse shumicës së tyre nuk ju konvenon që në atë shkollë përveç drejtorit nuk ka asnjë arsimtarë ose edukator të besimit isl-lam, por të gjithë janë ortodoksë të vërtetë, serbë ose rusë... Pastaj

<sup>30</sup> Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë – Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës, po aty, dok. nr. 16, f.101-137.

<sup>31</sup> Po aty, f. 37-38.

*fëmijët këtu mësimin e zhvillojnë në gjuhën serbe dhe në tërësi e pranojnë kulturën jugosllave..*<sup>32</sup>.

Ishin pikërisht këto ndër arsytet kryesore që numri i nxënësve shqiptarë të jetë aq i vogël, ndërsa këtu duhet shtuar edhe fushatën e Ferhat bej Dragës e të Atulla Hoxhës, të zhvilluar që në vitin e parë shkollor 1924/25 kundër regjistrimit të nxënësve shqiptarë në atë shkollë. Në informatën e Shtabit të Përgjithshëm të Armatës Jugosllave, dërguar Ministrisë së Fesë në Beograd, vihej në pah se politikanët shqiptarë, në krye me Ferhat Dragën e Atulla Hoxhën: *“..zhvillojnë agjitacion në Shkup e më gjerë që myslimanët mos t’i regjistrojnë fëmijët e tyre në Medresenë e Mbretit Aleksandërit, sepse boshnjakët do t’i serbizojnë..*<sup>33</sup>.

Kulmi i politikës antishqiptare ndodhi në prag të zgjedhjeve parlamentare të caktuara për më 8 shkurt 1925, kur u burgos Ferhat bej Draga, ndërsa disa drejtues tjerë u vranë, si Nazim Gafuri etj.. Me këto përndjekje të Qeverisë mori fund veprimtaria e hapur e organizatës ose partisë Xhemijeti<sup>34</sup>. Ndaj këtij sulmi barbar të Beogradit zyrtar kundër organizatës politike Xhemijet dhe krerëve të saj, në promemorien e përmendur më lart të klerit katolik të Kosovës, thuhej: *“...Partia politike, e cila u formua nën udhëheqjen e Ferat bej Dragës – kryetar, duhej të dilte në zgjedhjet parlamentare me listë prej 14 kandidatësh. Këta kandidatë, me njëte dhe metoda të ndryshme, u penguan të paraqiten para votuesve në ditën e votimit. Shumë prej tyre qenë detyruar me forcë të ngelin në shtëpitë e tyre. Në protestën e tyre pushtetarët janë përgjigjur se këto masa janë*

<sup>32</sup> AJ. 1.66.Пов.Бр.21938, 16 јули 1930 године у Београду.

<sup>33</sup> AJ.1.110. Пов.Бр. 2218, 21.III.1925 год., Београд.

<sup>34</sup> *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëllimi II, Tiranë 2019, f. 605.

Po aty; shih edhe *Kosova – vështrim monografik...*, f. 230; *Historia e Popullit Shqiptar...*, vëll. III, f. 473; etj.

*marrë vetëm për mbrojtjen e tyre, sepse në të kundërtën jeta e tyre ishte në rrezik. Kjo përpjekje përsëri nuk ngeli pa pasoja për ata që morën guximin ta fillojnë atë aksion nën pretekste të ndryshme. Secili që dënuar. Kryetari Ferat bej Draga mori 4 vjet burg, Nazim Gafuri u plagos e pastaj u vra para stacionit të xhandarmërisë në Prishtinë, Ramadan Fejzullau u dënuar, ndërsa të tjerëve iu konfiskua pasuria dhe, më në fund, secili e mori pjesën e tij...<sup>35</sup>.*

Ngjashëm si kleri katolik i Kosovës shprehet edhe Gajur bej Dera-lla, i cili në rrëfimin e tij kushtuar çështjes shqiptare midis dy luftërave botërore, në pjesën ku bën fjalë për Xhemijetin, shprehet: *“...Gjatë kohës së ish Jugosllavisë si trup politik mysliman në parlament ekzistonte ‘Bashkësia Myslimane Xhemijet’ e cila në pikat më të rëndësishme të programit të saj nga shteti i atëhershëm kërkonte hapjen e shkollave filllore në gjuhën amtare shqipe. Lejimi i debatit në parlament më dha shpresë se herdo-kurdo do të lejohet krijimi i shkollave, por për fatin e keq kjo nuk ndodhi. E njëjta u eliminua, ndërsa ne shqiptarët ngelëm në të drejtat se mund të shkollohemi në shkollat jugosllave dhe nëpër mejtepet e organizuara nga ana e Mexhllisit të Ulemasë... Me propozimin tim u pajtuan të gjithë që në mbrëmje të mbajmë një konferencë me pjesëmarrjen e të gjithëve në hotelin ‘Çajtores’. Në atë mbledhje ishin prezent, nga Tetova: Baba Qazimi, Sherif Mina, përndryshe deputet i Tetovës, hoxha Ahmet Efendiu dhe Nexhmedin Besimi..., nga Struga Remzi Beu, i quajtur ‘enciklopedia e kombit tonë shqiptar’. Atë (Remziun) e njihja shumë mirë që në kohën e luftës politike të partisë me forcë të emërtuar Xhemijet dhe e njihja si një mendimtar i Nexhip Dragës, Ferhat Dragës, Halim Derallës, Hamdi dhe Inajet*

---

<sup>35</sup> Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë – Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës, po aty.

*Ohri me shokët të cilët që asaj kohe kërkonin kthimin e tokave shqiptare të konfiskuara me Reformën Agrare, të drejtën e shkollimit të shqiptarëve në gjuhën amtare fillore e të mesme, ndërprerjen e shpërnguljes për në Turqi. Kur në shtëpinë tonë e cila tash është spital e kritikoi në mbledhje bashkëmundimtarin e tij Ferhat Dragën për paraqitjen e tij tepër të nervozuar, kundër Ninçit /nëse nuk gaboje, me atë rast Ferhat Draga iu përgjigj Ninçit me nervozë: ‘ne nuk do të presim derisa ju nuk i qetësoni shpirtrat në kuvendin kombëtar, gjendja e shpirtrave tuaj nuk na tregon neve, i kërkojmë të drejtat tona’, dëshmonin Ferat Draga së bashku me vëllanë tim/. Sipas Remzi Beut: ‘në rastin e parë, shteti do të përpiqet që me çdo kusht t’i rrënojë, prandaj nuk është dashur atë ta bëjnë’. Ashtu edhe ndodhi, në zgjedhjet e vitit 1925, megjithëse përfaqësuesit tanë nëpër Kosovë e Maqedoni, fituan në zgjedhje, kjo e drejtë iu pamundësua, duku u thënë se ata nuk janë të dhëna të sakta, pastaj duke i përdorur bajonetat e xhandarmërisë me të vetmin qëllim t’i rrënojnë ata, njëri ndër ata ishte edhe Shaip Pirroku, kundër Halim Derallës...’<sup>36</sup>*

Pas shpërbërjes së Xhemijetit, shqiptarëve iu ndalua e drejta e përfaqësimit në parlament nëpërmjet ndonjë partie të veçantë shqiptare, por kjo mundësohej vetëm nëpërmjet partive të ndryshme serbe, siç ishin në atë kohë “Partia Radikale” ose “Partia Demokratike”.

---

<sup>36</sup> *Tokat e liruarat...*, vëllimi III, dok.nr. 599, f.377-412.

**NURIDIN AHMETI**

*Instituti Albanologjik – Prishtinë*

## **“XHEMIJETI” – NJË ZË I ARTIKULUAR NË MBROJTJEN DHE AVANCIMIN E TË DREJTAVE NACIONALE TË SHQIPTARËVE NË MBRETËRINË SKS**

Në vitin 1919 në Shkup, nën udhëheqjen e vëllezërve Draga, Nexhip e më pastaj Ferhat Draga, ishte themeluar organizata politike “Xhemijeti”. Emri i saj i plotë ishte *”Islam Muhafaza-yl Hukuk Cemijet”*, ndërsa përkthimi i saj në gjuhën shqipe është *“Shoqatë Islamike për Mbrojtje dhe Drejtësi”*.

Pas vitit 1945, në ish-Jugosllavi, e rrjedhimisht edhe në Kosovë, periudha e Mbretërisë Serbo –Kroato–Sllovene dhe e institucioneve të themeluara në atë periudhë, u përshkruan përgjithësisht me tone negative, shumë herë pa bërë asnjë dallim ndërmjet një institucioni të themeluar në atë periudhë dhe pushtetit të kohës.

Së këndejmi, edhe Xhemijeti, si një organizatë e themeluar në këtë periudhë, u trajtua me shumë nga prizmi religjioz, duke u bazuar në emrin e saj, të imponuar nga rrethanat politike të kohës, dhe u anashkalua kontributi i kësaj organizate në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve kundrejt pushtetit të atëhershëm.

### ***Disa mendime rreth “Xhemijetit”***

Disa studiues të kësaj organizate, herë–herë, i dhanë edhe epitetet si “antikombëtare” etj. Kështu ndodhi në vitin 1985 në Prishtinë, kur u mbrojt tema e doktoratës në Universitetin e Prishtinës

me titull: “*Formimi dhe veprimtaria e partive politike borgjeze në Kosovë në vështrim të veçantë për Xhemijetin*”. Kjo doktoratë, për aq sa ne jemi në dijeni, nuk e pa dritën e botimit deri me sot. Por, të tilla mendime, tek ne, mund të hasen edhe sot e kësaj dite nga disa profesorë universitarë.

Por, jo të gjithë studiuesit tanë e kanë përkrahur mendimin e shfaqur në punimin e lartpërmendur të doktoratës, se kjo organizatë ishte borgjeze, antikombëtare etj. Ka edhe nga studiuesit tanë, si Hakif Bajrami e Muhamet Pirraku, që në kur flasin për këtë organizatë dhe veprimtarinë e saj, nuk pajtohen me konstatimet që jepen në atë punim doktorate. Ata, pra Hakif Bajrami, qysh në vitet e ‘80-ta, dhe Muhamet Pirraku, në vitet e ‘90-ta, ishin të mendimit se Xhemijeti, organi i saj “Hak” dhe drejtuesit e saj i mbrojtën të drejtat e shqiptarëve dhe e ngritën zërin kundër padrejtësive të pushtetit të atëhershëm ndaj popullatës së shtypur shqiptare.

Se “Xhemijeti” ishte organizatë e cila luftoi për avancimin e të drejtave të shqiptarëve në Mbretërinë Serbo–Kroato–Sllovene këtë e thonë troç edhe albanologët e huaj në veprat e tyre, si Noel Malcolm, Robert Elsie e Oliver Shmit.

Megjithatë, kontributet shkrimore për këtë organizatë, në përgjithësi, mbeten në nivelin e punimeve publicistike, të mendimeve në kuadër të ndonjë monografie etj.

Përgjigjen me të plotë rreth disa hamendësimeve në lidhje me veprimtarinë e kësaj organizate, të interesuarit do ta marrin në vitin 2017, përmes monografisë së shkruar dhe vëllimit me dokumente të studiuesit Dr. Skender Asanit me titull: “*Veprimtaria e organizatës politike Xhemijeti në trevat lindore (1919 – 1925)*”, të botuar nga Shtëpia Botuese “Logos–A” në Shkup. Studiuesi, dr. Skënder Asa–



ni, duke shfrytëzuar një mori burimesh arkivore të hulumtuara në arkivat rajonale dhe më gjerë, literaturën e botuar rreth kësaj organizate, shtypin e kohës etj., sjell konstatime bindëse, se kjo organizatë, e themeluar para 100 vjetësh me mbështetjen intelektuale të Nexhip e Ferhat Drages, Nazim Gafurrit etj., në mbështetje të orgaanit të saj “Hak”, i cili po i përhapte idetë dhe shqetësimet e artikuluar nga drejtuesit e Xhemijetit me qendër në Shkup, pra aty ku gjendej edhe selia e organizatës, kanë luajtur rol të rëndësishëm për propagandimin e të drejtave të shqiptarëve dhe demaskimin e politikës shoviniste serbomadhe ndaj shqiptarëve.

Se Xhemijeti veproi në mbrojtje të interesave kombëtare, për këtë shërben argumenti tjetër, që ofrohet edhe nga studiuesi Dr. Skender Asani në studimin e tij në lidhje me bashkëpunimin e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës më seli në Shkodër dhe Xhemijetit më seli në Shkup. Pra, dy organizata, që kishin seli në qytet të ndryshme, por që vepruan në periudhë kohore të njëjtë.

Historiografia shqiptare është unike në mendimin se Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” me qendër në Shkodër ishte organizata që i demaskoi fuqishëm padrejtësitë ndaj shqiptarëve jashtë kufijve politikë të Shqipërisë. Pra, kjo organizatë i mbrojtë interesat kombëtare. Andaj vetvetiu lind pyetja “Po që se drejtuesit e Komitetit ‘Mbrojtja Kombëtare e Kosovës’ nuk do të kishin bashkërendim pikëpamjesh me drejtuesit Xhemijetit, a do të bashkëpunonin udhëheqësit e tyre ndërmjet vete?” Mendimi im është, pa fije dyshimi, jo! Por, ajo që i shtyri të kenë kontakte të mira pjesëtarët e këtyre dy organizatave, ishin pikëpamjet e tyre në mbrojtje të interesave shqiptare, veçanërisht të popullit shqiptar jashtë kufijve të Shqipërisë politike. Kuptohet, secila organizatë dha kontributin e saj, duke i shfrytëzuar rrethanat politike të vendeve ku veproi. Si-

gurisht, ndikimi i drejtuesve të Komitetit “Mbroyta Kombëtar e Kosovës” te drejtuesit e Xhemijetit nuk do të shihet me sy të mirë nga pushteti i atëhershëm.

### Si përfundim,

Organizata Xhemijeti, me seli në Shkup, me veprimtarinë e saj, u tregua mbrojtëse e denjë, për aq sa e lejonin mundësitë e kohës, e interesave shqiptare në Jugosllavinë e periudhës mes dy luftërave botërore. Sado që “Xhemijeti” për nga emri dukej me karakter fetar, në thelb veprimtaria e udhëheqësve të kësaj organizate u vu në mbrojtjen e interesave kombëtare.

Pa dashur t’i anashkaloj disa nga autorët dhe kontributet e tyre shkrimore të lartcekura, do t’i radhis këtu disa nga aktivitetet shkencore dhe botimet në lidhje me Xhemijetin. Këtu para së gjithash duhet ta përmendim konferencën shkencore, të organizuar më 17 dhjetor 2017 në Shkup me temë “*Organizata “Xhemijeti” dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit*”, kumtesat e së cilës u botuan në vitin 2018. Kjo konferencë ishte organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup dhe SHB “Logos-A” – Shkup. Pastaj vijnë botimet e viteve të fundit, si: “*Veprimtaria e organizatës politike Xhemijeti në trevat lindore (1919 – 1925)*”, e botuar nga Shtëpia botuese “Logos-A” në Shkup më 2017, me autor dr. Skënder Asani; “*Ferhat Bej Draga – shembull atdhetarie*” (përmbledhje dokumentesh), e botuar nga Kolegji AAB në Prishtinë më 2018, me autorë Dr. Jusuf Osmanin dhe Mulla Asllan Murati; “*Aqif Blyta – kolos i Pazarit të Rr*”, botuar nga Shtëpia Botuese “Logos-A” në Shkup më 2019, me autor Ismet Azizi; libri i cili ka dalë këto ditë nga shtypi me titull:

*“Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë 1922–1941”* (përmbledhje dokumentesh), i botuar nga Instituti i Historisë në Prishtinë, nën përgatitjen e Dr. Qerim Litës. Për më tepër, studiuesi dr. Qerim Lita, në këtë përmbledhje dokumentesh, boton, mes tjerash, edhe një shkresë, që i dërguari jugosllav nga Stambolli më 1924 ia dërgon Ministrisë së Punëve të Jashtme në Beograd, ku ankohej për botimet e shkrimeve në gazetën “Hak” dhe ku, sipas tij, kjo gazetë e paraqet pushtetin e atëhershëm si të dhunshëm dhe plaçkitës ndaj popullatës shqiptare.

Pra, këto organizime, duke përfshirë edhe këtë organizim përkitazi me 100–vjetorin e Xhemijetit (17 dhjetor 2019), si dhe botimet e lartcekura, kanë hedhur dritë mjaftueshme për punën e kësaj organizate dhe drejtuesit e saj. Por njëkohësisht, këto organizime dhe botime janë edhe përgjigje për të gjithë ata që Xhemijetin dhe drejtuesit e saj i shikojnë njëanshëm, sepse – siç thoshte dijetari ynë i Rilindjes Kombëtare, Sami Frashëri – për historinë “sa më shumë që ndryshojnë burimet e saj, po aq ndryshon edhe interpretimi”. Në fakt, burimet për këtë organizatë dhe personalitetet me peshë në këtë organizatë nuk kanë ndryshuar, por burimet janë nxjerrë nga sirtarët dhe i janë ofruar lexuesit pa ngarkesa ideologjike, që për shkaqe objektive e subjektive deri më sot, për pjesën dërmuese të këtyre burimeve, nuk është ditur në këtë masë.

**NEXHMEDIN SPAHIU**

*Kolegji AAB – Prishtinë*

## 100 VJET NGA THEMELIMI I XHEMIJETIT – PARARENDËSES SË LDK-së SË IBRAHIM RUGOVËS

Viteve të ‘90–ta një diplomat amerikan në Tiranë më pat pyetur: “A nuk është politika e Ibrahim Rugovës vazhdimësi e politikës së Ferat Dragës?” Në atë kohë shumë pak te ne e kanë ditur se kush ka qenë Ferat Draga dhe kush ka qenë organizata “Xhemijet”. Në atë kohë e kam ditur që vëllai i madh i Feratit, Hajdini, moshatar i Isa Boletinit, i lindur në vitin 1864, ka qenë pjesëmarrës në Kuvendin e Vlorës, ku është shpallur pavarësia e Shqipërisë dhe e ka përfaqësuar Mitrovicën dhe Sanxhakun e Novi Pazarit. Kjo në historiografinë tonë nuk është përmendur.

Kur për herë të parë pata shkuar në Durrës në vitin 1991, aty te Ura e Dajlanit, te mbikalimi–nënkalimi, që ndanë hyrjen në Durrës dhe në plazh të Durrësit, një i persekutuar politik, intelektual, më pat thënë: "Këtu në këtë vend ku po bisedojmë unë e ti në vitin 1914 është vlarë Hajdin Draga, një bashkatdhetar i yti nga Mitrovica, bashkë me kolonelin Tomson, në mbrojtje të shtetit shqiptar, në mbrojtje të Princ Vedit nga bandat rebele të Haxhi Qamilit.

Vëllai tjetër, Nexhipi, është ditur atëherë që e ka themeluar dhe udhëhequr organizatën “Xhemijet” në vitin 1919, pikërisht 100 vjet më parë, dhe ka vdekur në vitin 1921 në Vjenë, ku është varrosur nga bashkatdhetarët tanë atje me një ceremoni madhështore.

Nexhip Draga ka lindur në vitin 1869 dhe ka qenë shok shkolle me Mustafa Kemal Atatürkun.

Për Ferat Dragën është ditur që ka qenë deputet në Parlamentin e Mbretërisë Serbo–Kroate–Sllovene dhe se ka qenë edhe i dënuar. Ai ka lindur në vitin 1880 dhe ka vdekur në vitin 1944. Këto, pak a shumë, kanë qenë të dhënat biografike, që janë përmendur nëpër tekste aty–këtu, por se çfarë burri ka qenë Ferat Draga, çfarë politike ka udhëhequr Ferat Draga, kjo që na intereson më shumë neve në shkencat politike, për këtë nuk është ditur ose është folur në terma negative.

Dhe, derisa unë po mendoja t’ia ktheja përgjigjen diplomatit amerikan në atë se a është apo s’është politika e Ibrahim Rugovës vazhdimësi e politikës së Ferat Dragës, diplomati amerikan ndërhyri duke thënë: "Ti po e kritikon Ibrahim Rugovën, por ne amerikanët e përkrahim politikën e tij". Unë thashë: "Rugova, për mendimin tim, nuk po bën më të mirën e mundshme për Kosovën edhe pse në vija strategjike është mirë". Ai m’u përgjigj: "Kjo është kërkesë e tepërt", duke vazhduar "më të mirën për popullin e vet e ka bërë veç Ferat Draga ose, të paktën, kështu ka raportuar ambasadori ynë në Beograd viteve të ‘20–ta për Ferat Dragën, për të cilin ka thënë se është politikani më i zhdërvjelltë në Mbretërinë Serbe–Kroate–Sllovene".

Natyrisht, kjo m’i ndezi të gjitha llambat në kokën time, sepse të bësh më të mirën e mundshme, të cilësohesh nga ambasadori amerikan i kohës që po bën më të mirën e mundshme për popullin tënd, ndërkohë që përkrahja amerikane atëherë ka ekzistuar për shqiptarët dhe për Shqipërinë, por jo në veçanti për Kosovën, është shumë, madje të thuash që është politikani më i zhdërvjelltë në Mbretërinë Serbe–Kroate–Sllovene në një konkurrencë tepër të

madhe me politikanë tepër të shquar, siç ishte lideri slloven Anton Koroshec, siç ishte lideri kroat Stjepan Radiq, siç ishte lideri boshnjak Mehmet Spaho e, mbi të gjitha, siç ishte një politikan i kalibrit evropian, kryeministri Nikolla Pashiq, ta krahasosh me të gjithë këta dhe të thuash që ka qenë më i zhdërvjellëti, ky ishte një vlerësim tepër–tepër i lartë.

Prej këtij momenti unë jam thelluar në studime dhe ajo që më tepër më ka ndihmuar që të kuptoj se cila ka qenë politika e Ferat Dragës e sa i rëndësishëm ka qenë ai për Kosovën, për t'i vërtetuar plotësisht fjalët e ambasadorit amerikan të kohës, u binda nga literature serbe. Aty shihet se Ferat Draga është konsideruar armiku numër një i Mbretërisë Serbe–Kroate–Sllovene dhe pengesa kryesore për shfaqjen e shqiptarëve, sanxhakasve dhe muslimanëve bullgarë nga Maqedonia, si edhe turqve. Madje, pengesë shumë më e madhe sesa lëvizja kaçake. Të gjitha këto të dhëna janë intriguese për studiuesit dhe, sidomos, studentët e rinj që të lexojnë në këtë drejtim.

Në këtë shkrim po i përmend disa gjëra vetëm sa për të animuar me rastin e 100–vjetorit të organizatës “Xhemijet”. Pra, cila ka qenë politika e Xhemijetit dhe politika e Ferat Dragës? Ajo ka qenë politika e sigurimit të mbijetesës. Ky do të ishte definicioni më i shkurtër. Po marr një shembull. Viteve të ‘90–ta kur një diplomat austriak e ka pyetur presidentin Rugova se cili është sukcesi i politikës sate, çka do t’u tregosh brezave të rinj, ai ishte përgjigjur: “Po, ne jemi këtu, po mbijetojmë”. D.m.th vetë fakti që ne jemi akoma këtu, vetë fakti që ne akoma nuk e kemi braktisur Kosovën, ky është një sukses, është një politikë madhore”. E imagjinojeni kohën ndërmjet dy luftërave botërore kur periudha ka qenë shumë më e vështirë sesa në kohën e Millosheviqit, kur rreziku për shfarosje ka qenë akoma më i madh.

Ne duhet të njoftohemi me të gjitha të bëmat e organizatës “Xhemijet” dhe të këtyre personaliteteve për ta kuptuar se nëpër çfarë fije peri ka kaluar shpëtimi i popullit tonë, shpëtimi i Sanxhakut, i Kosovës dhe i Maqedonisë falë zhdërvjelltësisë, sakrificës dhe guximit të burrave të mëdhenj, ku ndër më të spikaturit ishin Nexhip Draga e Ferat Draga, si dhe Aqif Blyta. Pikërisht këta tre burra janë më meritoret për këtë që ne ende ekzistojmë në këto troje.

Çfarë bëri Xhemijeti për mbijetesën?

Ferat Draga bashkëpunoi me liderin kroat Stjepan Radiqi, bashkëpunoi me partinë gjermane të Vojvodinës (ndërmjet dy luftërave botërore gjermanët ishin shumicë e popullatës në Vojvodinë). A bëri aleancë herë me radikalët e Nikolla Pashiqit, e herë me demokratët, vetëm e vetëm që ta zbuste edhe mënjantonte atë çfarë e kanoste popullin e këtyre trevave. Organizata “Xhemijet” jo pa një ideal të qartë, jo pa një qëllim, jo pa një objektiv, ishte një organizatë që nuk e përfshinte vetëm Kosovën, por e përfshinte edhe Sanxhakun, si edhe Maqedoninë. (Maqedonia deri në prag të Luftës së Dytë Botërore ishte e banuar me shumicë myslimane).

Shqiptarët, sanxhakasit, turqit dhe bullgarët muslimanë në Maqedoni mbijetuan në saje të sakrificës dhe gjenialitetit të këtyre burrave.

Është intrigues fakti që Ferat Draga selinë e Xhemijetit e zhvendosi nga Shkupi në Mitrovicë, kjo si një qendër nevralgjike gjeografike për kohën. Ferat Draga ishte i lidhur me Komitetin për Mbrotjtjen Kombëtare të Kosovës me seli në Shkodër, duke bashkëpunuar me Hasan Prishtinën, Bajram Currin e me Azem Bejtën. Madje, vëllai i vogël i Ferat Dragës, Shefqet Draga (1899–1937), ishte po ashtu kaçak dhe bashkëluftëtar i Bajram Currit.

Përmes aktivitetit të kaçakëve Ferat Draga e orientonte gjithë aktivitetin që t'i eliminonte zullumqarët më të mëdhenj të popullit tonë. Për dallim prej Ibrahim Rugovës, që bëri vetëm rezistencë pasive, rezistenca që e organizoi Xhemijeti ishte një rezistencë e gjithanshme, shumëdimensionale.

Prof. Jusuf Osmani dhe Mulla Asllan Murati e kanë botuar një libër për Ferat Dragën dhe aty mund ta gjeni fjalimin e Ferat Dragës në Parlamentin e Mbretërisë SKS, që është një fjalim shembullor, një fjalim meritore, shembull dhe mësim për studentët e shkencave politike, mësim për deputetët tanë, madje do të ishte mirë që dikush nga aktorët tanë të njohur ta bëjë atë monodramë dhe ta shfaqë edhe në Parlamentin e Kosovës, që të mësohen deputetët se si duhet të mbahet një fjalim në parlament nga çdo aspekt, nga aspekti patriotik, aspekti retorik, estetik, thjesht në çdo dimension. Të gjithë ata që e kanë lexuar e dinë se ky fjalim ka qenë brilant. Hiç më pak nuk ka qenë as fjalimi i Aqif Blytës, që e pason fjalimin e Ferat Dragës në vitin 1923 në Parlamentin e Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene dhe që ishte meritore që Sanxhaku të jetë në një përfaqësim politik me Kosovën e Maqedoninë dhe jo me Bosnjën. Bosnja kishte një organizim të veçantë përmes të ashtuquajturës Organizata Muslimane Jugosllave, që kryesohej nga Mehmet Spaho, por politikanët nga Kosova, Sanxhaku e Maqedonia ishin të bashkuar në një organizatë të vetme, në organizatën "Xhemijet".

Është me rëndësi ta përmend atë çfarë thotë për Xhemijetin dhe për Ferat Dragën, në gazetën "Politika" të vitit 1923, babai i sociologjisë serbe, Sreten Vukosavljeviq. Ai thotë: "Mos mendoni se kjo është një organizatë fetare, absolutisht jo. Kur kanë qenë në rend dite në parlamentin tonë çështjet fetare, ata nuk e kanë parë këtë si prioritet. Këta janë thjesht një organizatë nacionaliste.



Madje, Xhemijetin e udhëheqin nacionalistët më të mëdhenj që kanë pasur shqiptarët, ata që e kanë organizuar Kongresin e Dibrës më 1909, ku në mënyrën më të qartë janë formuluar kërkesat e tyre për pavarësi, për Shqipërinë prej Adriatikut deri në Seres e në Shtip dhe rreziku i shtetit tonë vjen pikërisht nga kjo organizatë".

Ky vizion i sociologut serb me të vërtetë duket shumë domethënës. Kur shteti serb e pa që s'po e qesin kurrqysh në krye me "Xhemi-jetin", vendosën që në mënyrë të dhunshme ta shkatërrojnë atë. Andaj e burgosën Ferat Dragën me 20 vjet burg, Aqif Blytën me 100 vjet burg etj., krejt kjo për ta shkatërruar organizatën "Xhemi-jet". Ky akt i shtetit serb doli të jetë shkatërrimtar për të.

Pasoi, po ashtu, vrasja e Stjepan Radiqit në Parlamentin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene në vitin 1928 e pastaj, më vonë, si rezultat hakmarrës, edhe vrasja e mbretit Aleksandar Karagjorgjeviq në Marsej të Francës në vitin 1934. Kështu vijmë deri te Lufta e Dytë Botërore, kur ky shtet shkatërrohet definitivisht.

Këtu, Ferat Draga e kryen misionin e tij si politikan. Por, para se te vijmë te Lufta e Dytë Botërore, Ferat Dragës ia kishin vlarë djalin e tij që i kishte përfunduar studimet e mjekësisë në Beograd. Kjo sigurisht që ishte thyerje e madhe për Ferat Dragën. Prandaj Aqif Blyta do të vazhdojë të jetë i pathyeshëm edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai e organizoi mbrojtjen e Novi Pazarit nga shfarosja në vitin 1941, duke e ftuar në ndihmë Shaban Polluzhën dhe rreth 4000 luftëtarët e tij, në mesin e të cilëve ishte edhe gjyshi im, i cili në atë betejë u plagos. Këta luftëtarë e mbrojtën Novi Pazarin nga shfarosja.

Ishte hera e parë gjatë zhvillimeve të Luftës së Dytë Botërore që çetnikët dhe partizanët të bashkëpunonin mes vete për një qëllim të vetëm – të merret Novi Pazari dhe të shkatërrohet e të shfaroset.

Kur po bisedojmë me diplomatë dhe me studiues të huaj këtu në Kosovë dhe kur ata i shohin sjelljet e popullit tonë të pakuptueshme, sjelljet e klasës tonë politike etj., vërej se ata shpesh nuk e kanë të qartë një gjë – nuk e kanë të qartë se populli ynë vetëm brenda shekullit XX është ballafaquar katër herë me tentim shfarosjeje, gjatë dhe pas Luftës së Parë Ballkanike, në mes dy luftërave botërore, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore edhe, e katërta, në kohën e Millosheviqit. Në të gjitha këto herë populli ynë shpëtoi për fije të flokut.

Të gjitha ata që i kanë lexuar kujtimet e Marti Ahtisaarit e shohin se sa delikat ka qenë procesi i çlirimit të Kosovës, si ka ecur gjithë ai proces nëpër fije të perit, kjo në suaza ndërkombëtare për ta shpëtuar një popull nga gjenocidi.

Nëse për atë që prej kohës së ardhjes së Millosheviqit në pushtet e derisa erdhi te koha e luftës për çlirimin e Kosovës e quajmë meritör Ibrahim Rugovën, nëse gjatë Luftës së Dytë Botërore edhe menjëherë pas kësaj lufte meritör për shpëtimin e popullit tonë nga gjenocidi konsiderohet Shaban Polluzha, ndërmjet dy luftërave botërore edhe pas Luftës së Parë Ballkanike meritörë për shpëtimin tonë janë pikërisht këta tre burra: Nexhip Draga, Ferat Draga e Aqif Blyta.

Lavdi e përjetshme u qoftë këtyre burrave! Shpallja për heronj të kombit të këtyre burrave e nderon shtetin e Kosovës dhe do të ishte hapi më emancipues për Kosovën, për Presidentin, për klasën politike në drejtim të heqjes së pluhurit të historisë ndaj një etape shumë të rëndësishme të ekzistencës sonë dhe vlerësimit meritör për burrat të cilët më së shumti e meritojnë atë.

**ISMET AZIZI**

*Shoqata "Kosova për Sanxhakut"*

## **AQIF BLYTA, SEKRETAR I XHEMIJETIT DHE LIDER I SANXHAKUT**

Aqif Blyta pa dyshim është personaliteti dhe lideri më me ndikim i boshnjakëve dhe shqiptarëve të Sanxhakut nga viti 1919 e deri në vitin 1945. Për t'ia zvogëluar rolin historik, disa historianë e vënë në rend të parë origjinën shqiptare të familjes së tij, por harrojnë se Aqifi ka lindur në Pazarin e Ri, se është sanxhakli dhe është në trojet e veta. Ai gjithë jetën ia kushtoi luftës për një të ardhme më të mirë të Sanxhakut dhe banorëve të tij shqiptarë, boshnjakë e serbë që jetojnë aty. Për këtë ideal e dha edhe jetën. Përveç kësaj, ata harrojnë se partia Xhemijeti jo vetëm që i bashkoi shqiptarët dhe boshnjakët, por i tuboi edhe të gjithë myslimanët e tjerë nga territori i Sanxhakut, Kosovës dhe Maqedonisë. Duhet të theksohet se Aqif efendiu, gjë që është e rrallë në atë kohë, ishte një intelektual i kompletuar me shkallë të lartë arsimore, me akademi ushtarake, por edhe një biznesmen shumë i suksesshëm, i cili i përkiste elitës ekonomike të Sanxhakut në atë kohë.

Aqif Blyta ka lindur në vitin 1887 në Pazarin e Ri në familjen Blyta. Është bir i Eminit dhe Jaldëzës. Ai ishte shqiptar dhe familja e tij ishte me prejardhje nga Gjakova. Duke qenë besimtar i devotshëm, ai e mori mbiemrin e gjyshit të tij Ahmeti. Në mungesë të shkollave, familja ishte e detyruar ta dërgojë për shkollim në

Turqi, në qytetin Seneixhe (Izmiri)<sup>37</sup>. Pasi e kreu gjimnazin, e vazhdoi akademinë ushtarake të Manastirit e cila përgatiste oficerë të zotë e të aftë për ta komanduar ushtrinë perandorake në krejt viset e pushtuara. Aty merr gradën e kapedanit të klasit të parë<sup>38</sup>. Mandej përfshihet nga Lufta e Parë Botërore, ku si oficer aktiv në gradën e kapitenit luftoi në anën e ushtrisë turke gjatë Luftës së Parë Botërore.

Fillimi i vitit 1919 është momenti vendimtar i jetës së Aqif Blytës. Ai kthehet në vendlindje dhe nga ai moment fillon karriera e tij politike. Sipas Hakif Bajramit, derisa Aqif Blyta kishte qëndruar në Stamboll, *“kishte fituar dashurinë e besimin e gjithë ushtarëve shqiptarë si edhe gjithë shqiptaret të viseve kosovare e atyre të Jeni-Pazarit. Sidomos u bë i dashur nga të gjithë kosovarët, me përpjekjet e mëdha që kishte bërë para konsullatës jugosllave për mbrojtjen e ushtarëve shqiptarë, që ishin grumbulluar në Stamboll me rastin e hyrjes të ushtrive franko-angleze në atë qytet”*<sup>39</sup>. Eugen Shehu shkruan se Aqifi, në prag të kthimit në vendlindjen e tij, u kishte thënë miqve të tij: *“Shkolla e burrnija s’na ka mungue as-kurrë ne shqyptarëvet të ardhun këtu në Stamboll. Por për mue, ajo çka i dhash Perandorisë asht e mjaftueshme. Hije s’po më ka me mbush gjoksin me dekorata, kur kufinin e Shqypnisë e kërcnon*

<sup>37</sup> Hakif Bajrami, *Kush ishte Aqif Bluta?*, “Kosova Sot”, e shtunë – 25 prill 2009. Fejton Ekskluzive: Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm Ushtarak për Mbrojtjen e Trojeve Etnike Shqiptare maj-nëntor 1944,

<sup>38</sup> Milutin Živković, *Aćif Hadžiahmetović Bljuta*. Prilozi za biografiju 1919–1941, *Istorija XX veka*, 3, 2012, str. 71-95

<sup>39</sup> Bajrami, H., *Kush ishte Aqif Bluta?*, “Kosova Sot”, e shtunë – 25 prill 2009. Fejton Ekskluzive: Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm Ushtarak për Mbrojtjen e Trojeve Etnike Shqiptare, maj-nëntor 1944

*serbi e greku natë me natë. Po iki e po ju tham edhe ju që të hidhni dyfekët e turkut për me mbrojt votrat tona.*<sup>40</sup>

Aqifi, si trashëgimtari i vetëm mashkull pas dy motrave në familjen e Blytajve, me të arritur në vendlindje, me iniciativën e prindërve, u martua me Mahijen, të bijen e Halit Kumonit nga Gjakova.

Fill pas kësaj ai ra në kontakt me drejtuesit dhe me programin e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, i cili ishte formuar më 1 maj 1918 në ilegalitet të thellë dhe nga nëntori i po atij viti ishte vendos në Shkodër. Qëllimi parësor i kësaj organizate politike kombëtare ishte mbrojtja e shtetit të pavarur shqiptar, demokrazimi i tij, por edhe çlirimi i Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare të Jugosllavisë, që ishin shkëputur më 1913, si dhe bashkimi i tyre me Shqipërinë<sup>41</sup>. Programi që u miratua në ditën kur u themelua Komiteti “MKK” ka të bëjë me nyjën e parë, e cila në mënyrë kërkonte bashkimin e të gjitha krahinave të banuara me shqiptarë. Në këtë mënyrë, qëllimi kryesor i komitetit ishte: *“Me u përpjekë para pushteteve të mëdha të Entantës e me kërkuë bashkimin e Krahinave të Kosovës (Shkup, Kumanovë, Preshevë, Tetovë, Gostivarë, Kaçanik, Ferizoviq, Gjilan, Prishtinë, Vushtrri, Mitrovicë, Jeni Pazar, Rozhajë, Pejë, Guci, Gjakovë, Prizren) në Shqipëri të lirë dhe vetëurdhnuëse”*<sup>42</sup>.

Aqif Blyta bie menjëherë në kontakt me atdhetarët e Sanxhakut dhe të viseve të tjera shqiptare. Veçmas do të lidhej në miqësi të

---

<sup>40</sup> Shehu, E.: *Aqif Efendi Blyta, sinonim i burrërisë shqiptare*, Gazeta “Dielli” online,

<sup>41</sup> *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë 1985, f. 499.

<sup>42</sup> Bajrami, H., *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dhe qeveritë e Tiranës për krimet serbe ndaj shqiptarëve 1918-1941*, Prishtinë 2008, faqe 95, AQSH, Fondi 1007,D-708-757.;

përjetshme me Nexhip Dragën (1869–1921) dhe Ferhat Dragën (1880–1944).

### *Aqif Blyta, një nga themeluesit e Xhemijetit*

Myslimanët, pra shqiptarët e boshnjakët e Sanxhakut, nëpërmjet lidhjeve etnike dhe farestnorie, filluan të vetorganizohen politikisht, sipas tyre, që të mund t'i artikulojnë në mirë interesat e tyre ekonomike, politike etj. Kështu më 16 shkurt 1919 u themelua Shoqata Myslimane Jugosllave në Sarajevë.

Prandaj, Nexhip Draga dhe Aqif Blyta, pas konsultimeve dhe aktiviteteve të mëhershme, siç ishte organizata legale kulturore e arsimore “Bashkimi”, e formuar në Mitrovicë nga Hasan Prishtina, e themeluan në Shkup organizatën “Xhemijet” (“Bashkimi”). Në kongres organizata e re politike u pagëzua me dy emra. Emri i vërtetë ishte “Shoqëria e Mbrojtjes së të Drejtave Shqiptare”, ndërsa në opinion, për t’u maskuar, u paraqit me emrin “Shoqata Islame muhavazi hukuk” (Xhemijet). Në atë kohë Shtabi i Armatës së Tretë e njoftoi Ministrinë e Ushtrisë se në Shkup po mbahej kongresi i “Myslimanëve të Jugut”, ku, në praninë e 64 pjesëmarrësve kryetar ishte zgjedhur Nexhip Draga<sup>43</sup>, nënkryetar Sheh Sadedini, kurse sekretar Aqif Blyta<sup>44</sup>. Çështja e arsimit ishte njëra nga prioritete kryesore programore të Xhemijetit. Popullsia myslimane

<sup>43</sup> Živković, M. (2012). Po aty, Për Nexhip Dragën i referohet autorit B. Hrabak, i cili shkruan: “Nexhip Draga, është njëri nga liderët e xhonturqve të rinj ndër shqiptarë, anëtar i një mason dhe një bashkëpunëtor i ngushtë i radikalëve, vëllai i madh i liderit të ardhshëm të Xhemijetit, Ferhat Dragës, dhe bashkëpunëtor i ngushtë i Aqif Blytës”.

<sup>44</sup> Bajrami, H. (1981)., *Rrethanat Shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941*. Prishtinë: Instituti i Historisë, f. 182.; Bajrami, H., “Kosova Sot”, e shtunë – 25 prill 2009. Fejton Ekskluziv: Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm Ushtarak për Mbrojtjen e Trojeve Etnike Shqiptare, maj-nëntor 1944;

mane e trevave lindore kërkonte hapjen e shkollave kombëtare dhe fetare, kjo si parakusht për të siguruar autonominë e plotë.<sup>45</sup>

Në radhët e kësaj organizate ata u përpoqën të afronin sa më shumë intelektualë, të cilët do të mund t'i mbronin në mënyrë energjike dhe të zgjuar të drejtat e Shqipërisë jo vetëm në viset shqiptare, por edhe më gjerë në Evropë e Amerikë. Aqif Blyta tashmë e kuptoi përfundimisht se veprimtaria e tij s'mund të ishte tjetër, pos ajo e bashkimit të shqiptarëve në luftë për ekzistimin e kombit. Në nivel lokal, Blyta ishte organizator i kuvendit të përkrahësve të Xhemijetit në Pazar të Ri, i cili u mbajt më 4 prill 1920. Tubimi i pranoi të gjitha vendimet e Kuvendit Themelues. Aty u aprovua rezoluta e veçantë, ndërsa njëri nga dy nënshkruesit ishte edhe vetë Aqif Blyta<sup>46</sup>.

Xhemijetit i duhej që aktivitetin e vet ta orientojë në baza partiake, në mesin e masave të gjëra popullore, ndërsa çështja kryesore e parashtruar nga Xhemijeti ishte profilizimi i saj si organizatë e veçantë politike e myslimanëve të trevave lindore, Kosovës dhe Sanxhakut.<sup>47</sup> Sipas autorit Radoviq: *“Në kuvendin themelues në Novi Pazar, zyrtarisht janë themeluar Këshillat e Qarqeve dhe Rretheve të Xhemijetit. Tubimi është mbajtur në hanin e Tufik Efendi Imamoviqit dhe Xhelil Agë Agusheviqit, i cili ndodhej aty ku është sot kinemaja “Crvena zvijezda” në Novi Pazar. Në kuvendin themelues kanë ardhur aq shumë myslimanë (boshnjakë e shqiptarë – I.A.), sa që hani nuk kishte mundur t'i zinte, andaj kishin*

<sup>45</sup> Asani, Dr. S. (2017), *Dokumente për veprimtarinë e politike të Xhemijetit*, Logos-A, Shkup, f. 170.

<sup>46</sup> Živković, M. (2012). Po aty, i referohet Sekulić, M. (1998) „Rezultati skupštinskih izbora u Raškom okrugu u periodu ograničenog parlamentarizma (1920–1929)“, *Novopazrski zbornik*, 22,

<sup>47</sup> Asani, Dr. Skender. (2017), *Veprimtaria e organizatës politike Xhemijet në trevat lindore, 1919/1925*, Logos-A, Shkup Tiranë. f. 75.

*qëndruar jashtë. Në kuvend kanë folur Qamil–beg Ejupbegoviqi dhe Aqif Haxhiahmetovi (Aqif Blyta – I.A.). Folësit kanë kërkuar bashkimin, i cili do të mundësohet nëpërmjet kësaj partie dhe ape–luan që mos të copëtohen në parti të ndryshme dhe ua shpjeguan atyre se në këtë mënyrë më shpejt dhe më mirë do t'i realizojnë të drejtat e veta... ”<sup>48</sup>. Politikanët më të dalluar të Xhemijetit për Sanxhak, përveç Aqif Blytës, kanë qenë: Mehmedali Osmanbegovi, Shahsuvar–beu Çaviqi, Qamil–beu Ejupbegoviqi, Ali aga Qillexhiqi, Ejup–agë Lajqi, Ahmed Daci, Fehim–beu Nuribegoviqi, Omer Koniçanini, Mehmed Peqanini, Ahmed Hamzagiqi, Jusuf Mavriqi, Nuradin Crnishanini etj. Në këtë tubim u vunë themelet e Xhemijetit në Novi Pazar<sup>49</sup> dhe rrethinë.*

Në zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese, në nëntor të vitit 1920, Aqif Blyta, edhe pse ishte i renditur shumë lart në Xhemijet, megjithatë nuk ishte kandidati i kësaj partie në zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese në nëntor të vitit 1920, kur Xhemijeti i fitoi 8 vende.

Në këto zgjedhje, edhe pse Xhemijeti fitoi vetëm 8 vende, vlen të theksohet se atje ku jetonte dhe vepronte Aqif Blyta, pra në në Qarkun e Zveçanit e të Rashkës, rezultatet ishin më të mira se askund tjetër. Në lidhje me këto rezultate B. Hrabaku shkruan: *“Në Tutin dhe rrethinë është shkelur rekordi, sepse Xhemijeti mori më tepër se 70% të votave, edhe atë jo vetëm të shqiptarëve, por edhe më tepër të myslimanëve (boshnjakëve) dhe të serbëve”*.<sup>50</sup> Në lidhje me mospjesëmarrjen e Aqif Blytës në zgjedhjet e nëntorit të vitit 1920 autorët japin disa arsye. Për këtë autori M. Zhivkoviç thotë se

<sup>48</sup> Radović, M. (1998). *Efendijina sjećanja i kazivanja*, Novi Pazar, f. 119-120

<sup>49</sup> Tashmë, në këtë kohë me emrin Novi Pazar.

<sup>50</sup> Hrabak. B. Po aty, f. 112.



ekzistojnë dy arsye: së pari, Haxhiahmetoviqi (Blyta) si një ish-oficer i një shteti armik kishte probleme për ta marrë shtetësinë jugosllave dhe kjo i mori atij disa vite kohë për ta rregulluar statusin e tij ligjor dhe, së dyti, deri në vitin 1923 në Xhemijet rolin kryesor e kanë pasur turqit e Maqedonisë dhe shqiptarët nga Kosova, përderisa myslimanët (shqiptarët dhe boshnjakët – I.A.) e Sanxhakut ishin në pozitë varëse. Por, kjo çështje nuk e pengonte Blytën. Meqë ai e dinte gjuhën turke, shqipe dhe serbe, si zyrtar i partisë, disa herë shkoi në Beograd për çështje të ndryshme politike dhe me ndërgjegje e kreu punën e Sekretarit të partisë. Ai u angazhua për unitetit në parti dhe harmoni të të gjithë myslimanëve në Jugosllavi. Ai kërkoi që të harrohen grindjet partiake të së kaluarës dhe i kundërshtoi fraksionet përçarëse në Xhemijet.<sup>51</sup> Madje, autori Zhivkoviç i referohet B. Hrabakut: *“Situata për Blytën ishte veçanërisht e vështirë nëse merret parasysh se një numër i liderëve politikë myslimanë shqiptarë në Sanxhak dhe në Kosovë tashmë ishin në paraburgim për shkak të papërshtatshmërisë politike, të akuzave të llojlojshme...”*. Centralizmi i tij më së miri është pasqyruar me rastin e propozimit që kandidatët për deputetë të ishin të detyruar të nënshkruajnë blanko dorëheqjen në rast se nuk respektohen direktivat e udhëheqjes së partisë. Megjithatë, si një shqiptar, ai iu afrua rrymës pro-shqiptare të Xhemijetit, në mbështetje të Nexhip (ndërroi jetë në vitin 1921.) dhe Ferhat Dragës<sup>52</sup>. Ky i fundit, me ndihmën e lidhjeve me radikalët, në vitin 1922 kthehet në vend dhe përparon në hierarkinë e partisë *Xhemijet*. Në janar të vitit 1923 Ferhat Draga në Kongresin IV të partisë arrin si lider i shqiptarëve nga Kosova dhe me mbështetjen e myslimanëve të Sanxhakut, imponohet si lider i partisë. Për ngjitjen e tij të shpejtë

---

<sup>51</sup> М. Радовић, по ату ф. 179

<sup>52</sup> Živković, M. (2012). По ату.;

meritat i përkasin edhe Aqif Blytës. Ai i siguroi Ferhat Dragës mbështetjet në mesin e banorëve të Sanxhakut.<sup>53</sup>

Për rolin e rëndësishëm të Aqif Blytës në *Xhemijet* Crnovrshanini shkruan: “*Aqif Efendia, me këmbëngulësinë e tij dhe politikën e guximshme arriti t’i kthejë shumë myslimanë, të cilët në vitin 1920 votuan për Partinë Radikale. Ai i forcoi radhët e partisë myslimane të Xhemijetit, kështu që ajo shumë shpejt u bë partia më e fortë në Sanxhak, kryesinë e së cilës e përbënin, Aqif Blyta, Ahmet Daci, Qamil beu Ejubegović, Shahsivar beu Çaviq, Aljaga Çilerxhiq dhe Mehmedalija Osmanbegović*”<sup>54</sup>, andaj Crnovrshanini thotë se “*Një nga çerdhet më të forta të Xhemijetit ishte filiali i Novi Pazarit*”<sup>54</sup>.

### ***Roli i Aqif Blytës si deputet në Parlamentin e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene***

Për shkak të gatishmërisë së tij në Xhemijet dhe mbështetjes politike ndaj Ferhat Dragës, në zgjedhjet parlamentare të marsit 1923 Blyta emërohet në krye të listës së kandidatëve të Xhemijetit për qarkun e Shtavicës (Tutinit)<sup>55</sup>. Në këto zgjedhje Xhemijeti kaloi shumë mirë, duke i fituar 14 mandate, madje si partner i koalicionit hyri në qeverinë e Nikolla Pashiqit. Aqif Blyta në njësinë e tij zgjedhore arriti një fitore bindëse, duke fituar 51.78% të votave<sup>56</sup>. Më tepër se gjysmën e votave dhe të gjitha vendet për deputet Xhemijeti i arriti në Qarkun e Zveçanit dhe të Rashkës. Xhemijeti në vitin 1920 kishte gjithsej 1.9%, ndërsa në vitin 1923 4.5% nga

<sup>53</sup> Radović, M. (2007), po aty, f. 179

<sup>54</sup> Crnovršanin, H. Sadiković, N. (1996) *Sinovi Sandžaka*, Frankfurt. f. 72.

<sup>55</sup> Živković, M. (2012). Po aty

<sup>56</sup> Živković, M. (2012), po aty, Blyta në zonën e tij zgjedhore mori 3676 prej gjithsej 7,099 të votave. Rivali i tij kryesor, radikali Zhivko Shushiq, mori 1,954 vota. Në përgjithësi, Xhemijeti në rrethinën e Zveçanit-Rashkës mori 10,707 vota nga 21,384 vota, që ishte rreth 50.1%. Pjesëmarrja në zgjedhje ishte 75,15%.

numri i përgjithshëm i deputetëve. Rezultati i zgjedhjeve në qarkun Shtavicës (Tutinit) dhe Dezhevës (“Pazarit të Ri”, vërejtja jonë – I.A.) dëshmoi për reputacionin dhe<sup>57</sup> ndikimin e Blytës në këtë trevë. Ferhat Draga po ashtu korri fitore në qarkun e Zveçanit – Rashkës. Megjithatë, zgjedhjet në qarkun e Dezhevës dhe Shtavicës kaluan me një numër të parregullsisive,<sup>58</sup> kështu që komisioni verifikues i kontestoi pothuajse të gjitha mandatet e fituara të Xhemijetit dhe në mesin e tyre edhe atë të Blytës. Atij, para së gjithash, i është zënë për të madhe bashkëpunimi i tij me kaçakun e mirënjohur Jusuf Mehoniqi, si dhe që një kohë të gjatë nuk ka pasur shtetësi serbe e jugosllave, sepse ka jetuar në Turqi. Falë ndërhyrjes së të parit të radikalëve, Nastas Petroviq, Blytës iu respektua mandati dhe, në vitin 1923 ai u bë deputet në Kuvendin e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve<sup>59</sup>. Përveç kësaj, Blyta nga Xhemijeti u kandidua për 6 komisione dhe, në fund, arriti të bëhet anëtar i tre komisioneve<sup>60</sup>. Deputet të Xhemijetit në këto zgjedhje arritën të jenë: Aqif Ahmetoviq Blyta, tregtar (Qarku i Zveçanit–Rashkës), Qamil Jashar beu, bujk (Qarku i Tetovës), Qemal Osman, bujk (Qarku i Shkupit), Qenan Zija, rentier (Qarku i Manastirit), Dervish Shqerkapiq, myfti i qarkut (Qarku i Prijepole–Berane), Ferhat Draga, industrialist (Zveçan–Rashkë), Haxhi Xhemail Agushi, rentier (Qarku i Kosovës), Halim Beg Deralla, rentier (Qarku i Tetovës), Hasan Shukri Haxhi Mustafa, tregtar (Shkup), Nazim Gafurri, tregtar (Qarku i Kosovës), Rifad Rushisdi, rentier (Zveçan–Rashkë), Sadedin Rushidi, rentier (Manastir), Salih Jusufi, bujk (Kosovës), Shaban Mustafa, tregtar (Zveçan–Rashkë). Pas

---

<sup>57</sup> Hrabak, B. (2003). po aty f. 167.

<sup>58</sup> Živković, M. (2012).

<sup>59</sup> Hrabak, B. (2003).: *Džemijet: organizacija muslimana Makedonije, Kosova, Metohije i Sandžaka: 1919-1928*, Beograd: Autori., f. 175.

<sup>60</sup> Živković, M. (2012).

këtyre zgjedhjeve element dominues në organizatën u bë elementi shqiptar, edhe pse ai ishte rritur dukshëm me kthimin e emigrantëve gjatë mesit të vitit 1922 dhe sidomos para Kongresit IV të janarit të viti 1923.<sup>61</sup>

Karriera parlamentare e Aqif Blytës, edhe pse jetëshkurtër, ka qenë për t'u mbajtur mirë në kujtesën e opinionit me paraqitjet e tij të suksesshme në parlament. Deputetët e Xhemijetit, për shkak të njohurive të dobëta të gjuhës serbe, por edhe mungesës së përgatitjes profesionale politike, rrallë folën publikisht. Në vend të tyre kanë folur kryesisht deputetët e JMO-së.

Si pengesë të madhe për realizimin e planit serbomadhi Nikolla Pashiqi e vërejti Aqifi Blytën, prandaj në vitin 1925 ai ndërmori një terror të madh në Pazar të Ri dhe në të njëjtën kohë porosi likuidimin e këtij politikani me ndikim. Qëllimi i tij ishte të frikësojë dhe të shkaktojë huti në popullatën myslimane në këtë trevë. Për fat të mirë, idetë e tij nuk u realizuan<sup>62</sup>.

Aqif Blyta i shkolluar, intelektual me vlera të larta politike e diplomatike, fillon të shkruajë në gazetën “Hak” (organ i Xhemijetit, i cili dilte në Shkup). Ai publikon me guxim nëpër shtyllat e gazetës “Hak” të bëmat e rrezikshme të Kosta Peçancit kundër shqiptarëve të Pazarit të Ri dhe të Senicës, duke demaskuar jo vetëm vrasjet dhe dëbimet masive të shqiptarëve, por edhe planet djallëzore të Nikolla Pashiqit, i cili me çdo mjet kërkon ta dezinformojë opinionin evropian. Me një gjuhë të rrjedhshme e të qartë, me argumente të fuqishme e, për më tepër, me një logjikë të ftohtë, Aqif

---

<sup>61</sup> Hrabak, B. (2003). Po aty fq 170.

<sup>62</sup> Crnovršanin, H. Sadiković, N.(2001), Po aty, f. 73

Blyta u dha shpresa të mëdha jo vetëm miqve të vet, por edhe gjithë popullit të Pazarit të Ri, se shqiptarët nuk do ta ulin kryet<sup>63</sup>.

Në artikullin e botuar në gazetën “Kosova Sot” Prof. Dr. Hakif Bajrami, midis tjerash, citon në origjinal: *“Në vitin 1923, organizata shqiptare nxori listat e veta të deputetit e Aqif Blyta bënte pjesë në listën e Ferhat Dragës në zgjedhjet e bame dhe mbasi fitoi në votime përkatëse u emnue deputet në parlamentin e Mbretërisë SKS. Mbasi Kosova kishte 14 deputetë, kishin të drejtë të formojnë grupin parlamentar, kështu u formue klubi nën kryesinë e Ferhat Dragës. Aqif Blyta, me votat e përbashkëta të 14 deputetëve, u zgjodh anëtar i Komisionit të Financave në parlament. Nikolla Pashiqi kishte nevojë për përkrahjen e deputetëve shqiptarë dhe të pakicave gjermane. Kundrejt kësaj shqiptarët kishin të drejtën e formimit të organizatave fetare, ligje agrare dhe të arsimit në gjuhën e tyre”*<sup>64</sup>.

Aqif Blyta ishte njeri me përvojë dhe njohës shumë i mirë i rrethanave. Paraqitja më e dalluar e tij në Parlament ishte ajo më 6 dhjetor 1923, në një takim të Komitetit Financiar. Edhe pse në rend të ditës ishte çështja e buxhetit për vitin e ardhshëm, ai e hapi temën e vrasjes dhe torturimit të shqiptarëve etnikë në Mitrovicë dhe në Gjakovë nga ana e autoriteteve policore gjatë zgjedhjeve komunale të mbajtura në gusht 1923. Ai kërkoi nga autoritetet që ta rrisin angazhimin dhe përpjekjen e tyre për t’i gjetur dhe

---

<sup>63</sup> Shehu, E.: *Aqif Efendi Blyta, sinonim i burrërisë shqiptare*, Gazeta “Dielli” online, shtator 2014: <https://archive.is/ykTKA#selection-147.0-291.1>

<sup>64</sup> Bajrami, Hakif: Kush ishte Aqif Blyta?, gazeta “Kosova Sot”, e shtunë - 25 prill 2009. Fejton Ekskluzive: Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm Ushtarak për Mbrojtjen e Trojeve Etnike Shqiptare, maj-nëntor 1944, shih: Protesta e Xhemijetit, Shkup, 3 shkurt...

ndëshkuar autorët e krimit.<sup>65</sup> Në anën tjetër, e kritikoi edhe vonesën e aprovimit të ligjit për gjykatat e Sheriatit, që ishte menduar të jetë themeli i koalicionit ndërmjet radikalëve dhe Xhemijetit<sup>66</sup>. Blyta u ankua edhe për çështjen e pazgjidhur të reformës agrare në krahinën e Sanxhakut<sup>67</sup>. Diskutimi protestues i Blytës ka qenë i projektuar në qarqet udhëheqëse të Xhemijet si reaksion ndaj marrëdhënieve të tensionuara midis partnerëve të koalicionit. Në këtë takim Blyta nuk ka votuar për buxhetin e ri dhe meqë anëtari tjetër i Komitetit Financiar nga radhët e Xhemijetit nuk ishte në takim (zyrtarisht ai ishte i sëmurë), buxheti nuk ishte miratuar dhe ministri i Financave, Millan Stojadinoviq, ishte detyruar të japë dorëheqje. Duke sulmuar partnerët e koalicionit në qeveri, që tashmë ishte në krizë, Blyta tërhoqi vëmendjen e opinionit politik. Rebelimi i tij gjatë fjalimit dha sinjalin se rënia e qeverisë do të bëhet së shpejti.

Aqif Blyta i patrembur e me guxim të paparë, disa ditë më vonë, më 15 dhjetor 1923, në seancën e rregullt të Kuvendit i vazhdoi kritikën e tij. Ai i akuzoi të gjithë ish autoritetet jugosllave se ua kishin konfiskuar tokat dhe pasuritë myslimanëve të Sanxhakut në mënyrë të paligjshme dhe se ato ua kishin dhuruar ortodoksëve. Kështu, në të njëjtën kohë, nga foltorja e parlamentit sulmoi edhe qeverinë edhe opozitën. Kjo gjë shkaktoi një tronditje në mesin e deputetëve. Në vazhdim ai kërkoi të respektohen të drejtat kushtetuese të myslimanëve në Sanxhak, në Maqedoni, në Kosovë dhe

---

<sup>65</sup> Azizi I.: *Aqif Blyta – Figurë kryesore o organizatës Xhemijeti*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore të Shqiptarëve – Shkup. *Organizata Xhemijet dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit* (konferencë shkencore mbajtur më 17.12.2017, Shkup) 20 Boton: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore të Shqiptarëve Vëllimi 20 – 2018 Biblioteka: SCUPI, Shkup 2018, f. 150.

<sup>66</sup> Živković, M. (2012), po aty f. 77

<sup>67</sup> Grupa autora, Novi Pazar i okolina, Beograd, 1969, f. 287.

në Dukagjin, të cilët, sipas tij, duhet të trajtohen njëjtë si serbët, kroatët dhe slovenët. Ai gjithashtu garantoj se myslimanët janë besnikë ndaj Beogradit, duke përmendur viktimat myslimane që ranë në mbrojtjen Beogradit në vitin 1915, si dhe qëndrimin e tyre se kurrë nuk do të kthehen kundër "fqinjëve" të tyre të serbë. Prandaj kërkoi nga opozita të formojë një komision që çdo gjë të vërtetohet në vend të ngjarjes, pra të vërtetohen pohimet e tij se reforma agrare për popullsinë myslimane ka shkaktuar probleme pa ndonjë dobi<sup>68</sup>.

Sipas Eugen Shehut: *"Aqif Blyta diti kurdoherë të tregonte maturinë dhe shpirtin atdhetar. Duke zënë një vend të respektuar në këtë komision. Kur forcat serbe ndërhyjnë në gushtin e vitit 1923, në Mitrovicë, duke vrarë të rinj që protestonin sepse donin të ishte shqiptar kryetari i Bashkisë, Aqif Blyta me të marrë vesh ngjarjen, mbajti një qëndrim trimëror në parlamentin e Mbretërisë SKS. Ai kërkoi që të merreshin masa ndaj xhandarmërisë serbe, duke ua përkujtuar parlamentarëve se gjaku i derdhur nëpër rrugët e Mitrovicës nuk do të ndalet pa u plotësuar vullneti i popullit të atij vendi heroik". Po atë ditë, në gazetën "Hak" Aqif Blyta shkruante: "Xhandarët serbë po i vrasin barbarisht shqiptarët, nëpër rrugë. Këto mizorinë barbare mund t'i bëjnë vetëm serbët e qeveria e tyre"*<sup>69</sup>.

Deri kah mesi i vitit 1924 Blyta ishte tashmë njëri nga politikanët më me ndikim të Xhemijetit. Pas paraqitjeve publike të Blytës, Nikolla Pashiqi, në prag të krizës së marsit të viti 1924, i bëri thirrje që Qeveria të bëjë përpjekje t'i përmirësojë lidhjet me Xhemijetin.

<sup>68</sup> Živković, M. (2012), po aty. f. 77

<sup>69</sup> Shehu, E.: (shtator 2014), *Aqif Efendi Blyta, sinonim i burrërisë shqiptare*, online, Gazeta "Dielli": <https://archive.is/ykTKA#selection-147.0-291.12> (qasja tetor 15, 2017), Gazeta "Hak" shtator 1923.

Në shkurt të 1924 Blyta pati një paraqitje të re në Kuvend. Në të vërtetë, pas pësimit të disa civilëve shqiptarë në fshatrat e rrethit të Vushtrisë gjatë operacionit për të kapur kaçakët nga xhandarmëria, Ferhat Draga dhe Aqif Blyta kërkuan interpelancë të ministrit të Punëve të Brendshme<sup>70</sup>. Në këtë kontekst Blyta foli në Kuvend, më 30 mars 1924, kur në agjendë ishte diskutimi për interpelancë. Ai u ndërlidh me ekspozenë e Ferhat Dragës për dhunën kundër popullatës joortodokse në Kosovë, Dukagjin dhe Sanxhak nga ana e xhandarmërisë dhe, midis tjerash, tha: *“Zotëri deputetë popullorë, natyrisht se z. Ferhat Draga nuk ka mundur që të numërojë në fjalimin e tij të gjitha krimet, sepse ato janë aq të shumta, sa që nuk mund të numërohen këtu për disa ditë. Unë, zotërinj, nuk do të hyj në detaje, sepse koha është e vonë, por shkurtimisht do t’i numëroj”*. Aqifi fillon me përshkrimin e vrasjes së Selim efendisë nga xhandarët. Selim efendija ishte një prej personave më të ndershëm dhe më me ndikim në Sanxhak. Këtë vepër e kishte bërë rreshteri i xhandarmërisë, Vidiq, kryetar i komunës së Dugopolës. Një komision hetues, pas vrasjes së një myslimani, kishte konstatuar se ky rreshter kishte vrarë 17 myslimanë dhe Sylejman Bozaxhinë. *“Zotërinj, edhe z. Ferhat beg Draga në fjalimin e tij ka theksuar se te ne në Sanxhak ka ardhur Miliq (Krstiq) dhe Kosta Peçanac. Për atë se çfarë kanë bërë, nuk do të flas, por vetëm dua të them se kur kanë ardhur në Novi Pazar nga fshati Stamenkoviq, kanë plaçkitur gjithçka gjatë rrugës, qerre dhe kuaj. Në atë rast nga prefekti i rrethit kanë kërkuar që t’ua bartë gjësendet e vjedhura. Atëherë, siç thuhet, i kanë tubuar shqiptarët dhe e kanë formuar çetën. Atëherë Miliqi ka shkuar me bandën e hajdutëve dhe kanë plaçkitur gjithçka, madje edhe vajzën e Syleman Efedisë e kanë çnderuar. Tërë*

---

<sup>70</sup> Živković, M. (2012), po aty, f. 78



*fshatin e kanë plaçkitur dhe myslimanëve nuk u kanë lënë asgjë*". Më pastaj, Aqif Ahmetoviq Blyta i përshkruan edhe krimet e tjera dhe konfliktin me hajdutin Mehoviq. Deputeti Aqif Blyta përshkruan në detaje shumë krime të bandave serbe, të xhandarmërisë dhe të tjerëve në popullatën vendase. Ai i përmend me emër shumë persona të vrarë nga vendet e ndryshme të Sanxhakut, Peshterit, Rozhajës e të tjerë. Aqif Blyta e përshkruan edhe sjelljen e keqe të organizatës nacionale të rinisë serbe, për qëndrimin e saj antiturk dhe antishqiptar dhe tërë atë siç ka ndodhur.

Në fund diskutoi edhe njëherë Ferhat Draga: "Zotëri, ne e dëgjuam z. Ministër të Punëve të Brendshme, i cili është përgjigjur në interpellancën tonë të Xhemijetit. Ne konsiderojmë dhe shpresojmë se z. Ministër edhe më tutje do të bëjë hetime siç janë bërë deri me tani. Andaj, propozojmë thjesht të kalojmë në rendin e ditës (duartrokitje në pjesën qendrore)"<sup>71</sup>. Pas këtij prezantimi pasuan raporte të detajuara të ministrit të Punëve të Brendshme dhe disa sulme ndaj Ferhat Dragës dhe Xhemijetit nga politikanët serbë nga Kosova dhe Dukagjini. Se kundër Fehrat Dragës bëhej propagandë e hatashme serbe flet edhe shkrimi i gazetës "Naša stara Srbija", e cila e konsideron Ferhat Dragën si promotor të kaçakëve. Madje, për ta diskredituar edhe më tepër, në faqet e saj e sjell një artikull me titull "Ubijen Šefket Beg Draga", ku thuhej se me Bajram Currin është vrarë edhe Shefket bej Draga, nipi i Ferhat Dragës, i cili ka qenë anëtar i Kuvendit Ekzekutiv i Komitetit të Kosovës"<sup>72</sup>

Tehu i sulmeve të tyre verbale ishte drejtuar kundër bashkëpunimit të anëtarëve të Xhemijetit me shumicën e bandave kaçake. Blyta,

---

<sup>71</sup> Asani. S. ( 2017)., *Dokumente për veprimtarinë e politike të Xhemijetit*, fq.129-131

<sup>72</sup> Asani, Dr. Skender. (2017), *Veprimtaria e organizatës politike Xhemijet në trevat lindore, 1919/1925*, Logos-A, Shkup, f. 89

në anën tjetër, përmendi se xhandarët nga qarku i Shtavicës (Tutin) janë në lidhje me kaçakët dhe e ndajnë plaçkën me ta. Ai tha se nga kaçakët pësojnë myslimanët dhe serbët dhe se Xhemijeti nuk ka asnjë lidhje me ta. Ai gjithashtu përmendi marshimin e Kosta Peçancit nëpër Sanxhak në vitin 1922 dhe përfundoi duke akuzuar qeverinë se nuk ka taktika të drejta për t'i luftuar kaçakët dhe ndjekjet e tyre zakonisht përfundojnë me ushtrim të dhunës kundër popullatës jo të krishterë.<sup>73</sup>

Disa muaj pas krizës, në prill 1924, qeveria radikale e Nikolla Pashiqit zëvendësohet nga qeveria e udhëhequr prej demokratëve të Luba Davidoviqit. Deputetët e Xhemijetit e mbështetën qeverinë e re, ndërsa Blyta ishte një nga nismëtarët e ndryshimeve të qëndrimeve të partisë<sup>74</sup>. Ai, në fakt, së bashku me Ferhat Dragën, mori pjesë në negociatat e zhvilluara me opozitën. Në kohën e konfliktit dhe trazirave brenda Xhemijetit gjatë gjysmës së dytë të viti 1924, kur disa anëtarë nga Maqedonia dhe Sanxhaku u përjashtua nga partia, Blyta doli në skenë si një ndër figurat më e fuqishme në parti dhe vazhdoi të qëndrojë përkrah Ferhat Dragës.

Megjithatë, në nëntor të vitit 1924 qeveria e demokratëve e humbi mbështetjen dhe u shpallën zgjedhje të reja parlamentare, që do të mbaheshin në shkurt 1925. Aqif Blyta kësaj here ishte kandidat i

---

<sup>73</sup> Azizi I.: Aqif Blyta – *Figurë kryesore e organizatës Xhemijeti*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore të Shqiptarëve- Shkup. *Organizata Xhemijet dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit* (Konferencë shkencore mbajtur më 17.12.2017, Shkup). Boton: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore të Shqiptarëve Vëllimi 20 – 2018 Biblioteka: SCUPI, Shkup 2018, f. 153.

<sup>74</sup> Hakif Bajrami: *Partia politike "Xhemijeti" (Bashkim) në Shqipërinë kontinentale krijon histori kombëtare*, (Konferencë shkencore mbajtur më 17.12.2017, Shkup) Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore të Shqiptarëve- Shkup. *Organizata Xhemijeti dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit*. Boton: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore të Shqiptarëve Vëllimi 20 – 2018 Biblioteka: SCUPI, Shkup 2018, f. 87.

Xhemijetit për qarkun e Dezhevës, Tutinit dhe Senicës (zëvendës Ibrahim Querkez).<sup>75</sup> Megjithatë, forcimi Xhemijetit dhe prononcimi gjithnjë e më i lirë i përfaqësuesve të tij, por edhe përafrimi me opozitën, më saktë me Partinë Republikane Fshatare Kroate në krye me Stjepan Radiqin (me kontaktet ekzistuese me JMO), nuk i përshkatej Nikolla Pashiqit. Prandaj ai ia doli që, me mbështetjen e gjykatës, ta organizojë eliminimin e Xhemijetit nga skena politike e Mbretërisë SKS. Aqif Blyta dhe Ferhat Draga shënohen si persona që duhet të bëhet presion policor mbi ta. Prandaj nga 27 dhjetori e deri më 6 shkurt 1924 Aqif Blyta është arrestuar katër here <sup>76</sup>.

Historiografia serbe nuk është e saktë kur flet për shpërndarjen e parlamentit të Mbretërisë së SKS në vitin 1925. Nikolla Pashiqi ia ofron Ferhat Dragës një sasi të konsiderueshme të parave si dëmshpërblim që t'ua ndajë agallarëve dhe bejlerëve në Maqedoni, në Kosovë, në Dukagjin dhe në Sanxhak në emër të dëmshpërblimit për tokat të cilat u ishin marrë. Por, Ferhat Draga, përveç parave të përmendura, kërkoi edhe një lloj autonomie për Kosovën dhe Du-

---

<sup>75</sup> Hrabak, B.: *Džemijet: organizacija muslimana Makedonije*, Kosova, Metohije i Sandžaka: 1919-1928, f. 242.

<sup>76</sup> Živković, M. (2012), Po aty.fq. 71-95; Blyta u arrestua për herë të parë më 27 dhjetor 1924, pa vendim paraprak të Asamblesë Kombëtare për heqjen e imunitetit parlamentar. Në të njëjtën ditë, në mbrëmje, ai u lirua në shtëpi, por i zhveshur nga legjitimiteti parlamentar. E arrestuan përsëri më 15 janar 1925 në Pejë gjatë përpjekjeve për të organizuar një takim të partisë. Ai është arrestuar dhe ndaluar për dy ditë me akuzën se është përpjekur për të organizuar çlirimin e Ferhat Dragës, i cili ishte në burg në Mitrovicë. Disa ditë më vonë në Gjakovë Blyta u arrestua përsëri më 15 janar 1925, prapë në Pejë, gjatë përpjekjeve për të organizuar një takim të partisë. Ai është arrestuar dhe ndaluar për dy ditë me akuzën se është përpjekur për të organizuar çlirimin Ferhat Dragës, i cili ishte në burg në Mitrovicë. Disa ditë më vonë u arrestua edhe në Gjakovë. Së fundi, para zgjedhjeve më 6 shkurt 1925, e futën edhe një herë në burg, kësaj radhe në Novi Pazar. Edhe pse kandidat parlamentar, Blyta i kaloi zgjedhjet parlamentare të viti 1925 në burg... "Politika", 27 janar 1925, 4; B. Hrabak, *"Novopazarske džemijetlije..."*, f. 250-251.

kagjimin. Kërkesës së tij Nikolla Pashiqi iu përgjigj negativisht, madje vazhdoi të kërkojë forma se si ta likuidojë partinë Xhemijet, e cila kishte arritur autoritet të madh në popullatën myslimane.

Dita e zgjedhjeve, 8 shkurti 1925, kaloi me terror të madh. Në zgjedhjet e vitit 1925 Nikolla Pashiqi i detyroi me dhunë myslimanët e Sanxhakut që ta votojnë partinë e tij Radikale. Për këtë qëllim ai me kohë e kishte përgatitur skenarin. Ejub Mushoviqi, në librit e tij “Novi Pazar i okolina”, e përshkruan se si është zhvilluar ky skenar: *“Në prag të zgjedhjeve, në Novi Pazar qëndroi edhe kryebashkiaku i Çaçakut. Ai zhvilloi një aktivitet të dendur para-zgjedhor dhe vazhdoi t’i përvetësojë myslimanët për Partinë Radikale. I tuboi, madje edhe hyri nëpër xhami, ku bisedoi me popullatën. Kishte dalë lajmi se myslimanët duan të lidhen me Kroacinë dhe, për këtë arsye, disa persona u shpallën si të dyshuar dhe u penguan ta bëjnë këtë. Në prag të zgjedhjeve u gjuajt me armë për të frikësuar popullatën. Në orët e hershme të mëngjesit nga fshatrat kishte ardhur masë e madhe e fshatarëve serbë, të ndarë në grupe dhe ata iu kishin bashkuar patrullimeve të xhandarmërisë, të cilët lëviznin nëpër rrugë, kjo me qëllim të frikësimit të popullatës. Pas orës 10,00 filloi maltretimi i qytetarëve eminentë, mandej i atyre për të cilët mendohej se ishin kundër Partisë Radikale. Popullata filloi të largohej nga rrugët dhe të mbyllet në shtëpi. Madje, edhe ata të cilët ishin caktuar në vendvotimi për t’i përcjellë zgjedhjet, i braktisen vendet e tyre dhe u futën brenda shtëpive të tyre. Pas orës 11 nuk ka pasur asnjë qytetarëmysliman në rrugë. Atë ditë, sipas Mija Radoviqit, janë rrahur, rreth 200 myslimanë. Në zgjedhjet e zhvilluara në ato kushte fitoi Zhivko Shushiqi”<sup>77</sup>.*

<sup>77</sup> Crnovršanin, H., Sadiković. N. (1996) po aty; Mušović. E., *Pazar i Okolina*, f. 293

*Burgosjet dhe shpërndarja e Xhemijetit*

Në maj të vitit 1925 Aqif Blyta u propozua prej qindra burrave gjakovarë që t'i përfaqësojë në parlamentin e Mbretërisë SKS. Serbët, nga ana e tyre, ende i ruanin në kujtesë fjalimet oratorike e debatet e nxehta në parlament, ku ai në çdo rast u dilte në mbrojtje të drejtave të bashkëkombësve të vet. Prandaj ata kurrsesi nuk mund ta lejonin që nga ky parlament të dilnin zëra protestues të deputetëve shqiptarë. Andaj në një natë gushti të vitit 1925, pas një atentati të dështuar, Aqif Blyta arrestohet prej xhandarmërisë serbe në shtëpinë e Ramiz Rizës. Akuza në këtë rast ishte menduar njaft mirë. Aqifi u akuzua për bashkëpunim të ngushtë me Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, si dhe me forcat vullnetare të luftëtarëve të Bajram Currit. E liruan me kusht që ai të largohej menjëherë nga Gjakova. Kushti ishte tejet domethënës... Po ashtu arrestohet edhe në Mitrovicë në shtëpinë e një miku të vet dhe i kërkohet llogari për takimet e fshehta që i ka pasur me Bajram Currin<sup>78</sup>.

Edhe Ferhat Draga gjithashtu u arrestua disa herë. Për ta shuar Xhemijetin, Pashiqi vendosi ta burgosë Ferhat Dragën. Sado që Ferhat Draga nuk kishte faj, gjykata e shkallës së parë e Mitrovicës, për ta paralizuar aktivitetin e tij politik paraelektoral, mu në prag të zgjedhjeve e dënoi me 20 vjet burg<sup>79</sup>.

Për zgjedhjet në Pazar të Ri dhe rrethinë, të cilat kaluan nën dhunën e terrorin shtetëror, që u ushtrua ndaj myslimanëve dhe për

---

<sup>78</sup> Shehu, E.: *Aqif Efendi Blyta, sinonim i burrërisë shqiptare*, Gazeta “Dielli” online shtator, 2014: <https://archive.is/ykTKA#selection-147.0-291.12> (qasja maj 15, 2017)

<sup>79</sup> Bajrami, H. (1981). *Rrethana shoqërore politike në Kosovë 1918-1944*, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, faqe 232, cituar “Pravda” 25. I. 1925, “Politika”, 1. II. 1925.

një numër i madh të parregullsive, shkruan edhe autori serb M. Raoviq<sup>80</sup>. Meqë rezultatet e publikuara të Xhemijetit për qarkun e Dezhëvës dhe Shtavicës nuk mund të konsiderohen si reale për shkak të presionit nga ekzekutivi, nuk dihet se sa vota kishte fituar kësaj radhe Blyta.

Historiani Marenglen Verli, në lidhje me gjendjen e krijuar gjatë mbajtjes së këtyre zgjedhjeve dhe veprimet e pushteti për ta penguar zgjedhjen e Blytës dhe Dragës, në veprën e tij e citon gazetën “Kosova”: *“Me të gjitha shtrëngimet e burgosjet që iu bënë Ferhat Dragës dhe Aqif Blytës (këta) fitojnë se fitojnë në zgjedhjet e Mitrovicës 13.000 vota e disa mijëra të tjera në Gjakovë. Mirëpo këto vota i vodhën kryetarët e komisioneve, të cilët i falsifikuan procesverbalet dhe, më në fund, lihen vetëm 5.000 vota në Mitrovicë e 3.000 në Gjakovë. Në këtë mënyrë zotërinjve Ferhat Draga dhe Aqif Blyta, sado që u zgjodhën prej popullit njëzëri, nuk u jepej mandati i deputetësisë, e kështu, 1.000.000 shqiptarë të Kosovës (nënkupton edhe Saxhakun – I.A.), lihen pa përfaqësues në Parlamentin Jugosllav. Aqif Blyta u mbajt i burgosur katër muaj pas zgjedhjeve e Ferhat Draga u mbajt tre vjet në pranga në burg”*<sup>81</sup>.

Për t’i frikësuar edhe më tepër dhe për ta detyruar popullatën që të shpërngulet, në Pazar të Ri janë vrarë qytetarët më eminentë, si: imani Selim Dugopolani, Emin Peçanini (Peja), Bedri beg Eminbegoviqi, vëllezërit Bajramoviqi, ndërsa atentat i pasuksesshëm ishte kryer edhe ndaj Emin beg Nuribegoviqit.

Në fillim të vitit 1924 shkatërrohet Partia Demokratike, ndërsa në vitin 1926, pas vdekjes së Nikolla Pashiqit, edhe Partia Radikale.

<sup>80</sup> Grup autorësh, po aty, 292; M. Radović, n.d., 128–133.

<sup>81</sup> Verli, M. (2017).101, *Nga Kosova për Kosovën* (Profile biografike), Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. f. 102.

Pasi e kishte humbur mbështetjen në Pazar të Ri, si dhe në Partinë Demokratike, mbreti Aleksandër, më 06.01.1929 e instalon diktaturën, e shkarkon parlamentin në Beograd dhe e ndalon veprimtarinë e partive politike. Nga kjo kohë deri me vrasjen e tij në Marsej (1934) nga atentatori bullgar, anëtar i VMRO, ai ishte mbështetur në fuqinë e ushtrisë dhe xhandarmërisë<sup>82</sup>.

Në vazhden e sulmeve kundër Xhemijetit autoritetet serbe burgosën tipografët e gazetës “HAK” dhe më pas e ndaluan edhe zyrtarisht gazetën, duke akuzuar se botonte informata që i cenonin autoritet serbe. Ndërkaq, në prag të zgjedhjeve parlamentare, të caktuara për 8 shkurt 1925, në orët e pasdites më 30 janar 1925, me urdhër të shefit të policisë së Mitrovicës, u arrestua u burgos Ferhat Draga, i cili u akuzua për vepër antishtetërore dhe për kundërvajtje të bëra më herët në Mitrovicë<sup>83</sup>. Me një procedurë të shkurtër ai u dënua me 101 vjet burg. Me këto përndjekje të qeverisë mori fund edhe veprimtaria e hapur e Xhemijetit. Pas kësaj autoritetet e Beogradit e liruan Ferhat Dragën<sup>84</sup>.

Arsyet për eliminimin e organizatës politike Xhemijetit nga skena politike e MSKS, mund t'i gjejmë te kryetari i saj, Ferhat Draga, i cili arriti ta heqë organizatën nga angazhimet e saj fetare e ta drejtojë kryesisht në çështjet kombëtare, për t'i zbardhur padrejtësitë kombëtare, të cilat bëheshin ndaj shqiptarëve dhe turqve në MSKS.<sup>85</sup>

---

<sup>82</sup> Crnovršanin, H. Sadiković, N. (1996). *Sinovi Sandzaka*, Frankfurt, f. 75

<sup>83</sup> Asani, Dr. Skender. (2017), *Veprimtaria e organizatës politike Xhemijet në trevat lindore (1919-1925)*, Logos-A, Shkup, f. 159

<sup>84</sup> Historia e Popullit Shqiptar III, *Periudha e Pavarësisë 1912 – 7 prill 1939*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Botimet “Toena”, Tiranë 2007.

<sup>85</sup> Asani, Dr. Skender. (2017), po aty, fq. 168

Pas shpërbërjes së Xhemijetit u ndërpre edhe karriera politike e Aqif Blytës për vite me radhë, sepse veprimtaria e mëtejshme publike nxiste presion të ri të autoriteteve ekzekutive. Megjithatë, A. Blyta mbeti politikani më me ndikim në Pazar të Ri dhe në rrethinën e tij, veçanërisht në mesin e popullatës myslimane. Për shumicën prej tyre Blyta ishte shtëpiak i respektuar, tregtar dhe politikan në zë, por edhe simbol i rezistencës ndaj Beogradit dhe shtetit, të cilin myslimanët e rajonit kurrë nuk e kishin pranuar plotësisht. Ndikimi i tij nga Pazari i Ri është përhapur edhe ë vendbanimet përreth, sidomos në rrethin e Shtavicës dhembështetja për të rritej me vendimet e myslimanëve nga rrethi Dezhevës<sup>86</sup>. Edhe Blyta i kuptoi avantazhet e pozicionit të tij. Prandaj ai i mblodhi ish-anëtarët e Xhemijetit të qarkut të Dezhevës e të Shtavicës dhe me ta mbante kontakte. Duke i "orientuar" votat e myslimanëve, ai ushtroi ndikim të madh në zgjedhjen e udhëheqësve politikë serbë të qarkut të Dezhevës dhe Shtavicës. Ndikimi i tij është ndjerë në të gjitha zgjedhjet në këtë rajon deri në vitin 1941. Kështu, në zgjedhjet komunale 1926, i ndihmoi demokratit Gjorgje Petroviq, i cili, falë votave myslimane, pra boshnjake e shqiptare, arriti ta mundë kundërshtarin radikal, Shushiq Një vit më pas, gjatë zgjedhjeve parlamentare, Blyta e mbështeti kandidaturën e Mehmed Spahos në listën e Partisë Demokratike për qarkun Dezhevës, e cila ia solli atij mandatin e deputetit<sup>87</sup>.

Duke qenë se kishte mbështetjen në popull, por edhe në organet komunale dhe të qarkut, si edhe në parlament, Blyta e shihte se po i kërcënoheshin interesat politike dhe ato të biznesit, andaj nuk

---

<sup>86</sup> Živković, M.(2012).fq. 81

<sup>87</sup> Petrović, M.(2007), *Raška oblast u jugoslovenskoj državi*, [tps://mostovikulture.wordpress.com/2015/02/27/milic-f-petrovic-raska-oblast-u-jugoslovenskoj-drzavi-1918-1941-ii-dio/](https://mostovikulture.wordpress.com/2015/02/27/milic-f-petrovic-raska-oblast-u-jugoslovenskoj-drzavi-1918-1941-ii-dio/) (marrë më: 15shtator 2017)



hezitonte të hynte në konflikt me autoritetet lokale. Qeveria komunale në vitin 1933, për shkak të mungesës së buxhetit, u detyrua të pushojë nga puna 12 të punësuar. Midis tyre ishin edhe disa bashkëpunëtorë të Blytës. Prandaj ai kërkoi nga kryetari i komunës, Gjorgje Petroviq, që për shkak të ndihmës së dikurshme që ia kishite ofruar, t’ia kthejë shërbimin, duke i kthyer në punë zyrtarët e larguar. Kur Petroviqi refuzoi, Blyta nëpërmjet këshilltarëve myslimanë, filluan t’ia minojë seriozisht pozitën e tij si kryetar komune<sup>88</sup>. Konflikti, madje, kulmoi me tentimin për likuidim të Blytës<sup>89</sup>. Por, sulmuesit kurrë nuk u kapën. Megjithatë, sipas dëshmive të bashkëkohësve, atentatin ndaj Blytës kanë tentuar ta bëjnë dy serbë të Pazarit të Ri. Njëri prej tyre ishte një punonjësi i komunës. Kriminelët arritën ta plagosin rëndë me sëpatë në kokë dhe në krah<sup>90</sup>. Autori Radoviq, në veprën e tij “Efendijina sećanja i kazivanja” (Kujtimet dhe tregimet e Efendisë), citon Omer Efendi Končanin: *“Nëpër qytet flitej se Aqifin e kanë sulmuar dhe e kanë plagosur Millojko Roginjac, nëpunës, tash punon në Entin Higienik në Novi Pazar dhe Bako Marovac, punëtor, që të dy nga Novi Pazar. Hetuesia ka konstatuar se sulmuesit janë të panjohur”*.

Pas këtij rasti pjesa më e madhe e myslimanëve edhe më tepër ishin përkrah Aqifit, si lider politik i tyre. Ky rast ndikoi negativisht edhe në marrëdhëniet midis serbëve dhe myslimanëve në trevën e Novi Pazarit. Ngjarja ndodhi në prag të zgjedhjeve komunale të vitit 1933”<sup>91</sup>.

---

<sup>88</sup> Radović, M. (2007) po aty. f.138

<sup>89</sup> Një atentat i çetnikëve serbë, “Kosova”, organ i Komitetit Kosovar, Viti I, nr. 3, 4 maj 1941 – XIX.

<sup>90</sup> 136 Crnovršanin, H. Sadiković, N. (1996). Po aty. f. 198.

<sup>91</sup> 137 Radović, M. (2007) *Efendijina sećanja i kazivanja*, botimi i dytë, Novi Pazar, 2000. f. 138.

Gazeta e kohës “Kosova”, pasi Aqif Blyta i shpëton atentatit, shkruan: *“Aqifi i plagosur derisa po dergjej në shtrat, 10.000 shqip-tarë vijnë e bëjnë demonstratë në Pazar të Ri kundër vrasësve”*. Ky atentat përshkruhet nga Kukaj në një gazetë shqipe që botohej në Rumani. E në vitin 1941 ky artikull në gazetën “Kosova” është ribotuar prapë<sup>92</sup>. Blyta e shfrytëzoi këtë atentat të pasuksesshëm për ta forcuar pozitën e tij politike në Pazar të Ri. Me mbështetjen e tij, në zgjedhjet komunale të viti 1933 demokrati i ndjerë Dushan Davidoviq korri një fitore dërmuese mbi kundërshtarin Blytës, Gjorgje Petroviq nga JNS-a<sup>93</sup>.

Aqif Blyta dhe ish anëtarët e Xhemijetit nuk e ndalën veprimtarinë e tyre, pavarësisht kushteve dhe rreziqeve të mëdha. Në vitin 1934, në Prishtinë do të tubohet ilegalisht ish-pjesa e kryesisë së Xhemijetit, të cilin autori Prof. Dr. H Bajrami e quan “Kuvendi i panjohur i Prishtinës”. Në Kuvend do të marrin pjesë Ferhat Draga, Aqif Blyta, Salih Hoxha, Hoxhë Visoka, Bajram Ajvazi, Iliaz Agushi, Mustafë Dërguti, Sejdi Sekiraqa dhe, çuditërisht, Meto Bajraktari me Zenel Salihun (këta dy militantë do të iniciohen të marrin pjesë nga babai i Zenel Salihut, përndryshe i njohur si patriot që kërkonte hapjen e mundësisë që shkollimi shqip t’ia fillojë punës qoftë edhe ilegalisht).

Kuvendi do të debatohet për tri pika. Së pari do të debatohet që kolonizimi agrar i Kosovës me sllavë të luftohet me të gjitha mjetet. Së dyti në Kuvend do të debatohet për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Së treti ishte debatuar në bazë të një dokumenti që ishte sjellë nga Hoxhë Visoka, që ishte deputet i Mbretërisë Jugosllave (1931–1935) e të cilin ai e kishte siguruar konfidentalisht.

---

<sup>92</sup> Verli, M. (2017), Po aty. f. 102.

<sup>93</sup> Radović, M.(2007), Po aty. f. 139.

Dokumenti kishte të bëjë me shpërnguljen e shqiptarëve në Anadoll. Në fakt, ishte fjala për një “parathënie të konventës famëkeqe 1938”<sup>94</sup>. Radoviqi, në veprën e tij “Efendijina sećanja i kazivanja” (Kujtimet dhe tregimet e Efendisë), duke bërë fjalë për personalitetin e Blytës, citon Omer Efendi Konićanin: “*Edhe pas likuidimit të Xhemijetit, Aqif Blyta për pjesën më të madhe të myslimanëve (boshnjakët dhe shqiptarët – I.A.) në qytet dhe rrethinë mbetet politikani numër një. Në pikëpamje fetare, Aqifi ishte në rendin e tarikatis bektashi*”<sup>95</sup> dhe ndonëse nuk agjëronte, këtë nuk e publikonte asnjëherë. Megjithatë, shkonte në xhami. Ai ishte psikolog i mirë për ta përfutur disponimin e myslimanëve, dëshirat e tyre, andaj u fliste gjithmonë ajo që u shkonte përshtati. Aksionet politike dhe masat e tjera të ndryshme, që kohë pas kohe i ndërmerre pushteti dhe Partia Radikale, krijuan nga Aqifi, në sytë e pjesës së madhe të myslimanëve, luftëtarin dhe heroin kombëtar, mbrojtës të myslimanëve. Të gjitha këto ai i shfrytëzoi me mjeshtri. Në asketin ekonomik, ai i ka takuar grupit të myslimanëve më të pasur në qytet. Ishte kryetar i Këshillit Drejtues të Bankës Tregtare në Pazar të Ri, kryetar i Shoqatës së Tregtarëve, aksionar në Centralin Elektrik dhe pronar i dyqanit me mallra të përziera zejtare në Pazar të Ri. Blyta ka pasur njerëzit e vet në “Gajret”, “Merhamet” dhe në Këshillin e Vakëfit. Gjithë kjo i ka ndihmuar atij që gjatë kohës së Mbretërisë SKS dhe Mbretërisë Jugosllave të afirmohet si politikan

<sup>94</sup> Bajrami, H.(Aug 8, 2017) *Kë e akuzojnë plagët e Kosovës 1844-1999* (37). <http://www.epokaere.com/sq/Fejtone/Kuvendi-i-panjohur-i-Prishtin%C3%ABs-m%C3%AB-5-janar-1934>. (qasja tetor 15, 2017)

<sup>95</sup> Bektashizmi është rend sufi, që mendohet se është themeluar në Anadoll nga haxhi Bektash Veliu (në turq. Hacı Bektas Veli), që jetoi në shek. XII. Me zgjerimin e Perandorisë Osmane, kjo traditë filloi të përhapej nga Anadulli qendror, sidomos në Ballkan, Greqi. Kretë dhe gjetkë, ku bektashinjtë shërbyen si misionarë të Islamit dhe udhëheqës shpirtërorë të jeniçerëve: Robert Elsie, *Fjalori Historik i Kosovës*, Skenderbeg Books.Tiranë 2011, f. 85.

numër një nga radhët e Myslimanëve në trevën e Pazarit të Ri dhe rrethit të Dezhevës”<sup>96</sup>.

Blyta, i pandalshëm, duke iu bërë ballë të gjitha vështirësive, shkoi një hap më tej. Pas dhjetë vjetësh ai konkurroi si kandidat i pavarur në zgjedhjet për Parlamentin e Mbretërisë Jugosllavisë në vitin 1935, në qarkun e Shtavicës. Megjithatë, kandidatura e tij u refuzua. Për arsye se Blyta nuk dëshironte t'i japë përkrahje askujt, pjesëmarrja në zgjedhje ishte shumë më e ulët se më parë, sepse shumica dërrmuese e myslimanëve i bojkotuan zgjedhjet, ndërsa mandatin e fitoi avokati nga Beogradi dhe shok shkolle i Millan Stojadinoviqit, Zhivko Susiq. Ai më parë kishte qenë kryeshef i qarkut dhe deputet i parlamentit. Përndryshe, ai ishte shumë i popullarizuar në mesin e myslimanëve... Ndërkaq, nën presionin e qeverisë u tërhoq edhe kandidati Tihomir Sharkoviq për qarkun e Dezhevës<sup>97</sup>. Ashtu si shumë herë më parë, Blyta përsëri mbeti i palëkundur. Në zgjedhjet e fundit komunale para Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1936, ai i dha mbështetje Dushan Davidoviqit, por edhe Davidoviqi u përpoq ta kufizojë ndikimin Blytës. Prandaj së shpejti rihapet konflikt mes dy burrave mbi çështjen e taksave të komunës, të cilat duheshin paguar, ndërsa koncesioner kryesor ishte Blyta.<sup>98</sup> Duke parë se nuk mund të mbështetej as në Davidoviqin, Blyta përsëri u përpoq për ta marrë mandatin e deputetit. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1938 ai ishte kandidat i Bashkësisë Radikale Jugosllave (PRI) të Milan Stojadinoviqit në listën e partitërit të tij politik, Tihomir Sharkoviq, për qarkun e Dezhevës dhe Shtavicës. Edhe pse sipas Sharkoviqit, Milan Stojadinoviqit personalisht ishte kundër kandidaturave të tyre, ai ishte detyruar të

<sup>96</sup> Radoviq, M. (2007)., *Efendijina sećanja i kazivanja*, botimi i dytë.

<sup>97</sup> Živković, M. (2012). Po aty.

<sup>98</sup> Radoviq, M. (2007) po aty. f. 141.

lëshojë pe që Sharkoviqi dhe Blyta mos të kalojnë në opozitë. Mbështetja e Blytës për Sharkoviqin në këto zgjedhje ishte vendimtare, posaçërisht nëse merret parasysh se atë vit Sharkoviqi kishte falimentuar. Por, situata para zgjedhjeve ishte e tensionuar. Një nga rivalët e Blytës, i cili ishte mysliman, nuk ishte i kënaqur me mbështetjen që ky ia bënte Sharkoviqit, andaj u përpoq që ta vriste Blytën. Megjithatë, përpjekja e tij dështoi. Në ditën e zgjedhjeve vetë JRZ korri fitore, sepse shumica votuan për të, si serbët, ashtu edhe myslimanët<sup>99</sup>.

Aqif Blyta e fitoi mandatin e deputetit në qarkun e Shtavicës (Tutin) i banuar me shumicë absolute shqiptare. Disa muaj më vonë Tihomir Sharkoviq u zgjodh për senator, edhe pse i vetmi në tërë Jugosllavinë kishte kundërkandidatë në qarkun në të cilin ishte kandiduar. Kur lufta erdhi në këto krahina dhe kur filluan konfliktet etnike midis myslimanëve dhe shqiptarëve, në njërin anë, dhe serbëve, në anën tjetër, Blyta dhe Sharkoviq kanë mbajtur marrëdhënie të mira, të paktën në masën që situata politike ka lejuar<sup>100</sup>. Aqif Blyta në nivelin shtetëror dhe lokal mbeti politikisht aktiv deri në fillim të luftës dhe rënien e Jugosllavisë në prill të vitit 1941.

Sipas studiuesve serbë, Miodrag Radoviq dhe Vukoman Qullafiq, Blyta, nëpërmjet bashkëpunëtorit të tij, Ferhat Draga, i përforcoi kontaktet me shqiptarët në Kosovë dhe Dukagjin<sup>101</sup>.

Darko Tanaskoviq, duke bërë fjalë për Blytën, midis tjerash, thotë: *“Personalitetin e tij politik e ndërtoi në bazë religjioze dhe me përkushtim ndaj Islamit, si edhe karizmën personale dhe pasurinë e fituar gjatë periudhës midis dy luftërave, duke u marrë me tregti.*

<sup>99</sup> Crnovršanin, H. Sadiković, N. (1996). po aty. f. 199.

<sup>100</sup> Živković, M. (2012).

<sup>101</sup> Živković, M (2012),

*Sipas bashkëkohësve, Blyta ishte në ndikimin e sufizmit. Sidoqoftë, ai shpesh u shfaq në xhami të ndryshme, jo vetëm për shkak të ndjenjave fetare, por edhe për të mbajtur fjalime politike, në sajë të të cilave e përhapu ndikimin e vet politik<sup>102</sup>. Ai e kuptoi mirë Psikologjinë e masës dhe me shkathtësi përdori demagogjinë dhe popullzimin<sup>103</sup>. Përveç kësaj, një burim gjerman i viti 1941, e përshkruan Blytën si "figurë e markante, nga e cila shpërthejnë pamëshira dhe energjia"<sup>104</sup>.*

### ***Si përfundim***

Aqif Blyta është figura më e famshme historike e gjysmës së parë të shekullit XX në trevën e Sanxhakut lindor. Si i lindur në një familje të pasur në Novi Pazar, kjo i mundësoi arsimim në shkollat më të mira dhe në Akademinë më të mirë të kohës në Ballkan. Në fillim të vitit 1919, ai u kthye nga Turqia në vendlindje. Atëherë e fillon veprimtarinë e tij aktive politike, së pari në Xhemijet, pastaj në parlamentin jugosllav, ku deri në vitin 1925 dy herë kishte mandat deputeti, e mandej aktivitet gjysmë publik në nivel lokal. Përveçse ishte kreu i Xhemijetit për Sanxhak dhe sekretar i saj, ai ishte edhe kolumnist në organin e kësaj partie, gazetën "Hak". Duke i shfrytëzuar aftësitë diplomatike dhe lidhjet me ambasadën turke, ai arriti të ndikojë në uljen e shpërnguljes nga Sanxhaku dhe Kosova. Falë aftësive të tij intelektuale e politike dhe pasurisë së madhe që kishte fituar si tregtar, Blyta gëzonte autoritet të madh si në Sanxhak, ashtu edhe në Kosovë dhe jo vetëm te boshnjakët dhe shqiptarët, por edhe te serbët lokalë.

<sup>102</sup> Aktiviteti propagandues i Blytës ishte krejtësisht legjitime dhe shteti nuk mund të ndërhynte kundër tij.... Periudha e aktivitetit më intensiv ishte gjatë Ramazanit... D. Tanasković, "Islam i mi" (Islami dhe ne), Beograd, 2010, f. 306–307, 310–315

<sup>103</sup> Radović, M. (2007). *Efendijina sećanja i kazivanja*, Novi Pazar, 2007, f. 179.

<sup>104</sup> Živković, M. (2012),

---

**EMIN AZEMI**

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kultruore të Shqiptarëve  
– Shkup*

## XHEMIJETI, 100 VITE PAS

Para 100 viteve, konkretisht më 17 dhjetor 1919, në Shkup u formua organizata politike me emrin “Xhemijet” (Bashkimi), emri i plotë i së cilës ishte “Islam Muhafaza-yl Hukuk Cemijet” (Shoqata Islamike për Mbrojtje dhe Drejtësi). Kryetar i parë i saj u zgjodh Nexhip Bej Draga, i cili fillimisht ishte deputet në Parlamentin Osman, kurse në vitin 1908 ishte kryetar i Klubit kulturor “Shkupi”. Më vonë ai do të zgjidhet deputet edhe në Parlamentin e Mbretërisë SKS në Beograd. Nënkryetar i Xhemijetit ishte Sheh Sadudini nga Tetova, ndërsa sekretar – Aqif Blyta nga Pazari i Ri.

### *Kurthet e konstatimeve sipërfaqësore*

Shumëkush që nuk është ndalur të analizojë arkivin e kësaj organizate, do të mund të bie shumë shpejt në kurthin e një konstatimi sipërfaqësor se gjoja Xhemijeti merrej kryekëput me mbrojtjen interesave fetare në popullatën e atëhershme (shqiptarë, turq, boshnjak etj.), por në fakt atributin fetar e kishte vetëm petk. Xhemijeti ndryshe edhe nuk mund të regjistrohej e as të funksiononte në terren. Autoritetet mbretërore të kohës e kishin lejuar themelimin kësaj organizate me idenë se ajo do të merret kryekëput me çështje fetare, por ngjarjet e mëvonshme e vërtetuan të kundërtën.

Xhemijeti, në thelb, ishte një organizatë që thellë në prapavijë e sendërtonte betejën politike kombëtare, kurse fenë e kishte vetëm si paravan për t'i fshehur idetë primare që i kishte.

E themeluar vetëm një vit pasi ishte formuar Mbretëria SKS, Xhemijeti erdhi mu në kohën kur në hapësirën shqiptare jashtë Shqipërisë londineze, pas shpalljes së pavarësisë më 1912, ekzistonte një vakum total i organizimit politik. Jemi në kohën kur shqiptarët ndodheshin në mes të disfatës turke dhe triumfit sllav në këto troje, ndërkohë që gjunjëzimi më i madh kishte ndodhur në Betejën e Kumanovës (23–24 tetor 1912).

Konteksti kohor kur u formua Xhemijeti përkonte me shumë ngjarje dramatike që ndodhën menjëherë pas Luftës së Parë Botërore, kurse shtrirja dhe ndikimi i kësaj organizate luajti rol vendimtar në kanalizimin e disa proceseve të rëndësishme që lidheshin me fatet e popullit shqiptar.

Xhemijeti erdhi pas planit 14 pikësh të presidentit amerikan, Woodrow Wilson, të prezantuar në Konferencën e Parisit pak muaj më parë, dhe pas formimit të Komiteti “Mbrotja Kombëtare e Kosovës” më 1 maj 1918.

Xhemijeti u formua katër vite para nënshkrimit të Konventës së Lozanës (30 janar 1923), atë vit kur ishte themeluar edhe Republika e Turqisë, marrëveshje kjo e veçantë turko-greke, që kishte për objektiv shkëmbimin e grekëve të Anadollit me “turqit” e Greqisë (këtu u përfshinë edhe shqiptarët e besimit mysliman nga Çamëria). Në frymën e kësaj marrëveshje filloi edhe përgatitja e terrenit për shpërnguljen e “turqve” (lexo: shqiptarëve) nga trojet e tyre stërgjyshore nën Mbretërinë SKS.



Xhemijeti, pas formimit, doli me një sërë kërkesash politike për autonominë e plotë fetare, për vazhdimësinë e gjyqeve të Sheriatit për çështjet civile, për ruajtjen e vakëfeve, për “përdorimin e lirë dhe zyrtar të gjuhës përkatëse amtare të joserbëve në shkolla” dhe për mbrojtjen e pronave të bejlerëve nga reformat e reja agrare. Mirëpo, të gjitha kërkesa ishin formale, ndonëse edhe ato të qenësishme, ndërkohë që krerët e kësaj organizate kishin objektiva të tjera, të cilat vetëm më vonë do të nxjerrin krye.

Objektet fetare (xhamitë dhe mejtepet) ishin vatrat kryesore ku ishte shtrirë aktiviteti i vetëdijesimit kombëtar të popullatës, sepse vetëm në këtë formë të kamufluar mund të veprimej papengueshëm.

Xhemijeti ishte vazhdimësi e përpjekjeve politike e kombëtare të shqiptarëve pas nënshtrimit që ndodhi me mbetjen e territoreve shqiptare pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912, Disa vite më vonë organizimi politik e ushtarak i shqiptarëve filloi të merrte konturat e veta organizative, fillimisht me formimin e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, i cili kishte tri forma të organizimit: aktivitetin diplomatik (të cilin e zhvillonte kryesisht Hasan Prishtina), rezistenca e armatosur, përmes lëvizjes kaçake (Azem Bejta me shokë...) dhe organizimit politik, që rezultoi me formimin e organizatës legale politike Xhemijeti.

Në kushte të disfavorshme politike e sociale, Xhemijeti arriti ta ruajë kontinuitetin e veprimit të vet deri në vitin 1925, kur edhe u ndërpre aktiviteti i tij pas ndërhyrjes brutale së autoriteteve jugosllave dhe pas arrestimit të krerëve të Xhemijetit.

Por, edhe pse në rrethana të vështira, kjo organizatë politike arriti të faktorizohet në skenën atëhershme pluraliste, duke bërë koalicion

me Partinë Radikale të kryeministrit Nikolla Pashiq, në vitin 1923, i cili, edhe përkundër dëshirës së tij, ishte i detyruar të bëjë aleancë politike me Xhemijetin për arsye se rival e kishte Partinë Demokratike Serbe, me të cilën kishin mospajtime të mëdha ideologjike e politike.

Pas pëlqimit të krerëve të Xhemijetit për të bërë koalicion me radikalët serbë fshihej qëllimi i tyre që disa objektiva programore t'i bëjnë pjesë të politikës zyrtare të Beogradit, që përfshihen në këto pika: hapja e shkollave shqipe, ndalja e kolonizimit dhe reformës agrare, kthimi i pronës së rrëmbyer padrejtësisht etj.

### ***Kërkesat kombëtare të Xhemijetit e irrituan Beogradin***

Por, marrëdhëniet e deputetëve të Xhemijetit më vonë u përkeqësuan, kjo si pasojë e mospërmbyesjes së kërkesave të tyre nga ana e radikalëve të Pashiqit dhe kjo kishte mjaftuar që politikanët e Shkupit të kërkonin aleatë të rinj, fillimisht (më 1924) duke kokeutuar me Partinë Popullore Fshatare Kroate, e cila ishte forca më e madhe politike që i kundërshtonte politikat centriste e nacionaliste të Beogradit.

Po atë vit Pashiqi e dërgoi njeriun e tij më të besueshëm, Punisha Raçiq, në Kosovë, që të takohej me zyrtarë vendës serbë, si dhe për të përgatitur kushtet paraprake për një fushatë obstrukcioni dhe frikësimi, me qëllim që të shkatërrohej Xhemijeti në këtë rajon. Në janar të vitit 1925, dy muaj para zgjedhjeve të përgjithshme, Ferat Draga, së bashku me aktivistë të tjerë të dalluar u arrestua, duke përfshirë edhe gazetarët e revistës së Xhemijetit "Hak", gjithë kjo në prag të zgjedhjeve. Për rrjedhojë, Ferat Draga u dënua me 20 vjet burgim. Më pas, pasi u lirua dhe u ftua në Beograd që të bënte një ujdi politike me Pashiqin, por asgjë s'doli nga kjo marrëveshje,

kështu që në vigjilje të zgjedhjeve të reja, më 1927, ai u burgos sërish dhe u dënua edhe një herë me 20 vjet burgim. Partia e Xhemijetit u dobësua nga ky sulm, si dhe nga përçarjet e brendshme, u shthur dhe pushoi së ekzistuari si forcë politike. Revista “Hak” pushoi së botuari, u arrestuan edhe disa liderë tjerë të kësaj partie, kurse një ndër intelektualët e spikatur të kësaj kohe, Nazim Gafurri, gjatë majit të vitit 1927 u vra, sepse i kishte kritikuar publikisht metodat e kërcënimit që u zbatuan gjatë zgjedhjeve lokale nga zyrtarët serbë.

Për të goditur, jo vetëm krerët, por edhe infrastrukturën fetare, qeveria jugosllave në vitin 1925 e rrënoi xhaminë Burmalë (afër Urës së Gurit në Shkup) dhe në vend të saj e ndërtoi Pallatin e Oficerëve, që simbolizonte edhe arkitekturën e ere të imponuar serbo-sllave, në inaugurimin e së cilës kishte qenë vet Mbreti, Aleksandar Karagjorgjeviq.

Çuditërisht, shumë vite më vonë, pikërisht në të njëjtin vend, disa karagjorgjeviqë të rinj të Shkupit, të veshur me petkun e nacionalizmit të lodhur maqedonas, e rindërtuan sërish Pallatin e Oficerëve, në shenjë nostalgjie e nënshtrimi ndaj pushtuesve serbë, duke mos lejuar kategorikisht edhe njëherë ngritjen e xhamisë Burmalë, aty ku kishte qenë deri në vitin 1925. Kjo dëshmon se aleancat ballkanike sllavo-ortodokse kundër shqiptarëve nuk kanë pushuar, sado që veprimi i tyre në dukje mund të ketë një formë ose stil tjetër. Esenca ka ngelë e njëjta.

### *Xhemijeti si lajthitje për të painformuarit*

E ideuar si parti antikomuniste, me prapavijë fetare, Xhemijeti shumëkujt i shkaktonte lajthitje. Lajthitja e parë ndodhi me autori-

tetet jugosllave, të cilët e lejuan Xhemijetin të funksionojë, sepse mendonin që krerët e saj do të merreshin vetëm me çështje fetare.

Lajthiça e dytë ndodhi atëherë kur Nikolla Pashiqi lidhi koalicion me Xhemijetin, me idenë se po e lufton komunizmin përmes një partie që kishte petk fetar.

Lajthiça e tretë kishte ndodhur se gjoja Xhemijeti ishte zgjatim i politikës turke në Ballkan, konkretisht e presidentit të atëhershëm të Republikës së Turqisë, Mustafa Kemal Atatürk. Mirëpo, fushëveprimi në terren i Xhemijetit dëshmoi se jo vetëm që nuk ishte proturke, por ishte kundër shumë politikave zyrtare turke që i dëmtonin interesat vitale kombëtare të shqiptarëve. Xhemijeti, në esencë, kishte frymë laike dhe aspak anadollake, por në formë dukej si fetare.

Si organizatë që e pengoi kolonizimin, reformën agrare dhe shpërnguljen e shqiptarëve për Turqi në periudhën mes dy luftërave botërore dhe si fuqi politike emancipuese në rrafshin arsimor e kulturor, Xhemijeti do të mbetet një prej gurëve më domethënës kilmotrikë në rrugëtimin vështirë të shqiptarëve për të siguruar më shumë dinjitet e prosperitet kundrejt aspiratave grabitqare të fqinjëve ballkanikë.

Vetë mënyra si përfundoi Xhemijeti dhe hakmarrja mizore që u shkarkua mbi krerët e saj nga ana e autoriteteve të Beogradit, që rezultoi me disa dhjetëra vite burg, me reprezalje dhe grabitje të pronave të tyre, flet për karakterin e kësaj organizate, e cila në thelb u krijua për ta mbrojtur substancën kombëtare të shqiptarëve në vitet e muzgut sllav midis dy luftërave botërore.

(Dhjetor, 2019)

---

**MEHMET PRISHTINA**

*Pasardhës i Hasan Prishtinës*

## **“XHEMIJETI”, VAZHDIMËSI E PËRPJËKJEVE PATRIOTIKE SHQIPTARE**

Edhe pse kanë kaluar 100 vite, jehona e organizatës “Xhemijeti” i tejkalon përmasat kohore në të cilën veproi ajo, madje përmasat e veprimtarisë së saj sa vijnë e shtohen, kjo për arsye se konteksti dhe vizioni i kësaj organizate e determinonte përshpejtimin e një zgjidhje kombëtar e kulturor të shqiptarëve, si mekanizëm i domosdoshëm i kundërvënies ndaj politikave hegjemoniste sllave për ta shpërfytyruar karakterin identitar të etnisë shqiptare në vitet e Mbretërisë Serbo Kroate Sllovene.

Në fakt Xhemijeti ishte vazhdimësi e përpjekjeve të pareshtura të patriotëve shqiptarë, në krye me Hasan Prishtinën, që kishin ndodhur paraprakisht, për ta projektuar në një program politik platformën e emancipimit politik e kulturor të shqiptarëve dhe etnive më të vogla, të cilat po përjetonin apartheidin më të rëndë nën thundrën serbe, menjëherë pas largimit të administratës osmane nga këto troje.

Gjatë hulumtimit tim shkencor dhe me rastin e 100-vjetorit të Xhemijetit po u sjellim dokumente të reja arkivore, që po botohen për herë të parë nga frëngjishtja, kjo me qëllim të dokumentimit të kërkesave të vazhdueshme të shqiptarëve dhe që të korrigjohet copëtini i padrejtë i kufijve shqiptarë. Siç dihet, më shumë së gjysma e territorit dhe popullit shqiptar, me vendimin e Konfe-

rencës së Ambasadorëve në Londër më 1913 , mbeti jashtë trojeve të Shqipërisë Londineze.

Në vazhdim do ta paraqesim prononcimin e kryeministrit britanik, Z. Asquith, në Dhomën e Komunave në Londër: *«Ne nuk do ta fusim kurrë shpatën në këllëf, ndërsa nuk e kemi nxjerrë me lehtësi, para se Belgjika dhe unë po i shtoj sot edhe Serbinë, ta kenë fituar tërë atë që kanë sakrifikuar, madje edhe më shumë»*

Kjo deklaratë i shqetëson seriozisht të gjitha qarqet nacionaliste shqiptare. Tashmë, gjatë mbledhjes së konferencës së Londrës, më 1913, Shqipëria e gjorë kishte pësuar dhimbje të skajshme, duke parë që një pjesë e madhe e territoreve etnikisht dhe kryesisht nacionale, të populluara prej më shumë se një milion shqiptarësh të pastër, t'i jenë dhënë Serbisë dhe Malit të Zi, të cilat nuk kanë realizuar kurrfarë progresi serioz në lëmin e civilizimit.

Për ta fshehur regjimin e terrorit dhe tmerret e padenja të kryera ndaj familjeve pa mbrojtje, qeveria serbe kishte urdhëruar, që nga muaji tetor 1913, ligje e të cilat parashiheshin dënime drakoniane. Nenet më të ashpra parashihnin dënime prej 3 deri në 10 vjet punë të detyrueshme për personat që nuk do t'i denonconin kryengritësit (rebelët), pastaj ata që flisnin sado pak kundër nëpunësve të shtetit etj....

Ne pyesim me ankth se çfarë do t'i ndodhte kombit tonë të pafat nëse serbëve dhe malazezve do t'u jepeshin edhe më tutje territore shqiptare? Ne rrëqethemi sa herë që na shkon mendja se vëllezërit tanë mund të bien e ribien nën zgjedhën e tiranëve, të cilët nuk kanë aspak mëshirë e të cilët janë betuar që ta shfarosin rrënjën shqiptare.

Në anën tjetër, qeveria helenike, e cila sipas deklaratave të saj, e kishte pushtuar Shqipërinë mesdhetare, shihet se ka për qëllim që përfundimisht t’ia aneksojë territoret tona mbretërisë greke.

Dokumentet e reja arkivore shprehin autenticitetin e përpjekjeve titanike të lëvizjes patriotike shqiptare, në krye me ideologun Hasan Prishtina, në sensibilizimin e temave që do të jenë në fokusin e Konferencës së Paqes në Paris. Këto dokumente, të përkthyer nga frëngjishtja, mund të jenë edhe një ndihmesë shtesë për zgjerimin e observimit tim hulumtues edhe me rastin e 100–vjetorit të Xhemijetit, që është njëherësh edhe tema bosht e kësaj konference shkencore.

Autorë të ndryshëm iu kanë qasur kësaj tematike nga kënd–vështrime të ndryshme, por për mua ka qenë me rëndësi ta analizoj kontekstin historik të dy ngjarjeve të rëndësishme që ndodhën para një shekulli, siç janë Konferenca e Paqes në Paris dhe organizata politike Xhemijeti

Përderisa Presidenti Udro Uilson në Paris po e formatizonte një rrugëtim tjetër të popujve të Ballkanit, përfshi edhe shqiptarët, Xhemijeti, në anën tjetër, po i jepte fuqi këtij rrugëtimi, duke e jetësuar në praktikë frymën dhe porosinë e projektit 14–pikësh të Wilsonit mbi perspektivën e popujve të Ballkanit. Ndërkaq, diku në mes qëndronte figura kolosale e Hasan Prishtinës, i cili përveç që ishte frymëzuesi kryesor i lëvizjes shqiptare në periudhën pas pa–varësisë së Shqipërisë, edhe ai – si për ko incidencë – u paraqit me platformën e tij prej 14 pikash, ku vizioni i mëvetësisë shqiptare në trojet e veta etnike do të marrë pastaj një formë pak a shumë më programatike me themelimin e Xhemijetit.

Rëndësia e Hasan Prishtinës në historinë politike shqiptare qëndron në faktin se ai, si ideolog kryesor i Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës, i artikuloi drejt interesat kombëtare të më shumë se gjysmës së kombit që kishte mbetur jashtë Shqipërisë Londineze, kurse Xhemijeti do të bëhej zëdhënës mjaft i fuqishëm i këtij artikulimi politik.

Për të zbërthyer më mire këtë kontribut, në vazhdim po e japim letrën e Hasan Prishtinës dërguar presidentit amerikan Udro Uilson në Paris më 18 dhjetor të vitit 1918:

*“Z. Kryetar,*

*Ju jeni duke u përgatitur të merrni pjesë në kongresin i cili duhet ta rikonstruktojë Europën në parimet e së drejtës së popujve që vet të vendosin për fatin e tyre, parime për të cilën lavdia e të shënuarit në flamurin e njerëzimit ju takon juve.*

*Në këtë moment solemn ne, përfaqësuesit e dy milionë e gjysmë shqiptarëve – popullit më të vjetër të gadishullit Ballkanik, ju drejtohem juve me lutje që t’i shqyrtoni dëshirat e popullit tonë për paanshmëri të plotë, i cili aq shumë ju dallon nga të tjerët, dhe të na mundësoni që këto dëshira t’i dorëzojmë në Konferencën e Paqes.*

*Gjatë shumë shekujve dhe me shumë vështirësi me të cilat duhej të ballafaqohej, megjithatë populli jonë e ruajti gjuhën e vet, origjinin e vet, traditat e veta. Pesë shekuj te plotë populli jonë me një rezistencë të fuqishme i kundërvihet presionit otoman dhe në fund ja mori pushtetit turk të gjitha ato të arritura të mëdha me shfaqizimin e tij në vitin 1912. Është e vërtetë se në takimin e ambasadorëve në Londër në 1913 u krijua Shqipëria e pavarur, por pjesa më e madhe e shqiptarëve mbeti jashtë kufijve të këtij shteti.*



*Prandaj, proklamimi i juaj, që kishte të bënte me të drejtat e popujve që vetë të drejtojnë me fatin e tyre, populli shqiptar e priti si porosi të një shpëtimtari. Nuk dyshojmë se Ju, zoti Kryetar, së bashku me aleatët Tuaj të kombit shqiptar, do t'i mundësoni të drejtat e njëjta siç i gëzojmë edhe armenët, çekët, jugosllavët dhe kombet tjera.*

*Kombi shqiptar, i cili dha aq shumë viktima për realizimin e idealit të vet nacional dhe për këtë qëllim derdhi aq shumë gjak, mbetet i bindur se ju dhe aleatët tuaj do t'u vini fund vuajtjeve në emër të së drejtës dhe barazisë.*

*Të bindur në këto premisa, ne Ju drejtoheni me lutje, Z. Kryetar, që ta shfrytëzoni ndikimin tuaj që gjatë kohës së bisedimeve, të cilat kanë të bëjnë me ardhmërinë e Shqipërisë, që në Konferencën e Paqes të ftohet për pjesëmarrje edhe delegacioni i popullit shqiptar, që t'i paraqesë dhe arsyetojë dëshirat dhe kërkesat e kombit shqiptar.*

*Ju drejtojmë, z Kryetar, respektin tonë të thellë!*

*Në emër të kombit shqiptar!*

*Hasan Bej Prishtina” (nënshkrimi)*



# RECENSION



**ADEM ZEJNULLAHU**

*Instituti Albanologjik – Prishtinë*

## DËSHMI HISTORIKE PËR KONTRIBUTIN E FERAT BEJ DRAGËS DHËNË ÇËSHTJES KOMBËTARE

(Jusuf Osmani & Asllan Murati, *Ferhat Bej Draga shembull atdhetarie* (dokumente), Kolegji AAB, Prishtinë, 2018, f. 484.)

### *1. Fjalë hyrëse*

Në vargun e figurave më të shquara të kombit tonë, Ferat bej Draga zë një vend të veçantë në kohën kur jetoi dhe veproi. Ai, me angazhimin e tij, u bë simbol i qëndresës, sakrificës dhe atdhedashurisë.

Ky personalitet i njohur rrjedhë nga një familje me traditë të pasur kombëtare, e cila gjatë tërë jetës nuk kurseu asgjë nga jeta dhe pavarësia e saj për sendërtimin e idealeve të larta kombëtare për çlirim dhe pavarësim të të gjitha viseve shqiptare.

E kaluara e popullit tonë gjatë historisë karakterizohet me përpjekje, luftëra e sakrifica të panumërta gjatë shekujve për çlirim dhe pavarësim të atdheut nga sunduesit e huaj. Këtë fat të keq e trashëgoi edhe familja Dragaj, sidomos Ferhat Dragaj, i cili deri në momentin e fundit të jetës veproi dhe sakrifikoi për çështjen kombëtare.

Veprimtaria patriotike e kombëtare e këtij atdhetari zhvillohet në periudhën kohore të sundimit të Perandorisë Osmane dhe të

Mbretërisë SKS, të cilat nuk lanë pa përdorur asnjë mjet dhe metodë më të vrazhdë për ta zhbërë qenien tonë kombëtare.

Vepra monografike “Ferhat bej Draga – shembull atdhetarie” (dokumente), e Jusuf Osmanit dhe Asllan Muratit, përmban në vete tërë veprimtarinë jetësore e kombëtare të kësaj figure të shquar në raport me popullin, atdheun dhe pushtuesit e huaj. Kjo vepër, në rrafshin historik, analitik dhe semantik ka një rëndësi të veçantë. Ajo kumton fuqishëm me akte e fakte, në kohë e hapësirë të caktuar, për realitetin jetësor e historik të popullit tonë në një periudhë tejet të vështirë të mbijetesës kombëtare. Të dhënat e paraqitura bazohen në burime dokumentare arkivore, në kronika, në bibliografi historiko-shkencore, si dhe në letërkëmbimet konsullore të Shqipërisë dhe të vendeve të tjera ballkanike dhe evropiane që ishin të angazhuara për çështjen shqiptare. Monografia përmban 240 dokumente të rëndësishme arkivore.

Këto dokumente të shumta dhe të larmishme karakterizohen me të dhëna të shumta, konstatime dhe vlerësime të ndryshme, varësisht nga koha, kushtet dhe rrethanat që i kanë kushtëzuar e determinuar qëllimet e palëve kundërshtuese. Disa sosh flasin për mbijetesën e popullit tonë nën robërinë e huaj, të tjerat për sundimin, shkatërrimin, shpërnguljen dhe shfarosjen për qëllime politike e ushtarake dhe ekonomike të tij. Të dhënat e ndryshme dokumentare, në radhë të parë, dallojnë nga kush jepen dhe çfarë qëllimi kanë: a janë në shërbim të shtetit okupues, individëve, institucioneve, mjeteve të informimit, apo ka ndonjë përpjekje të vogël nga individët, shoqatat e ndryshme e, veçmas, konsullata shqiptare, që angazhohen për të mirën e shqiptarëve nën robërinë e pushtuesve të huaj etj.

Sipas dokumenteve të përfshira në këtë vepër monografike, shihet qartë se shqiptarët pas vitit 1912, kur tokat tona u pushtuan nga

sllavo–bizantinët, i nënshtrohen një vuajtje dhe shfarosjeje kriminale, individuale e kolektive, sistematike institucionale shtetërore nga këto hapësira etnike.

Serbo–sllavët në Mbretërinë SKS hartuan me kohë programe e memorandume të shumta, nënshkruan marrëveshje e konventa të ndryshme për shpërnguljen e shqiptarëve dhe popullzimin e tokave të tyre me ardhacakë sllavë.

Ideja serbe për zgjerim në jug shprehet qysh në kohërat e hershme, si në veprën e Ilija Garashaninit "*Neçartania*" (1844), Programi i Depërtimit në Det (1881), programi i likuidimit të shqiptarëve (1920), Elaborati i Çubriloviqit (1937), Programi i Ivo Andriqit (1939), Programi i Moleviqit (1941), Programi i Drazha Mihajloviqit (1942), Elaborati i Çubrilloviqit (1944 dhe 1945), programi për likuidimin e shqiptarëve (1950), Memorandumi i Akademisë Serbe (1986), si dhe "*Patkoj*" dhe "*Osveta*" (Hakmarrja) në luftën e fundit në Kosovë të vitit 1999, të cilat u plotësuan, u zbatuan dhe u vunë në veprim nga pasardhësit e tyre.

Pushtuesit e huaj, sidomos ata serbë, në vazhdimësi vepruan në mënyrë të pandërprerë dhe institucionalisht kundër popullit tonë në shumë plane, si: **në aspektin politik, ushtarak e diplomatik; në aspektin ekonomik, duke zbatuar reforma agrare; dhe në diskriminimin arsimor e kulturor.**

Të gjitha këto veprime armiqësore kundër shqiptarëve bëheshin me të vetmin qëllim – që në tokat shqiptare të mos ketë shqiptarë dhe në vend të tyre të ketë sllavë.

Realiteti jetësor e historik i shqiptarëve, në këto rrethana tejet të vështira, bëhej gjithnjë e më i padurueshëm. Por, jeta dhe historia e popujve të robëruar e ka dëshmuar të kundërtën – sa më e madhe

të jetë dhuna e pushtuesit ndaj një populli, aq më e fuqishme bëhet rezistenca, kundërshtimi, lufta dhe sakrifica e tij për të mbijetuar, për t'u çliruar dhe për ta mundur atë. Edhe shqiptarët iu kundërvunë kësaj dhune të vazhdueshme në mënyrë energjike me personalitetet e njohura kombëtare, siç ishin: Isa Boletini, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Ferhat Bej Draga, Sherif Voca, Sali Gjuka, Bedri Pejani, Zyhri Ohri etj. Këto personalitete të shquara kombëtare e koordinuan aktivitetin dhe organizimin e tyre me Mehmet Pashë Derallën në Dibër, në Elbasan, në Vlorë, si dhe me të gjithë ata patriotë të tjerë që për ideal, synim jete kishin çlirimin dhe parësimin e tokave shqiptare.

## ***2. Shqiptarët ngjasojnë me zogun e diellit***

Vepra “Ferat bej Draga shembull atdhetarie” (dokumente), e Jusuf Osmanit dhe Asllan Muratit, përfshin në vete ngjarjet dhe personalitetet më të rëndësishme të periudhës kohore 1908 e deri në përfundimin të Luftës së Dytë Botërore (1941–1945) dhe kontrbutin e kësaj figure të shquar dhënë çështjes kombëtare kundruall dhunës së egër serbo-sllave.

Historikisht e keqja më e madhe ndaj popullit shqiptar në trojet e veta etnike i vjen me ardhjen sllave në Gadishullin Ballkanik në shek. VI, VII, të cilët, sipas legjendës serbe, thuhet se që u dynden në jug e morën ***Zotin e Zjarrit, Bed.*** Duket se legjenda përkon shumë me realitetin historik të këtij populli, ngase, siç dihet, sllavët e jugut kudo që shkonin digjnin çdo gjë para vetes, e bënin tokë të djegur dhe pastaj fillonin ta shfrytëzonin si të veten.

Veprimet e tilla kriminale i nxiti dhe i frymëzoi edhe më tepër Petri i Madh i Rusisë, që dikur thoshte: “*Suedia e pushtuar, Persia e pushtuar, Polonia e nënshtruar, Turqia e zaptuar, ushtritë tona të*



*bashkuara, Deti i Zi dhe deti Baltik nën rojat e anijeve tona.*”<sup>105</sup> Udhëzimin e zotit të zjarrit **Beda** dhe porosinë e mbretit rus, serbët e zbatuan në mënyrë më të egër ndaj popullit dhe tokave tona të pushtuara, duke djegur, shkretuar, shpërngulur e vrarë pa mëshirë shqiptarët. Ata u munduan me shekuj ta zhbëjnë qenien tonë kombëtare nga këto hapësira etnike, duke vepruar institucionalisht me plane e programe të hartuara për këtë qëllim ogurzi.

Po të vështrohet me kujdes e kaluara jonë gjatë rrjedhave historike nëpër të cilat kemi kaluar, në përballje të vazhdueshme me vuajtje, qëndresë, luftëra, sakrificë e tragjedi të panumërta në historinë e kombeve të ndryshme, të rrallë janë ata popuj në botë që kanë mundur të përballojnë dhe të mbijetojnë sikur shqiptarët. Në këtë kontekst kohor, shoqëror e historik populli i ynë më tepër se çdo popull tjetër në botë i përngjan zogut të diellit, **Feniksit**, i cili sipas mitologjisë shumë herë u dogj dhe u ringjall nga hiri i vet. I tillë ishte edhe populli i ynë gjatë historisë.

Serbët, për të qenë sa më të suksesshëm në qëllimet e tyre kriminale e djallëzore për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi e në vende të tjera të botës, planifikuan dhe zbatuan reformën agrare – kolonizimin që kishte karakter ekonomik dhe politik. Qëllimi i Nikolla Pashiqit dhe Kral Petrit, sidomos pas vitit 1918–1941, ishte që shqiptarëve t’ua merrte tokën e bukës, të mos kenë me çka të jetojnë, të detyrohen ta braktisin atdheun, të shpërngulen në mënyrë masovike në Turqi e në vende të tjera të botës.

Sipas dokumenteve të paraqitura në këtë vepër, me tokën e paktë që qeveria serbe ua linte shqiptarëve, prej 0, 40 për familje që numëronte prej 30–78 anëtarë, ata nuk mund ta siguronin as për së

---

<sup>105</sup> Shih: Gazeta SHEKULLI, Tiranë më 14.6. 1999, fq. 12.

afërmi bukën e gojës. Por, edhe për këtë pjesë toke qeveria serbe me vështirësi u lëshonte tapitë, edhe pse nga tri herë në vit detyroheshin ta paguajnë tatimin.

Që nga vitet 1912, 1918, e deri në rënien e Aleksandër Ranoviqit më 1966, më tepër se gjysma e popullatës sonë është shpërngulur nga tokat e veta. Këtë e dëshmojnë dokumentet arkivore të paraqitura në veprën e këtyre dy bashkautorëve. Marrjen e tokave të shqiptarëve dhe dhënien e saj ardhacakëve sllavë pushteti serb e shoqëronte me dhunë të egër, duke futur derra nëpër oborret e shqiptarëve, i rrlhnin, i çnderonin kryefamiljarët etj. Për të qenë sa më të suksesshëm në veprimet e tyre kriminale, ata kohë pas kohe përdornin “**Errfinë**”, ku armata dhe xhandarmëria serbe zbatonin ligje të egra ushtarake, duke djegur e vrarë popullin shqiptar pa ligje e gjyqe.

Nën sundimin serbo-sllav shqiptarët ishin të diskriminuar edhe në aspektin arsimor e kulturor. Ata nuk kishin asnjë shkollë fillore në gjuhën amtare, as gazetë e as shtypshkronjë. Madje, edhe ata pak shqiptarë që gjenin ndonjë mundësi për t’u shkolluar, ishin të detyruar që mësimet t’i ndiqnin në gjuhën e pushtuesit. Po të gjendej ndonjë libër shqip në familje shqiptare, ndëshkimet e pushtetit serb ishin shumë të rënda: rrahje, dënime e burgosje të gjatë e të mundimshme. Nikolla Pashiqi, kryeministër në Mbretërinë SKS, urdhëronte zëshëm: *Arnauta treba tučiti i mučiti, i ne daj mu da uči!* (Shqiptarin mundoje e torturoje, por mos e lë të mësojë!). Këtë më së miri e dokumenton kjo ngjarje që ka ndodhur në vitin 1937. Ramadan Hysen Shala nga Kopiliqi i Ulët, Drenicë, ishte talebe (nxënës) i Fahri ef. Gjakovës, Drejtor i Medresesë së Madhe në Gjakovë. Duke u kthyer nga Gjakova në vendlindje, Ramadani e merr me vete dhe e fsheh në mesin e librave të tjera edhe një abe-

tare shqip. Në rrugë e sipër e ndal xhandarmëria serbe, e cila ia kontrollon librat dhe kur ia gjejnë abetaren shqipe, tërbohen dhe e detyrojnë më dhunë që t'i hajë 3 kg. kripë. Ramadani sëmuret keq. Kur dëgjon ef. Fahri Gjakova, shkon e merr dhe e dërgon në spital. Ramadani mezi shërohet, por thonë se kurrë gjatë jetës së tij më nuk ka arritur t'i ketë më se 45 kg. Madje, për t'i ikur represionit të pushtetit serb, ai detyrohet të shpërngulet në Shipol të Mitrovicës, ku ndërron jetë më 1966 dhe varroset në varrezën e këtij fshati.<sup>106</sup>

Në këto rrethana tejet të ndërlikuara dhe të vështira për popullin tonë, nën sundimin serbomadh, kur shqiptarët dhe Shqipëria në qarqet ndërkombëtare gëzonte pak ose aspak përkrahje për të mirën e popullit dhe të shtetit, në skenën politike e diplomatike dolën personalitetet e njohura kombëtare, të cilat dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm për ruajtjen dhe avancimin e qenies sonë kombëtare. Kështu, kontributi i familjes Draga për çështjen shqiptare ishte i madhe dhe i shumëllojshëm. Natyrisht, veprimtaria e saj zhvillohej në kushte shumë të vështira politike e ekonomike, në përballje të vazhdueshme me dhunën e egër institucionale e shtetërore të pushtuesve serbo-sllave.

Sipas dokumenteve arkivore të paraqitura në veprën Jusuf Osmanit dhe Asllan Muratit, familja Draga trashëgonte një pasuri të madhe në Pazarin e Ri që nga koha e sundimit të Perandorisë Osmane. Këtë pasuri e kishte krijuar gjyshi i Dragës, Aliu, imam në qytetin e Jeni Pazarit, i cili po ashtu kishte qenë edhe njëri ndër prijësit më të dalluar në Luftën e Plevlës, pastaj pjesëmarrës në Lidhjen e Prizrenit, deputet në Parlamentin Osman dhe, mbi të gjitha, ishte unifi-

---

<sup>106</sup> Të dhënat i mora nga Mulla Asllan Murati më 15. 5. 2017.

kues i boshnjakëve dhe shqiptarëve për çështjet më të rëndësishme për fatin e këtyre dy popujve. Ai, me veprat e tij, u bë figurë e njohur e kohës. Sukseset e Aliut i vazhduan edhe pasardhësit e tij: Ajdin, Nexhip dhe Ferat Draga, të cilët luftuan dhe sakrifikuan shumë për të mirën e atdheut.

Ferhat bej Draga më 1915 e ndihmoi Hasan Prishtinën në formimin e Organizatës Legale Kulturore e Arsimore “Bashkimi” të Mitrovicës, e cila në brendi e kishte “Komitetin e Kosovës”, një organizatë kjo politike e ushtarake ilegale për çlirimin e tokave shqiptare nga pushtuesit e huaj, me qëllim të bashkimit të të gjitha viseve shqiptare në një shtet të vetëm shqiptar.

Pas vdekjes së Nexhip Dragajt, i cili e udhëhiqte organizatën e njohur si “Xhemjet” (Bashkimi), të themeluar në vitin 1919 në Shkup, Ferhat bej Draga emërohet kryetar i saj. Xhemjeti, në kohën e vet, luajti një rol të jashtëzakonshëm për çështjen shqiptare. Ajo në të vërtetë ishte një organizatë politike e ushtarake e veshur nën petkun fetar, që angazhohej për realizimin e aspiratave të shqiptarëve për të qenë të lirë në tokat e tyre. Kjo organizatë zhvilloi aktivitete të shumta për mbrojtjen e të drejtave të popullit tonë nën pushtim serbo-sllav. Me anë të përfaqësuesve të saj në Parlamentin e jugosllav, ajo e ngriti çështjen e muhaxhirëve të Sanxhakut të Nishit, duke kërkuar kthimin e tyre në pronat e veta, kërkesën për një autonomi të Kosovës, ndërprerjen e vuajtjeve dhe dhunës ndaj popullatës myslimane në jugosllavi, ndërprerjen e reformave agrare, ndërprerjen e shpërnguljes së shqiptarëve për në Anadoll të Turqisë, inkuadrimin në punë, në administratën shtetërore, pastaj mundësoi hapjen e shkollave shqipe, botimin e ndonjë gazete në gjuhën shqipe etj., të cilat për qeverinë e Mbretërisë SKS ishin të papranueshme, madje edhe armiqësore dhe të dënueshme.

Prandaj organet shtetërore të sigurisë, në mënyrë institucionale, fillojnë vëzhgimin, ndjekjet, sulmet fizike, burgosjen dhe vrasjen e përfaqësuesve të saj. Në vitin 1925 burgoset edhe Ferhat bej Draga në Shkup dhe dërgohet në Mitrovicë, ku gjyqi jugosllav e dënoi me njëzet vjet burgim, por pas tri rigjykimëve të njëpasnjëshme lirohet.

Dragajt, në përgjithësi, me bashkëpunëtorët e tyre zhvilluan një aktivitet të jashtëzakonshëm edhe me rastin e mbajtjes së Kongresit të Alfabetit të gjuhës shqipe në Manastir më 1908. Në këtë kohë shqiptarët përdornin tri alfabete: latin, grek dhe turko-arab. Ata kishin njohuri dhe vizion të avancuar për kohën e tyre. Duke qenë properëndimor, Nexhip Draga do të deklaronte zëshëm: *“Me alfabetin latin i hapim dyert e kalasë evropiane, të bijtë e së cilës jemi. Ndërkaq, në një rast lidhur me alfabetin e gjuhës shqipe Ferat bej Draga shkruante: “... germëria-alfabeti jonë kombëtar, gjuha jonë më e ëmbël që pikon mjaltë nga gjuha jonë e lirë shqipe.”*<sup>107</sup>.

Nexhip Dragaj, si deputet nga Shkupi në Parlamentin Osman, dhe Hasan Prishtina, po ashtu deputet nga Kosova aty, mbajtën fjalime të zjarra, duke pasur qëndrime të drejta dhe parimore në të mirë të kombit, kjo në raport me turqit e rinj. Ata i kritikuan reptë veprimet kriminale të Xhavit Pashës me ushtri, i cili në vitin 1910 e dogji dhe shkatërroi Kosovën, gjë që i armiqësoi skajshmërisht shqiptarët me osmanët.

### ***3. Aktiviteti i Ferat bej Dragës në parlamentin jugosllav***

Sa herë që Ferat bej Draga zgjidhej nga populli i vet për deputet në parlamentin jugosllav, qeveria serbe e kundërshtonte me të gjitha

---

<sup>107</sup> Jusuf Osmani - Asllan Murati, *Ferhat Bej Draga shembull atdhetarie* (dokumente), Kolegji AAB, Prishtinë, 2018, f. 451.

mjetet represive. Gjatë votimit ajo i provokonte votuesit shqiptarë, duke i rrahur e burgosur, me qëllim të caktuar, madje jo rrallë derdhej edhe gjaku i shqiptarëve për ma të voglin shkas.

Në emër **Xhemjetit** Ferat Draga u angazhua në Parlamentin Jugosllav për mbrojtjen e të drejtat e shqiptarëve, të cilët në çdo aspekt jetësor, shoqëror e fetar ishin të diskriminuar. Të drejtat e popullit tonë nëpërkëmbeshin, duke ua pamundësuar edhe ekzistencën në trojet e veta etnike, sidomos me marrjen e tokave dhe dhënien e tyre kolonëve serbë. Shqiptarët ngarkoheshin me tatime të mëdha, rriheshin, plaçkiteshin e burgoseshin. Atyre nuk u lejonin të arsimoheshin në gjuhën amnore. Vuajtje shtesë për shqiptarët ishte dhe mbledhja e armëve, e cila shoqërohej me dhunë të egër nga xhandarmëria serbe, e cila i ndëshkonte kryefamiljarët në prani të familjes, ndërsa hoxhallarët i detyronte të betoheshin në Kuran se nuk kanë armë etj.

Sipas dokumenteve të paraqitura në këtë vepër të Jusuf Osmanit dhe Asllan Muratit, jo rrallë kur Ferat Draga e merrte fjalën për të diskutuar në Parlamentin Jugosllav, atë e pengonin dhe e injoronin deputetët serbë të pranishëm në sallë. Në një nga këto dokumente, që përfshihet në këtë vepër, thuhet se në një rast kur Dragaj u drejtohet deputetëve të Parlamentit Jugosllav me fjalët se *“ndoshta mund të gaboj gjatë fjalimit, sepse do të flas në gjuhën serbe”*, deputeti serb Dushan Dimitrijeviq i ndërhynte duke i thënë: *“Kush të ka faj që s’e di gjuhën tënde?”* Por, Dragaj ia kthen guximshëm: *“Unë nuk jam turk, zotëri. Unë jam mysliman i nacionalitetit shqiptar, më i vjetër se ti në Ballkan”*. Pastaj e vazhdon diskutimin: *“Ne nuk i gëzojmë të drejtat që na i garanton Kushtetuta, nuk kemi shkollë, nuk jemi të punësuar, nuk kemi asnjë gazetë në gjuhën tonë, asnjë shtypshkronjë, edhe pse atë na e garanton Kush—*

*tetuta*”<sup>108</sup>. Më tej Draga vazhdon: “*Xhemjeti kërkon nga qeveria që të heqë dorë nga kolonizimi agrar, marrja e tokave të shqiptarëve, t’i ndërpresë reprezaljet ndaj familjeve shqiptare*”, duke përmendua rastin e masakrës në Zagori të Vushtrisë, ku xhandarmëria serbe kinse po e prangosë Mehmet Konjuhini (kaçak), i cili nuk ishte fare në shtëpi, i plagosi e vrau me dhjetëra gra e fëmijë të pafajshëm në atë fshat dhe në fshatrat e tjerë përreth: Dumnice të Epërme, Ceceli etj. Më tutje Dragaj vazhdon: “*Vuajtjet e shqiptarëve nuk kanë fund – ju kinse po i ndiqni kaçakët edhe kur nuk gjenden nëpër shtëpi, merrni shkas dhe bëni masakër në familje të pambrojtura*”. Po ashtu, edhe në një rast tjetër Dragaj, gjatë mbajtjes së fjalimit në këtë parlament, u drejtohet deputetëve: “*Ju lutem që të më falni, se unë po flas serbisht, nëse nuk mund t’i gjejë shprehje të duhur si njeri i shkolluar që në gjuhën shqipe mundem*.” Në këto momente i ndërhyjnë deputeti serb Çedo Kokonoviq duke i thënë: “*Ti e ke harruar gjuhën amtare*.” Por, ky ia kthen: “*Nuk është gjuha ime amnore serbishtja. Gjuha e ime është gjuha shqipe*”.<sup>109</sup>

Sipas veprës “Ferat bej Draga shembull atdhetarie” (dokumente), të autorëve Jusuf Osmani dhe Asllan Murati, Ferat Draga ka dhënë një kontribut të madh për çështjen kombëtare me fjalimet e tij në Parlamentin Jugosllav. Ai në këtë parlament u bë zë i fuqishëm i aspiratave të shqiptarëve për të jetuar të lirë në trojet e veta stërgjyshore. Në diskutimet e tij, e theksonte me të madhe gjendjen e vështirë në të cilën ndodheshin shqiptarët, duke kërkuar që të ndalet shpërngulja për në Turqi, marrja e tokave, plaçkitjet, rrahjet, burgosjet, vrasjet, por edhe që të përmirësohet gjendja e rëndë ekonomike, shkollimi etj.

<sup>108</sup> Jusuf Osmani- Asllan Murati, *Ferhat Bej Draga shembull atdhetarie* (dokumente), Kolegji AAB, Prishtinë, 2018, f. 78.

<sup>109</sup> Vepra e cituar, f. 130.

Qeveria serbe me strukturat e saj kriminale i mbante nën vëzhgim të plotë fjalimet e Ferat Dragës dhe kohë pas kohe jepte urdhra për ndjekje, burgosje dhe likuidime fizike. Ndërkaq qëndrimet armiqësore ndaj shqiptarëve i përkrahte dhe i publikonte edhe shtypi i kohës, sidomos gazeta “Politika”, e cila shquhej me shkrimet e saj destruktive dhe armiqësore ndaj shqiptarëve. Kjo gazetë, si edhe të tjerat, i shtrembëronin të vërtetat dhe shërbeheshin me gënjeshtër të trilluara vetëm e vetëm për t’i fajësuar shqiptarët, me qëllim të caktuar për gjithçka të keqe që ndodhte në hapësirat ku jetonin dhe vepronin ata.

Gjatë historisë shqiptarët kanë kaluar nëpër tragjedi të mëdha, që kanë ndodhur në hapësirën ballkanike, evropiane dhe më gjerë, siç ishin Lufta e Parë Ballkanike (1912–1913), Lufta e Parë Botërore (1914–1918) dhe Lufta e Dytë Botërore (1939–1945), të cilat – në një mënyrë – ua prishen planet dhe marrëveshjet qeverisë serbe me Turqinë për shpërnguljen e shqiptarëve.

Për shqiptarët që jetonin nën sundimin serbomadhi Lufta e Dytë Botërore ishte çlirim e jo okupim, sepse ajo ndali gjenocidin ndaj nesh. Në këtë periudhë shqiptarët në Kosovë për herë të parë e përjetuan çlirimin, edhe pse jo krejtësisht, por ata pak a shumë u ndien të lirë për të jetuar e vepruar. Atëbotë erdhën një numër i konsiderueshëm mësuesish nga Shqipëria, u hapën shkollat shqipe, shqiptarët u punësuan në administratën shtetërore, në vende udhëheqëse, administrata filloi të zhvillohet shqip, në sigurim ishin shqiptarët, madje dhe kufirin e mbronin forcat e armatosura shqiptare. Ferat bej Draga po në këtë vit shkoi në Romë, me qëllim të propagandimit për bashkimin e trojeve shqiptare në një shtet të vetëm. I lodhur nga mosha dhe hallet e mëdha të atdheut ai vdes më 1944 në fshatin Kralan të Dushkajës së Gjakovës.



#### *4. Disa fjalë përmbyllëse*

Jusuf Osmani dhe Asllan Murati, me veprën “Ferat bej Draga shembull atdhetarie (dokumente)”, në mënyrë të dokumentuar e kanë pasqyruar tërë realitetin jetësor e historik të shqiptarëve gjatë decenieve të fundit nën sundimin e Perandorisë Osmane, të periudhës së Mbretërisë SKS, e deri në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, kur në mënyrë institucionale u bënë përpjekje për ta zhbërë qenien tonë kombëtare në rrafshin jetësor e veprimtar.

Në fund do thënë se vepra “Ferat bej Draga shembull atdhetarie (dokumente)”, në aspektin historik, dokumentar, arkivor, kronik dhe publicistik ka një rëndësi të shumëfishtë. Ajo flet zëshëm me gjuhën e fakteve, të dokumenteve arkivore e konsullore për shumë të këqija dhe krime më monstruoze, që i kanë ndodhur popullit tonë brenda një harku kohor mjaft të gjatë, në një anë, dhe kontributin e madh kombëtar e patriotik që dha familja Draga, në anën tjetër, për popullin tonë gjatë periudhave më të vështira të ekzistencës së tij.

Të dhënat e mjaftueshme për veprimtarinë e kësaj figure të shquar kundruall dhunës së egër serbe në periudha të caktuara kanë munguar për shkaqe të njohura objektive, andaj ky studim monografik në masë të ndjeshme do ta plotësojë me të dhëna të reja bibliografike e kësaj familje, por edhe të popullit tonë për periudhën kohore 1908–1945, sepse aty janë hulumtuar dhe publikuar në masë të madhe dokumentet e gjetura në arkivat e Tiranës, Beogradit, Shkupit, Prishtinës etj.

Kjo monografi dokumentare, për këtë personalitet të shquar kombëtar, do të jetë shembull i çmuar i frymëzimit e mobilizimit të gjeneratave të reja se si duhet dashur e mbrojtur me sakrificë atdheu

e populli në kohët më të vështira. Po ashtu, kjo vepër do të jetë aktuale deri sa të ketë shqiptarë nën sundimin e huaj dhe të pabashkuar në një shtet të vetëm etnik.

# FOTOGRAFI



**17 dhjetor 2019 (e martë)**

**11.00 – Shpaloje e pllakës përkujtimore për 100-vjetorin e Xhemijetit**  
Çarshia e Shkupit – Kapan Han

**12.00 – Ekspozitë “Xhamitë dhe teqetë në Shkup mes dy luftërave botërore”**  
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup  
Salla e Ekspozitave

**12.30 – Promovim dhe panel shkencor**  
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup  
Salla “Woodrow Wilson”

**Fjalë përshëndetëse:**  
Prof. dr. Skender ASANI,  
drejtor i ITSHKSH-së  
Prof. dr. Jasmina CURIC,  
kryetare e Këshillit Nacional të Boshnjakëve në Novi Pazar  
Prof. dr. Suad BEĆIROVIĆ,  
rektor i Universitetit Ndërkombëtar në Novi Pazar

**Sesion shkencor:**  
- Dr. Zeqirija IBRAHIMI – drejtesja i sesionit  
- Dr. Nexhmedin SPAHIU  
- Dr. Qerim LITA  
- Mr. Mehmet PRISHTINA

**Promovim i veprave për Xhemijetin në gjuhën shqipe:**  
- Dr. Adem ZEJNULLAHU  
- Dr. Rexhep SHKRIFEL  
- Dr. Nuredin AHMETI

**Fjalë rasti nga autoritë:**  
- Dr. Jusuf OSMANI  
- Mr. Ismet AZIZI  
- Dr. Skender ASANI

**FTESË**

**INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRITËRORE  
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP**

**SHTËPIA BOTUESE “LOGOS-A” – SHKUP**




**“100 VJET XHEMIJET”**

– promovim dhe panel shkencor –




**Shkup, 17 dhjetor 2019**















***BOTUES:***  
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE  
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

SCUPI, vëllimi 28 – 2020

Kryeredaktor: Dr. Zeqirija Ibrahim  
Përgjegjës i botimit: Dr. Sevdail Demiri  
Redaktor teknik: Naser Fera

Shtypi: Focus Print – Shkup  
Rr. Pellagonia 3 – Shkup

Tirazhi: 500 copë

*Ky edicion i SCUPI-t botohet me vendimin e Këshillit të  
ITSHKSH-Shkup, nr. 0201-95/4, të datës 19.02.2020, si pjesë e  
programit të punës së Institutit për vitin 2020.*

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

323.1(=18:497):329Џемијет

100 vjet Xhemijet : (konferencë shkencore - 17 dhjetor 2019) /  
[kryeredaktor Zeqirija Ibrahim]. - Shkup : Instituti i trashëgimisë  
shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, 2020. - 130 стр. : фотографии ;  
21 см. - (Biblioteka Scupi ; v 28)

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4897-13-2

а) Албанско национално прашање - Балкан - Џемијет - Собири

COBISS.MK-ID 51384837